



**Fëmijët në Lëvizje në Shqipëri
Reagimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve
Ndaj Nevojave të Tyre**

Analizë e Situatës




Terre des hommes

tdh.ch



Save the Children

Mbrojtje për fëmijët në lëvizje



Fëmijët në Lëvizje në Shqipëri
Reagimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve
Ndaj Nevojave të Tyre
Analizë e Situatës



Botimi i këtij studimi u mundësua nga Projekti Mario – Mbrojtje për Fëmijët në Lëvizje
financuar nga Fondacioni OAK



TIRANË, 20 Nëntor 2014

“Të Gjitha të Drejtat janë të Rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht për qëllime jofitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet nga njohja e Save the Children dhe Terre des hommes si burimi i tij”

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e Save the Children dhe Terre des hommes.

Fëmijët në Lëvizje në Shqipëri
Reagimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve
Ndaj Nevojave të Tyre

Analizë e Situatës

Autorë:

M.Sc. Kristina Voko

PhD Izela Tahsini

Grupi i punës:

Pierre Stéphane Cazenave

Terre des hommes Regional Office for Central and South Eastern Europe

Blerta Spahiu - **Terre des hommes**

Sabina Carcani - **Save the Children**

Disenjimi & Faqosja:

Eduart Strazimiri




Tabela e Lëndës

Hyrje	7
I. Përmbledhje Ekzekutive	9
• <i>Struktura e raportit</i>	10
• <i>Konkluzionet kryesore të raportit</i>	11
II. Metodologjia	14
• <i>Metodat</i>	14
• <i>Shfletimi i literaturës</i>	14
• <i>Intervistat gjysmë e strukturuar dhe diskutimet në grup</i>	14
• <i>Vëzhgimet</i>	15
• <i>Procedurat dhe kampionet</i>	15
III. Konteksti	17
• <i>Përkufizimi i ‘Fëmijëve në Lëvizje’</i>	19
• <i>Konteksti ligjor dhe parimet e punës në lidhje me fëmijët në lëvizje</i>	19
• <i>Kuadri ligjor ndërkombëtar</i>	19
• <i>Kuadri ligjor shqiptar</i>	22
IV. Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës në Shqipëri	26
• <i>Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve</i>	27
• <i>Standardet dhe procedurat</i>	28
• <i>Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat e trafikimit</i>	29
• <i>Standardet dhe procedurat</i>	30
V. Fëmijët në Lëvizje në Shqipëri	31
• <i>Kush janë fëmijët në lëvizje në Shqipëri?</i>	31
• <i>Modalitetet e lëvizjes dhe arsyet e saj</i>	35
• <i>Lëvizjet e brendshme</i>	37
• <i>Lëvizjet e jashtme</i>	38
• <i>Pasojat e lëvizjes</i>	39

•	<i>Regjistrimi</i>	40
•	<i>Arsimi</i>	41
•	<i>Shëndetësia</i>	43
•	<i>Shfrytëzimi</i>	44
VI.	Reagimi Aktual i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve për Fëmijët në Lëvizje ...	46
•	<i>Kapaciteti dhe përshtatshmëria e reagimeve të SMF-së</i>	46
•	<i>Identifikimi, referimi dhe ndërhyrjet</i>	48
•	<i>Përshtatshmëria e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët viktime të trafikimit...</i>	52
•	<i>Gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria e reagimeve të SMF-së</i>	54
•	<i>Parandalimi</i>	57
VII.	Rekomandimet	63
•	<i>Forcimi i reagimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve</i>	63
•	<i>Krijimi i masave parandaluese</i>	64
VIII.	Shtojcat	65
•	Shtojca I	65
-	<i>Udhëzime për intervistën me palët e interesuara</i>	65
-	<i>Udhëzime për intervistimin e fëmijëve</i>	66
•	Shtojca II	67
-	<i>Origjina e konceptit të fëmijëve në lëvizje</i>	67
•	Shtojca III	72
-	<i>Kuadri rregullator shqiptar në lidhje me të drejtat e fëmijëve në lëvizje ...</i>	72
•	Shtojca IV	80
-	<i>Rolet dhe përgjegjësitë e agjencive në lidhje me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve</i>	80
-	<i>Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me Mekanizmin Kombëtar të Referimit të viktimeve të trafikimit</i>	82
IX.	Referencat	97

Listë e Akronimeve

NGO	Organizatë jo Qeveritare
SMF	Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve
CPU	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
BKTF	Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve
CRU	Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
CRC	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
UN	Kombet e Bashkuara
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
UNICEF	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
EU	Bashkimi Evropian

Hyrje

Migrimi i brendshëm apo midis vendeve i fëmijëve dhe familjeve të tyre, është fenomen i cili vazhdon të ndeshet në Shqipëri; tashmë, në tendenca të reja përsa i përket destinacionit,

“Këtu shoqëria është më e mirë, njerëzit më të afrueshëm. Në fillim më erdhi keq që ikëm nga fshati se aty ishte vendlindja ime, por tani u mësova. Tani pas 4 vjetësh ndihem shumë mirë.” Djalë, 12 vjeç

periodicitetit, morisë së familjeve dhe angazhimit të fëmijëve në sigurimin e kushteve minimale të jetesës.

Ndërkohë që lëvizja mund të sjellë ndryshime të rëndësishme; mundësi më të mira jetese, zhvillim personal apo akses në shërbime cilësore, mundet gjithashtu të rrisë gjasat e ekspozimit të fëmijëve ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit, meqë shpesh ata konsiderohen si “të padukshëm”. Si të tillë, fëmijët në situatë migrimi të brendshëm apo midis vendeve, veçanërisht fëmijët e pashoqëruar, kanë nevoja të veçanta për mbrojtje.

Për qëllime të projektit Mario, një “fëmijë në lëvizje” do të kuptohet se përfshin kategoritë e mëposhtme të fëmijëve: fëmijë migrantë (të brendshëm ose përtej kufijve; të ligjshëm ose të paligjshëm; të shoqëruar ose jo), fëmijë azilkërkues dhe refugjatë, fëmijë të trafikuar, fëmijë të zhvendosur brenda vendit ose fëmijë jashtë mjedisit të mbrojtur. Për rrjedhojë, fëmija duhet të ketë lëvizur, mund të jetë migrant i kthyer, është në lëvizje ose/dhe migrimi është i pashmangshëm.

Fëmija duhet të ketë nënshtetësinë ose vendbanimin në një nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Migrimi mund të jetë ose i brendshëm ose ndërkombëtar.

Fëmijët në lëvizje, në Evropën Jugore dhe Lindore, të cilët janë vunerabël kundrejt abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit. Partnerët e Mario-s kanë dedikuar përpjekjet për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve; kryerjen e hulumtimeve

I Partnerë kyesorë: Neglected Children's Society (ECPAT Bulgaria) Nobody's Children Foundation (ECPAT Poland) Save the Children Albania CO, Salvati Copiii (Save the Children Romania) Terre des hommes (Albania, Hungary, Kosovo, Romania) The associate partners: ARSIS (GR), Associazione 21 luglio (IT), Open gate – La Strada (Macedonia) Defence for Children International (ECPAT The Netherlands).

kombëtare dhe midis vendeve; ngitjes së mekanizave të monitorimit dhe advokacisë në përmbushjen e detyrave të institucioneve lokale dhe kombëtare për realizimin e të drejtave të fëmijëve; si dhe, advokimin në nivel evropian.

Një nga këto mekanizma janë Bordet e Konsultimit të Fëmijëve – grupim formal i fëmijëve të cilët kanë eksperiencën e lëvizjes, e që janë bashkuar për të advokuar për nevojat e veçanta, të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje. Në Shqipëri janë ngritur dy Borde; njëri, i cili ka marrë pjesë në realizimin e kësaj “Analize të Situatës” e që po punon ngushtësisht me Koalicionin Kobëtar BKTF, të cilët vijnë nga organizata të ndryshme dhe një; në Cërrik.

Kjo Analizë e Situatës synon të informojë për punën dhe përpjekjet e partnerëve dhe palëve kryesore publike dhe private të projektit Mario, në lidhje me funksionalitetin dhe efektivitetin e sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, për të regjistruar dhe përgjigjur nevojave të fëmijëve në lëvizje në lidhje me aksesueshmërinë, gjithpërfshirjen dhe reagimin.

Partnerët e Mario-s shpresojnë që të kuptuarit e faktorëve të vulnerabilitetit dhe shqetësimeve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje, do të ndihojë për të hartuar rekomandime dhe zgjidhje të mundshme, të cilat janë në interesin më të mirë të fëmijëve në Shqipëri.



I. Përmbledhje Ekzekutive

Problemet kryesore me të cilat përballen fëmijët sot në Shqipëri janë abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, keqtrajtimi, trafikimi, diskriminimi, neglizhenca, varfëria dhe përjashtimi nga shoqëria, të cilat për vite me radhë kanë qenë në qendër të vëmendjes së OJQ-ve, të shoqërisë civile lokale dhe ndërkombëtare. Meqenëse edhe në nivel ndërkombëtar, lëvizja e fëmijëve është gjithashtu një fenomen i përhapur gjerësisht në rajonin e Ballkanit, i cili paraqet rreziqe konkrete për jetën e shumë fëmijëve, që janë të detyruar të lëvizin për shkak të arsyeve të shumta sociale dhe ekonomike².

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri nuk është i aftë të identifikojë dhe t'u përgjigjet siç duhet problemeve të mbrojtjes që lëvizja mund të shkaktojë në jetën e fëmijëve në lëvizje, të cilët shpesh anashkalohen. Sistemi aktual i mbrojtjes së fëmijëve nuk siguron një mekanizëm për identifikimin e hershëm të nevojave të këtyre fëmijëve dhe nuk ka protokolle në funksion për t'i ndihmuar këta fëmijë me efikasitet si brenda ashtu edhe jashtë vendit dhe të sigurojë që ata kanë akses në shërbime cilësore pa qenë të kufizuar nga faktori gjeografik.

Në këtë kuadër, partnerët e projektit Mario në Shqipëri; Misioni i Terre des hommes në Shqipëri dhe Save the Children, kanë ndërmarrë këtë Analizë të Situatës, e cila ka si qëllim të informojë punën dhe përpjekjet e partnerëve të projektit Mario dhe të palëve kryesore të interesuara, qofshin private dhe publike, mbi funksionalitetin dhe efikasitetin e sistemit ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, që lidhet me zbulimin dhe reagimin ndaj nevojave të fëmijëve në lëvizje, për sa i përket aksesueshmërisë, gjithëpërfshirjes, proaktivitetit dhe parandalimit.

Qëllimi kryesor është që të përdoret një qasje gjithëpërfshirëse për të kuptuar faktorët e cënueshmërisë dhe problemet e mbrojtjes së fëmijëve me të cilat përballen fëmijët në lëvizje, dhe të propozohen zgjidhje në interesin më të mirë të fëmijëve, nëpërmjet advokimit, rritjes së kapaciteteve të ofruesve të shërbimit dhe asistencës së drejtpërdrejtë që u jepet fëmijëve në lëvizje.

Objektivat e kësaj Analize të Situatës kanë si synim të:

- I. Zhvillojnë një studim të thelluar të literaturës, duke rishikuar të gjithë dokumentacionin e disponueshëm, kryesisht dokumente zyrtare dhe raporte, me qëllim që të kuptohet

² Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijëve, Projekti Mario, BKTF, 2012.

fenomeni i fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, shkalla e tij dhe si sistemi ekzistues i mbrojtjes së fëmijëve është përshtatur për të identifikuar dhe për të reaguar ndaj nevojave dhe çështjeve që lidhen me ta.

2. Vlerësojnë perceptimin dhe këndvështrimet e fëmijëve se si lëvizja ka ndikuar në jetën e tyre dhe marrëdhënien që ekziston ndërmjet lëvizjes dhe cënueshmërisë së fëmijëve.
3. Vlerësojnë nevojat e fëmijëve për shërbime; cilat shërbime janë të disponueshme në vend; sa janë fëmijët të informuar për këto shërbime dhe aksesin që kanë ndaj tyre?
4. Vlerësojnë nëse sistemi i mbrojtjes është efikas për sa i përket shtrirjes, gjithëpërfshirjes dhe reagimit.

Struktura e raportit

Raporti fillon me kapitullin e Metodologjisë, për të shpjeguar sfondin se ku është e bazuar kjo analizë dhe metodologjia e saj.

Kapitulli i dytë; Konteksti, do të japë një përmbledhje të të dhënave dytësore që ekzistojnë lidhur me: a) zhvillimet për përkufizimin e fëmijëve në lëvizje; b) kontekstin ligjor ndërkombëtar dhe vendas për sa i përket fëmijëve në lëvizje; dhe c) tiparet e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Kapitulli i tretë ‘Fëmijët në lëvizje në Shqipëri’ do të paraqesë karakteristikat e fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, shkaqet dhe modalitetet e lëvizjes së tyre, si edhe pasojat e saj. Të dhënat e paraqitura në këtë pjesë, janë mbledhur nga raportet e studimeve të mëparshme, si edhe nga intervistat, fokus-grupet dhe vëzhgimet e kryera në funksion të kësaj analize.

Kapitulli i katërt ‘Reagimi i sistemit ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve ndaj fëmijëve në lëvizje’ identifikon praktikat pozitive, mundësitë dhe mangësitë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, për të reaguar siç duhet, për të qenë përfshirës, për t’i siguruar fëmijëve në lëvizje aksesin në shërbime dhe të ndërmarrë masa parandaluese, me qëllim reduktimin e rreziqeve që lidhen me lëvizjet e pasigurta.

Kapitulli i fundit i raportit jep një përmbledhje të rekomandimeve kryesore që janë identifikuar në këtë analizë të situatës, hapat e mëtejshme e të nevojshme për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, me qëllim që ai të reagojë më mirë ndaj nevojave të fëmijëve në lëvizje.

Konkluzionet kryesore të raportit


- Fëmijët në lëvizje janë anashkaluar gjatë hartimit të legjislacionit dhe politikave

- kombëtare, që trajtojnë migracionin dhe mirëqenien e fëmijëve, edhe pse në këto vitet e fundit, lëvizja e fëmijëve po bëhet një pjesë edhe më e njohur e lëvizjes më të gjerë të grupeve të popullsisë. Ajo po merr një vëmendje më të madhe si nga institucionet shtetërore, ashtu edhe nga agjencitë e të drejtave të fëmijëve, në lidhje me rrethanat e veçanta, cënueshmëritë dhe pasojat e lëvizjes së fëmijëve.
- Shqipëria ka ratifikuar shumë instrumente ndërkombëtarë kyçe për të drejtat e njeriut që kanë lidhje me fëmijët në lëvizje, por deri tani legjislacioni shqiptar nuk u referohet fëmijëve në lëvizje si një kategori gjithëpërfshirëse. Pavarësisht se Shqipëria ka miratuar gjatë dekadës së fundit një sërë ligjesh, strategjish dhe dokumente të tjera të rëndësishme, të cilët ndërtojnë kuadrin rregullator të mbrojtjes së fëmijëve, nga i cili përfitojnë deri diku edhe fëmijët në lëvizje, ka akoma shumë për të bërë, me qëllim që atyre t'u jepet një mbrojtje dhe asistencë efikase, sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar.
 - Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri vazhdon të funksionojë sipas një qasje të bazuar në rast dhe në grupin e synuar, çka zvogëlon rezultatet për mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë të qëndrueshme, sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Sistemi bazohet në dy mekanizma shumë të rëndësishëm; në atë të mbrojtjes së fëmijëve me në qendër fëmijët që janë abuzuar ose në rrezik për t'u abuzuar, dhe në mekanizmin kombëtar të referimit, i cili ka në qendër fëmijët viktimë/viktima të mundshme të trafikimit.
 - Grupet kryesore të fëmijëve të prekur nga lëvizja në Shqipëri, siç janë identifikuar nga literatura apo informuesit kryesorë dhe profesionistët, përfshijnë: fëmijët që kanë migruar; fëmijët e rrugës; fëmijët e trafikuar; dhe fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian. Edhe pse sipas përkufizimit Mario, mund të ketë fëmijë të tjerë që preken nga lëvizja në Shqipëri, për shembull fëmijët e larguar, këto grupe nuk janë identifikuar nga burimet kryesore apo nga të dhënat dhe literatura lokale e disponueshme. Studimet e bëra deri më tani në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, kryesisht u referohen grupeve të përmendura më sipër në mënyrë të fragmentizuar dhe nuk identifikojnë lëvizjen si një faktor të përbashkët rreziku për të gjitha grupet apo për disa prej tyre. Gjithashtu, të dhënat ekzistuese për këto grupe janë të ndara, duke rritur rrezikun për mbivendosje të të dhënave, sepse fëmijët e grupeve të cënueshme mund t'u përkasin njëherazi më shumë se një kategori.
 - Pavarësisht karakteristikave të ndryshme të secilit grup, burimet kryesore të studimit tonë raportuan ekzistencën e elementeve të përbashkëta, të cilat mund të identifikohen si faktorë rreziku nëse je fëmijë në lëvizje. Kështu, fëmijët që vijnë nga familjet me probleme sociale apo ekonomike, nga zonat rurale apo nga grupet e përjashtuara nga shoqëria (p.sh komuniteti rom), u raportuan nga burimet kryesore, si grupe me më shumë gjasa për të lëvizur dhe më të prekur nga pasojat e saj.
 - Pavarësisht nga modalitetet e lëvizjes, fëmijët gjithnjë janë të prekur me pasoja negative dhe pozitive. Lëvizjet e qëndrueshme migratore, ku e gjithë familja lëviz për një

periudhë të gjatë kohe, shpesh ndiqen nga kushte më të mira të jetës dhe një akses më të madh në shërbime, por kjo nuk mund të përgjithësohet. Duke u mbështetur në këtë përgjithësim, profesionistët e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve ndonjëherë e nënvlerësojnë peshën e migracionit, si p.sh. humbjen e mjedisit familjar, të lidhjeve familjare, të miqve, vështirësitë që këta fëmijë kanë për t'u përshtatur. Gjithashtu, fëmijët përfitojnë nga lëvizja, duke mësuar aftësi të reja, siç është raportuar nga studimet e mëparshme.

- Disa nga pasojat negative që lëvizja shkakton te fëmijët, ndaj të cilave sistemi i mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë më i vëmendshëm, lidhen me:
 - a) Regjistrimin – Disa nga fëmijët mund të mos jenë regjistruar në lindje ose mund të preken nga problemet e regjistrimit në zonën e re ku familja ka lëvizur. Mungesa e regjistrimit sjell si pasojë një akses të kufizuar në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, në programet e mbrojtjes sociale, etj., por edhe vështirësi për akses në institucionet publike.
 - b) Arsimimin – grupet e fëmijëve në lëvizje, në veçanti fëmijët rom, ndikohen nga dy probleme kryesore që lidhen me arsimin: niveli i ulët i regjistrimit në shkollë dhe niveli i lartë i braktisjes së shkollës para përfundimit të vitit akademik, duke kontribuar kështu në shkallën e përgjithshme të analfabetizimit.
 - c) Shëndetësinë – për shkak të mos regjistrimit apo statusit të tyre të paligjshëm në shtete të tjera, fëmijët në lëvizje kanë akses të kufizuar në vaksinim, në ofrimin falas të kujdesit shëndetësor apo shërbimeve cilësore shëndetësore.
 - d) Shfrytëzimin – fëmijët në lëvizje janë në mënyrë të veçantë të pambrojtur ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit. Kryesisht, kur lëvizin vetëm, këta fëmijë janë të pambrojtur ndaj shfrytëzimit, shtrëngimit, mashtrimit dhe dhunës. Ata janë sidomos të ekspozuar ndaj formave më të këqija të punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit e abuzimit seksual. Si pasojë e këtyre rreziqeve, diskriminimit që ata përjetojnë dhe statusit të tyre si sapo të ardhur, fëmijët që lëvizin përballen me pengesa për të gëzuar të drejtat themelore dhe për të pasur akses në shërbimet bazë.
- Megjithatë gjatë viteve të fundit, Shqipëria është duke u larguar nga qasja e bazuar në rast, për programimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe po shkon drejt një qasje më sistematike të mbrojtjes së fëmijëve. Qasjes së parë i mungonte qëndrueshmëria dhe nuk i përgjigjej situatës së të gjithë fëmijëve në rrezik abuzimi në formën e tij më të gjerë. Aktualisht, sipas disa studimeve del në pah se akoma nuk është një sistem në funksion por vetëm pjesë të tij.
- Shërbimet ekzistuese kanë shumë mangësi për t'u përgjigjur nevojave të fëmijëve, çka dëshmohet më së miri me rastet e fëmijëve në lëvizje. Shërbimet që ofrohen nuk janë të përshtatura sipas nevojave individuale të fëmijëve në lëvizje. Mekanizmat kryesore për t'ju drejtuar këtyre nevojave janë mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat e trafikimit.

- Kapacitetet e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve (SMF) për t'u përgjigjur nevojave të fëmijëve në lëvizje, janë të kufizuara për shkak të shpërndarjes së pamjaftueshme gjeografike të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) në Shqipëri. Nuk ka bashkërendim ndërmjet aktorëve, veçanërisht midis niveleve vendore dhe qendrore, për shkak të mungesës së mekanizmave të mjaftueshëm të monitorimit për menaxhimin e rastit.
- Shërbimet e ofruara nga Shteti dhe OJQ-të për fëmijët në lëvizje janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë, ku OJQ-të kryejnë pjesën më të madhe të shërbimeve të ofruara. Përfaqësuesit e OJQ-ve identifikojnë lehtësirat e kufizuara të Shtetit në sigurimin e këtyre shërbimeve.
- Roli i aktorëve kryesorë, si psikologët e shkollave, administratorët social, policia kufitare, etj., nuk është plotësisht i detajuar dhe i monitoruar, me qëllim që të ndihmojnë në identifikimin dhe referimin e fëmijëve në lëvizje. Administratorët social janë gjithashtu të mbingarkuar me rolet e tyre ekzistuese, të cilat janë kryesisht të kufizuara në dhënien e ndihmës financiare. Shkollat si institucione, nuk sigurojnë ndjekjen e mëvonshme të lëvizjeve, veçanërisht brenda vendit, kjo mund të ulte numrin e fëmijëve që zhduken nga sistemi. Policia kufitare, veçanërisht për rastet e minorenëve të pashoqëruar, kryesisht për fëmijët Rom, është raportuar se i toleron këto lëvizje, ndonjëherë edhe pa dokumentet e nevojshme të identifikimit.
- Për sa i përket parandalimit, qeveria dhe OJQ-të kanë ndërmarrë disa masa të kufizuara parandaluese në lidhje me ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme që fëmijët në lëvizje mund të përballen, për shembull fushata, seminare etj. Deri më tani, pavarësisht këtyre, nuk është bërë asnjë vlerësim për nivelin e mbulimit të masave të ndërmarra. Fëmijët që morën pjesë në hulumtimin tonë nuk mund të identifikonin asnjë nga masat e ndërmarra apo diçka tjetër të ngjashme me to. Nga ana tjetër, disa masa parandaluese lidhur me mbrojtjen e fëmijëve gjatë lëvizjes së tyre janë ndërmarrë nga institucionet e SMF-së në funksion të: regjistrimit në regjistrin civil, ndjekjes së rregullt të shkollës dhe uljes së nivelit të braktisjes së shkollës, vaksinimit dhe kujdesit shëndetësor dhe integritetit të të kthyerve.
- Rekomandimet e kësaj analize të situatës përqendrohen në: nevojën për të zhvilluar një kuadër ligjor që trajton fëmijët në lëvizje që redukton mangësitë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, me qëllim që t'i përgjigjet sa më mirë nevojave të fëmijëve në lëvizje, të hartojë masa më të mira parandaluese parësore dhe dytësore, të përmirësojë sistemin e mbledhjes së të dhënave dhe të vazhdojë më tej hulumtime specifike për fëmijët në lëvizje.



II. Metodologjia

Metodat

Studimi i Analizës së Situatës u zhvillua gjatë periudhës Tetor 2013 – Mars 2014. Sipas

- “Udhëzimeve Metodologjike Mario”, katër metoda kërkimore u zbatuan në Shqipëri: (1) shfletimi i literaturës, (2) intervista gjysmë e strukturuar me palët e interesuara, fëmijët dhe prindërit, (3) diskutime të hapura në grup me palët e interesuara dhe fëmijët, dhe (4) vëzhgim.

Shfletimi i literaturës

- Të dhënat dytësore për analizimin e situatës u mblodhën nëpërmjet shfletimit të literaturës, me qëllim që të vlerësohen dokumentet ekzistuese rregullatore dhe raportet e hulumtimeve për fëmijët në lëvizje. Rishikimi i dokumentacionit ishte hapi i parë i kërkimit shkencor dhe gjetjet ndihmuan për zhvillimin e instrumenteve më të detajuara për intervistat dhe diskutimet në grupe, si edhe për identifikuar më mirë palët kryesore të interesuara, shërbimet dhe projektet e tjera në këtë fushë.

Intervistat gjysmë e strukturuar dhe diskutimet në grup

- Sipas kuadrit metodologjik të parashikuar në projektin _____ Mario dhe gjetjeve nga studimi i literaturës, u hartuan tre instrumente të ndryshëm për intervistat gjysmë të strukturuar dhe diskutimet në grup; një për secilin grup: palët e interesuara, fëmijët dhe prindërit. Instrumentet e përdorur për të drejtuar intervistat gjysmë e strukturuar dhe diskutimet në grup jepen në Shtojcën I të këtij raporti.

Palët e interesuara – Intervistat gjysmë e strukturuar me palët e interesuara u zhvilluan ballë për ballë ose nëpërmjet email-it. Në total u zhvilluan 19 intervista dhe një diskutim në grup me 16 pjesëmarrës: përfaqësues të institucioneve vendim-marrëse (Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Arsimit; Ministria e Shëndetësisë; Shërbimi Social Shtetëror; Ministria e Punëve të Brendshme; etj.); përfaqësuesit e OJQ-ve që punojnë në këtë fushë me projekte ose nëpërmjet ofrimit të shërbimeve; dhe profesionistët që punojnë në shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve.

Fëmijët – Në total, u zhvilluan 12 intervista gjysmë e strukturuar dhe dy diskutime në grup me 16 fëmijë. Një diskutim në grup u zhvillua me nëntë fëmijë, anëtarë të bordit të këshillimit të

fëmijëve, ndërsa tjetri u zhvillua me një grup prej shtatë fëmijësh, i moderuar së bashku me dy përfaqësues të bordit. Fëmijët të intervistuar ishin të moshës nga gjashtë deri në 17 vjeç. *Prindërit/kujdestarët* – Gjatë punës në terren, u zhvilluan shtatë intervista me **të thelluara me prindërit apo kujdestarët e fëmijëve në lëvizje.**

Vëzhgimet

Vëzhgimet për këtë analizë të situatës u zhvilluan në bazë të një rasti specifik të një komuniteti rom që u zhvendosën nga zona e tyre e mëparshme e banimit gjatë periudhës së kohës së punës në terren. Vëzhgimet u bënë në dy faza: faza e parë, gjatë kohës së zhvendosjes, dhe faza e dytë, një muaj pas vendosjes së tyre në një zonë tjetër (e ngritur si një Qendër e Përkohshme Emergjente nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe e menaxhuar nga Shërbimet Sociale Shtetërore).

Procedurat dhe kampionet

Në përputhje me Udhëzimet Metodologjike Mario, pas shfletimit të literaturës, u zhvilluan dy takime me Bordin e Këshillimit të Fëmijëve, ku u paraqit qëllimi i kërimit dhe u vendos raporti me fëmijët. Anëtarët e Bordit u ftuan që të marrin pjesë në këtë hulumtim, në përputhje me interesat dhe gatishmërisë së tyre për të qenë të përfshirë në disa nga fazat e hulumtimit, e për këtë arsye ata u trajnuan me mbështetjen e stafit të Tdh dhe projektit BKTF, si të kryejnë një kërkim shkencor.

Në bazë të gjetjeve të shfletimit të literaturës dhe diskutimit me Bordin e Këshillimit të Fëmijëve dhe grupit të partnerëve të projektit (Save the Children dhe Terre des hommes, Shqipëri) u identifikua lista e palëve të interesuara përkatëse, që do të intervistohesh, si edhe grupet e fëmijëve dhe të prindërve. Sipas përkufizimit Mario të fëmijëve në lëvizje, të intervistuarit e përzgjedhur ishin fëmijë migrantë (brenda ose jashtë kufirit; të ligjshëm ose të paligjshëm; të shoqëruar ose jo), fëmijë të trafikuar, fëmijë të zhvendosur brenda vendit dhe fëmijë jashtë një mjedisit të mbrojtur.

Më pas, u përgatitën udhëzimet e intervistave dhe diskutimeve në grup, dhe mjetet për fëmijët u testuan me Bordin. Më tej, u zhvilluan intervistat, diskutimet në grup dhe vëzhgimet me pjesëmarrësit e përzgjedhur, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Bordit si vëzhgues dhe moderatorë të diskutimeve në grup me fëmijët. Të gjitha intervistat e bëra me fëmijët u zhvilluan me pëlqimin e tyre të informuar. Duke përdorur një gjuhë të kuptueshme për fëmijët, atyre iu shpjegua qëllimi i hulumtimit dhe vlera e pjesëmarrjes së tyre, dhe ju dha mundësia që të pranonin ose refuzonin pjesëmarrjen e tyre. Gjithashtu, ata u siguruan se i gjithë informacioni i dhënë do të mbetej konfidencial.

Si hap i fundit, projekt raporti u nda dhe u diskutua me anëtarët e Bordit dhe u përgatit raporti përfundimtar i analizës së situatës.



III. Konteksti

Fëmijët në Shqipëri (përcaktuar në Nenin I të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe legjislacionin shqiptar si “çdo qenie njerëzore nën moshën 28 vjeçare [...]”) përbëjnë 33% të popullsisë shqiptare³. Ndryshimi i regjimit në fillim të viteve 1990, midis të tjerave solli edhe probleme sociale dhe ekonomike, si edhe prishjen e familjes tradicionale dhe sistemeve të komunitetit që ofronin siguri dhe mbrojtje për fëmijët.

Problemet kryesore më të cilat po përballen sot fëmijët në Shqipëri janë abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, keqtrajtimi, trafikimi, diskriminimi, neglizhenca, varfëria dhe përjashtimi social⁴. Këto probleme kanë qenë për vite të tëra në qendër të vëmendjes së organizatave jo-fitim prurëse vendase dhe ndërkombëtare për fëmijët dhe të qeverisë. Gjithashtu, në Shqipëri, ashtu si në të gjithë botën, lëvizja e fëmijëve është një fenomen shoqëror i shumë përhapur, i cili paraqet kërcënime konkrete ndaj jetëve të shumë fëmijëve, që janë të detyruar të lëvizin për arsye të ndryshme shoqërore dhe ekonomike⁵. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në vend nuk është në gjendje të identifikojë dhe të trajtojë siç duhet çështjet e mbrojtjes që lëvizja mund të krijojë në jetën e këtyre fëmijëve, që shpesh anashkalohen. Sistemi aktual i mbrojtjes duhet të sigurojë një mekanizëm për identifikimin e hershëm të nevojave të këtyre fëmijëve dhe të ketë kapacitetet e burimet që t’i ndihmojë ata me efikasitet si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke u siguruar akses të plotë në shërbime cilësore, pavarësisht vendndodhjes së tyre⁶.

Pavarësisht faktit se mungojnë të dhëna të sakta për fëmijët në lëvizje në Shqipëri, disa studime që janë bërë për fenomenet e trafikimit, migracionit dhe fëmijëve të pashoqëruar, tregojnë qartë se, vetë lëvizja mund të ketë një ndikim negativ në jetën e fëmijëve dhe në përmbushjen e të drejtave të tyre⁷.

Studimi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (2006) thekson rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe shfrytëzimit. Duke realizuar rekomandimet e Studimit, d.m.th duke u larguar nga një qasje për mbrojtjen e fëmijëve e bazuar në rast, e cila përqendrohet në raste të veçanta të mbrojtjes dhe në grupe specifike të fëmijëve, dhe duke synuar një qasje të bazuar në sistem, e cila trajton të gjithë gamën e faktorëve të mundshëm që ndikojnë te fëmijët, te familjet e tyre dhe komunitetet. Në këtë linjë mendimi, zhvillimi i një qasje të bazuar në sistem për mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje, sesa t’i klasifikojmë sipas sektorëve dhe

3 INSTAT, Shqipëria në Shifra, 2010.

4 Analiza e Situatës për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve BKTF, 2011.

5 Fenomeni i Lëvizjes së Fëmijëve në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012.

6 Po aty.

7 Po aty.

grupeve, do të vendoste një qasje gjithëpërfshirëse ndaj mbrojtjes së fëmijëve. Në të njëjtën kohë, kjo metodologji merr parasysh dallimet e fëmijëve sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, motivimeve, aspiratave dhe faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në cënueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Për rrjedhojë, koncepti i fëmijëve në lëvizje krijon më shumë hapësirë për ndërhyrjet, që me të vërtetë u përgjigjen nevojave të tyre dhe që respektojnë të drejtat e fëmijëve, përfshirë këtu të drejtën e fëmijëve për të shprehur mendimet e tyre dhe të drejtën e aksesit në shërbime dhe të mbështetjes për të zhvilluar interesat e tyre më të mira.

Në Shqipëri, janë bërë mjaft studime hulumtuese, shumë prej tyre të kohëve të fundit, për situatën e kategorive të mësipërme të fëmijëve brenda përkufizimit gjithëpërfshirës, dhe për reagimin e sistemit të mbrojtjes ndaj tyre. Edhe pse shumë nga studimet kanë në qendër njërin prej këtyre kategorive, ka edhe mbivendosje të tyre, duke marrë parasysh dhe kompleksitetin e situatave të jetës së tyre. Të gjitha këto studime e shikojnë lëvizjen/shpërnguljen si një fenomen dhe faktor që ndikon në jetën e fëmijëve, qoftë në mënyrë pozitive apo negative. Gjithashtu, nuk ka shumë informacion se si fëmijët në lëvizje kanë akses në shërbimet bazë, si ato shëndetësore, arsimore, të mbrojtjes etj., në mjediset e tyre të reja të banimit.

Në Shqipëri deri më tani, ka vetëm një studim që ka në qendër përvojat e fëmijëve në lëvizje si një grup i vetëm⁸. Studimi ka hetuar përvojat e lëvizjes nga vetë këndvështrimi dhe ndjenjat e fëmijëve, ka eksploruar rrugët e lëvizjes, rolin e fëmijëve në marrjen e vendimeve për të lëvizur, dhe mundësitë e mundshme që mund t'u ofrohen fëmijëve gjatë lëvizjes së tyre. Edhe pse gjetjet nuk mund të përgjithësohen për të gjithë fëmijët që lëvizin, studimi ofron një informacion të vlefshëm për tendencat aktuale të migrimit të fëmijëve në Shqipëri. Gjetjet nxorën në pah, praninë e dy modeleve kryesore të lëvizjes, sipas situatës ekonomike të familjeve dhe sipas llojit të lëvizjes. Familjet me varfëri të theksuar, kryesisht të komunitetit rom, lëvizin për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike nëpërmjet punës së fëmijëve apo prindërve. Lëvizja e tyre është e shpeshtë, brenda dhe jashtë vendit. Në rastin e fëmijëve me familje në gjendje më të mirë ekonomike, lëvizja motivohet nga nevoja për akses më të mirë në shërbimet e arsimit dhe shëndetësisë, dhe mundësi më të mira punësimi për prindërit. Lëvizja e tyre në përgjithësi është më e strukturuar, për një periudhë më të gjatë kohe, brenda vendit dhe qëndrimi i tyre në vende të reja zakonisht është më i gjatë. Në përgjithësi, fëmijët raportuan për një ndryshim të vogël në cilësinë e jetës së tyre pas lëvizjes. Ata fituan aftësi dhe shprehi të reja si gjuhë apo dialekte të reja, shprehi dhe aftësi teknike dhe aftësinë për t'u përballur me situata të reja. Megjithatë, lëvizja u shoqërua edhe me pasoja negative si, problemet e përshtatjes, punë të pasigurta dhe në disa raste, mungesa e aksesit në shërbimet shëndetësore.

8 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijëve, Projekti Mario, BKTF, 2012.

Pjesët e mëposhtme të këtij kreu përmbledhin të dhënat dytësore që ekzistojnë mbi: a) zhvillimet e përkufizimit të fëmijëve në lëvizje; b) kontekstin ligjor ndërkombëtar dhe vendas në lidhje me fëmijët në lëvizje; dhe c) tiparet e sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Diskutimet dhe analiza e mekanizmave ligjorë dhe institucional lidhur me fëmijët në lëvizje në vend paraqiten në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti.

Përkufizimi i ‘Fëmijëve në Lëvizje’

Për qëllime të projektit Mario, një “fëmijë në lëvizje” do të kuptohet se përfshin kategoritë e mëposhtme të fëmijëve: fëmijë migrantë (të brendshëm ose përtej kufijve; të ligjshëm ose të paligjshëm; të shoqëruar ose jo), fëmijë azilkërkuar dhe refugjatë, fëmijë të trafikuar, fëmijë të zhvendosur brenda vendit ose fëmijë jashtë mjedisit të mbrojtur. Për rrjedhojë, fëmija duhet të ketë lëvizur, mund të jetë migrant i kthyer, është në lëvizje ose/dhe migrimi është i pashmangshëm. Fëmija duhet të ketë nënshtetësinë ose vendbanimin në një nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Migrimi mund të jetë ose i brendshëm ose ndërkombëtar.

Konteksti ligjor dhe parimet e punës në lidhje me fëmijët në lëvizje

Fëmijët në lëvizje shpesh anashkalohen në hartimin e ligjeve dhe politikave kombëtare që trajtojnë migracionin dhe mirëqenien e fëmijëve. Megjithatë, në vitet e fundit ka pasur një rritje të vëmendjes, si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga agjencitë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për rrethanat specifike, cënuesheshmëritë dhe pasojat e lëvizjes së fëmijëve⁹. Të gjithë fëmijët që klasifikohen sipas përkufizimit “fëmijë në lëvizje” gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sipas të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare të refugjatëve, të drejtës ndërkombëtare humanitare, instrumenteve të ndryshëm rajonal dhe kuadrit ligjor vendas, dhe është e nevojshme që atyre t’u jepet mbrojtje efikase dhe ndihmë në mënyrë sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar.

Kuadri ligjor ndërkombëtar

Disa traktate ndërkombëtare mbulojnë të drejtat e fëmijëve në lëvizje. Në qendër të kuadrit ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve është Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1989) që, (më poshtë e përmendur: KDF) – së bashku me Protokollin Shtesë mbi Shitjet e Fëmijëve, Shfrytëzimin e Fëmijëve për Prostitucion dhe Pornografi dhe Protokollin Shtesë për Përfshirjen e Fëmijëve në Konflikt të Armatosur – është një nga traktatet për të drejtat e njeriut, i cili është ratifikuar më gjerësisht, dhe është baza për mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të fëmijës.

⁹ Daniela Reale, “Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje: Përkthimi i parimeve në praktikë”, tek IOM, *Fëmijët në Lëvizje*, 2013.

KDF përcakton standardet minimale që Shtetet duhet të respektojnë lidhur me trajtimin e fëmijëve në juridiksionet e tyre përkatëse, pa asnjë diskriminim në bazë të kombësisë, statusit të imigrimit apo statusit të shtetësisë (Neni 2 KDF). Për rrjedhojë, Shtetet i trajtojnë fëmijët në lëvizje para së gjithash si fëmijë, t'i shikojnë dhe t'i trajtojnë ata si çdo fëmijë tjetër, duke u dhënë atyre akses të barabartë në të drejtat themelore, si fëmijët e tjerë.

Në rastin e Shqipërisë, e cila e ka ratifikuar konventën, një ligj kombëtar specifik që siguron mbrojtjen e këtyre të drejtave është Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, 2010¹⁰. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përfshin shumë nga aspektet kryesore të KDF-së. Nene të veçanta që trajtojnë të drejtat e fëmijëve në lëvizje përfshijnë:

- Neni 7 i referohet të drejtës të regjistrimit në lindje, kombësisë, ruajtjes së identitetit dhe marrjes së kujdesit prindëror, kur është e mundur;
- Neni 9 njuh të drejtën e fëmijëve të lëvizin në një shtet tjetër për t'u ribashkuar me familjen;
- Neni 10 njuh të drejtën e fëmijës që të kthehet në vendin e origjinës, nëse fëmija është i pashoqëruar.

Nene të tjera mbulojnë të drejta të tjera si mbrojtja nga forma të ndryshme të abuzimit, neglizhencës dhe shfrytëzimit, të cilat janë rreziqe për fëmijët në lëvizje, dhe të drejtën për mbrojtje sociale, etj.

Së bashku me parimin e mos-diskriminimit (më sipër), parime të tjera kyçe të mishëruara në KDF duhet të zbatohen gjithnjë për fëmijët në lëvizje. Sipas kësaj Konvente, Shtetet kanë detyrimin që të sigurojnë mbrojtjen për secilin fëmijë nga çdo formë neglizhence, abuzimi, dhune dhe shfrytëzimi. Në veçanti, fëmijët në lëvizje kanë të drejtën për t'u mbrojtur që të mos lëndohen fizikisht dhe mendërisht, nga abuzimi dhe neglizhenca (Neni 19), nga të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual (Neni 34), nga rrëmbimi, shitja dhe trafikimi i fëmijëve (Neni 35), si dhe nga çdo formë e shfrytëzimit që dëmton mirëqenien e fëmijës (Neni 36), dhe nga veprimet çnjerëzore, poshtëruese dhe ndëshkuese (Neni 37). Neni 39 i KDF-së, në veçanti parashikon se ka nevoja të domosdoshme për riaftësimin dhe ri-integrimin e fëmijëve viktimë të neglizhencës, abuzimit, ndëshkimit dhe poshtërimit, që zakonisht lidhen me fëmijët e pashoqëruar ose fëmijët e ndarë.

Parimi i interesave më të mira të fëmijës duhet të jetë elementi kryesor i të gjitha veprimeve që lidhen me fëmijët, përfshirë këtu zgjidhjet afatshkurtra dhe afatgjate (Neni 3, KDF). Ky parim duhet të respektohet gjatë gjithë fazave të ciklit të lëvizjes. Parimi i interesave më të mira për fëmijën përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me fëmijët, të ndërmarra ose jo nga institucionet

10 Fletorja Zyrtare, nr. 53. 2010. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Republikën e Shqipërisë, Nr. 10347, datë 4.11.2010.

publike apo private, organet ligjore, administrative apo organet vendim-marrëse. Rëndësia e këtij parimi është e dukshme në shumë situata me të cilat fëmijët në lëvizje përballen, si edhe kur shumë faktorë duhet të merren parasysh në marrjen e vendimit për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës. Në veçanti, për fëmijët në lëvizje, vendimet dhe masat e mbrojtjes duhet të jenë të mishëruara në një proces më të gjerë, më gjithëpërfshirës, me synimin për të përcaktuar interesat e tyre më të mira¹¹.

Në studimin e kryer në Shqipëri, disa fëmijë u shprehën se, edhe pse disa herë gjatë udhëtimit të tyre, ata mendonin se vendimi i prindërve nuk ishte zgjidhja më e mirë, tani, kur e shohin përvojën e tyre në përgjithësi, ata besojnë se vendimi që prindërit morën për të migruar, në fakt ishte mundësia e vetme që prindërit kishin për të siguruar kushte më të mira për jetët e tyre. Të gjithë fëmijët, përfshirë këtu edhe ata që prindërit nuk i kishin pyetur gjatë procesit të marrjes së një vendimi për të migruar, janë shprehur se prindërit e tyre e morën këtë vendim duke vepruar në interesin më të mirë të fëmijëve¹².

Bazuar në Nenin 22 të KDF-së, Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar një mbrojtje të veçantë dhe asistencë ndaj fëmijëve në lëvizje, të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në përputhje me të drejtat e zbatueshme ndërkombëtare të njeriut dhe instrumentet humanitare ligjore.

Komenti i Përgjithshëm Nr 6 (2005) për Trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës, botuar nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, organ i pavarur përgjegjës për të monitoruar zbatimin e KDF-së nga Shtetet Palë, ka një rëndësi të veçantë sepse ai siguron përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në lëvizje¹³. Për më tepër, Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 është i rëndësishëm sepse u jep autoriteteve udhëzime se si të sigurojnë dhe të promovojnë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë duke interpretuar disa nga dispozitat kyçe të KDF-së në kontekstin e këtyre dy grupeve fëmijësh.

Gjithashtu, KDF-ja bashkon dhe përforcon dispozitat e disa konventave të tjera ndërkombëtare që përbëjnë bazën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe të gjitha këto janë të zbatueshme për fëmijët në lëvizje.

Midis tyre, është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve (1951) dhe Protokollin shoqëruar për Statusin e Refugjatëve (1967), Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi (1954) dhe Konventa për Reduktimin e Pashtetësisë (1961), Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1965)¹⁴.

11 PFNE, *Deklarata e Praktikave të Mira. Botimi i 4 i Rishikuar, 2009, D9.*

12 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012.

13 Trajtimi i Fëmijëve të Pashoqëruar dhe të Ndarë Jashtë Vendit të tyre të Origjinës, te www.unhcr.ch.

14 Në këtë dokument, nuk përmenden instrumentat ligjor rajonal të zbatueshëm për fëmijët në lëvizje në Evropë.

Kuadri ligjor shqiptar

Shqipëria ka ratifikuar shumë Instrumente të rëndësishëm Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut në lidhje me fëmijët në lëvizje, por legjislacioni shqiptar deri më tani nuk u referohet fëmijëve në lëvizje si një kategori gjithëpërfshirëse. Gjithsesi, gjatë dhjetë viteve të fundit, Shqipëria ka miratuar një sërë ligjesh, strategjish dhe dokumente të tjerë të rëndësishëm, që krijojnë kornizën rregullatore për mbrojtjen e fëmijëve, nga i cili përfitojnë deri diku, edhe fëmijët në lëvizje. Më poshtë jepet një përmbledhje e ligjeve dhe strategjive kryesore për këtë çështje, ndërsa një listë e Instrumenteve kryesorë Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut, si edhe një përshkrim më i detajuar i kuadrit përkatës rregullator mund të gjendet në Shtojcën III të këtij raporti.

Ligji më i fundit dhe i një rëndësie të veçantë është Ligji Shqiptar Nr. 10347, mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (miratuar në nëntor, 2010) i cili përcakton kuadrin ligjor për ngritjen e mekanizmave të duhur në nivelet qendrore dhe vendore, të cilat sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre ndaj të gjithave formave të abuzimit, në përputhje me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës.

Aktualisht, janë hartuar akte nënligjore, të cilat do të përcaktojnë rolin e ministrive të linjës dhe të aktorëve të ndryshëm gjatë zbatimit të këtij ligji, si për shembull:

- ‘Mbi llojet dhe mënyrat e shkëmbimit dhe përpunimit të informacioni dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia dhe strukturat përgjegjëse shtetërore në nivel qendror dhe vendor’,
- ‘Mbi procedurat në lidhje me monitorimin dhe vendosjen e sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve’,
- ‘Mbi mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve publike përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe mënyrës së ndjekjes së rastit’
- ‘Mbi bashkëpunimin ndërmjet mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe organizatave jo-fitimprurëse’.

Për herë të parë Ligji parashikon një përkufizim për dhunën kundër fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve si ‘parandalim dhe reagim ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijës, duke përfshirë këtu rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktika të dëmshme tradicionale, siç janë gjymtimet gjenitale dhe martesat e fëmijëve’. Ligji përcakton mekanizmat përkatës në nivelin qendror, siç është ngritja e Këshillit Kombëtar të të Drejtave të Fëmijëve dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe mekanizmat në nivel vendor, që sigurojnë zbatimin efikas të mbrojtjes së këtyre të drejtave, në pajtueshmëri me Nenin 32 të KDF-së. Ligji parashikon krijimin e Njësisve të të Drejtave

të Fëmijëve (NJDF) në çdo distrikt (përmendur më poshtë si Qark) dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në çdo bashki dhe komunë. Neni 39, paragrafi 2 bën fjalë për krijimin e grupeve ndër-disiplinore për mbrojtjen, referimin dhe analizimin e rasteve të identifikuar, si pjesë e detyrave të kësaj njësie. Gjithashtu, Neni 38, paragrafi 2, shprehet për krijimin e grupeve ndër-disiplinore në nivelin e Qarkut, për mbrojtjen, referimin dhe analizimin e rasteve të identifikuar, si pjesë e detyrave të NJDF-së.

Protokolli i punës për PMF-të (2009)¹⁵ është një dokument që rregullon punën e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës (PMF) dhe raportet e tyre me partnerët përkatës, duke siguruar kështu një ndihmë të vazhdueshme dhe efikase për individët në nevojë (fëmijët, të rriturit dhe familjet). Ky protokoll e bën të qartë faktin se, midis detyrave të punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve përfshihet edhe identifikimi i fëmijëve në nevojë brenda komunitetit të tij, identifikimin e situatës së përgjithshme të fëmijëve në zonë, të përmbushjes së të drejtave të tyre dhe situatës së ofruesve të shërbimit për t'u përgjigjur nevojave të fëmijëve në zonën ku ata punojnë.

NJMF-të janë përgjegjëse për: a) identifikimin e fëmijëve të abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, trafikuar dhe në rrezik; b) mbrojtjen dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të identifikuar dhe të referuar, duke u ofruar shërbime të drejtpërdrejta dhe mbrojtje në bashkëpunim me strukturat përkatëse shtetërore dhe jo-shtetërore, në përputhje me interesat më të mirë të fëmijës; c) shpërndarja e informacionit dhe analizimi i rasteve, që kanë përfituar mbrojtje, me komunitetet vendore duke përdorur të dhëna të dokumentuara; d) promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Ndërhyrja e NJMF-së do të vazhdojë deri sa fëmija të konsiderohet si “jo në rrezik”.

Vendimi Nr. 265, i datës 12. 04. 2012, në mbështetje të Ligjit Nr. 10347, parashikon krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse shtetërore për të referuar rastet e fëmijëve në rrezik. Pika 5b thekson se komiteti mund të funksionojë *ad hoc*, dhe të mbështesë menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik që janë referuar nga NJMF-ja, nëse nevojat e rastit mund të mos adresohen tërësisht nga shërbimet ekzistuese ose kjo vlen për bashkitë/komunat që nuk kanë krijuar akoma një NJMF.

Urdhri i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe Ministrisë së Brendshme (MB), Nr. 125, dt. 23.08.2012 “për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit, ndiqet një qasje pune ndër sektoriale për të identifikuar dhe menaxhuar rastet e fëmijëve në rrugë.

¹⁵ Protokolli i Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në Shqipëri, UNICEF dhe Terre des hommes. 2010

Strategjia Kombëtare për Fëmijët, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 368, 31.05.2005, dhe Plani i saj i Punës (2005-2010) përfaqësojnë politikën zyrtare të qeverisë shqiptare ndaj të drejtave të fëmijëve. Dokumentet përfshijnë lloje të ndryshme masash që do të ndërmerren nga ministri të ndryshme, në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre. Kjo strategji është një dokument që përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për 2005-2010. Implementimi i Strategjisë është një detyrim ligjor për autoritetet përgjegjëse të qeverisë qendrore, por procesi i decentralizimit të kompetencave i ka dhënë edhe qeverisë vendore një rol shumë të rëndësishëm në procesin e institucionalizimit dhe respektimit të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ky rol parashtrohet nga pika 1.2 e Planit të Veprimit të Strategjisë, ku ‘krijimi i strukturave të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor’ theksohet si masë e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë kontekst, MMSR-ja si autoriteti qendror përgjegjës bashkërendues dhe monitorues i zbatimit të Strategjisë ka mbështetur iniciativën e UNICEF-it për krijimin dhe fuqizimin e NJMF-ve, si një strukturë e qeverisë vendore në funksion të një sistemi të qëndrueshëm kombëtar për mbrojtjen e fëmijës.

Më 13 Mars 2012 me **Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 182**, u miratua **Plani i ri i Veprimit për Fëmijët 2012-2015**. Plan Veprimi për Fëmijët është një dokument plotësues i Strategjisë Kombëtare për Fëmijët (2012-2015), i cili akoma përfaqëson politikën zyrtare të qeverisë shqiptare ndaj të drejtave të fëmijëve. Qëllimet strategjike dhe objektivat e Plan Veprimit të ri për Fëmijët ndjek politikat e përcaktuara në Strategjinë e mëparshme dhe ka në qendër dy çështje kryesore: 1) Forcimi i strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe rajonal; dhe 2) Promovimi dhe hartimi i politikave gjithëpërfshirëse, të bashkërenduara dhe të harmonizuara për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve. Plan Veprimi për Fëmijët kërkon krijimin e NJMF-ve në çdo bashki/komunë dhe zbatimin e VKM-së nr. 265, datë 12.04.2012, për krijimin dhe miratimin e metodologjisë së veprimit për NJMF-të, krijimin dhe funksionimin e grupeve ndër-disiplinore në qarqe, bashki dhe komuna për menaxhimin e fëmijëve në rrezik.

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2008-2010) ka si qëllim të eliminojë trafikimin e fëmijëve dhe të ndërtojë sistemet për integrimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë ngritjen e rrjeteve dhe sigurinë për fëmijët dhe familjet e tyre në nivel rajonal dhe vendor për t’u përgjigjur një gamë më të gjerë abuzimesh kundër fëmijëve, përfshirë edhe trafikimin. Më 2011, një raport që vlerëson zbatimin e Strategjisë për 2008-2010 u përgatit nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave për 2001-2013 u hartua dhe miratua nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 23.02.2011, si edhe dokumenti shtesë “Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2011-2013”. Këto dokumente të reja kanë në qendër katër shtylla: 1)

Hetimin dhe Ndjekjen Penale; 2) Mbrojtjen dhe Asistencën për Viktimat; 3) Parandalimin; dhe 4) Bashkërendimin ndërmjet Aktorëve. Strategjia e re ka si qëllim të përfundojë dhe të vejë në funksion të gjithë mekanizmat e mundshëm që ekzistojnë për të ndaluar trafikimin, duke ndjekur penalisht dhe dënuar çdo formë të shfrytëzimit të qenieve njerëzore, ndërkohë që mbron dhe ndihmon viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, kur këta të fundit bashkëpunojnë me agjencitë ligj zbatuese. Gjithashtu, parashikohen aktivitetet parandaluese që trajtojnë shkaqet rrënjësore të trafikimit si, varfëria, problemet sociale, mungesa e informacionit, arsimimi etj., si edhe aktivitete bashkërenduese të cilat do të vendosin rregull dhe një mekanizëm funksionues për zbatimin e plan veprimit, duke mobilizuar agjenci dhe partnerë të shumtë, të cilët do t'u përgjigjen fëmijëve dhe familjeve të tyre më mirë dhe me shërbime më të bashkërenduara për një gamë të gjerë të formave të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit dhe trafikimit në Shqipëri.

Për të përmirësuar identifikimin dhe ofrimin e ndihmës ndaj kategorive të ndryshme të viktimave të trafikimit, **Mekanizmi Kombëtar i Referimit** u nënshkrua në Tiranë, në vitin 2005 ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Rendit Publik (tani Ministria e Brendshme), Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, OJQ-së “Vatra”; “Tjetër Vizion” dhe Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).



IV. Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës në Shqipëri

Përvoja për mbrojtjen e fëmijëve gjatë viteve të tranzicionit ka dëshmuar nevojën për të ngritur një sistem gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve, i cili përfshin identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e të gjitha rasteve, pavarësisht kompleksitetit të tyre. Disa studime¹⁶ kanë treguar se aktualisht nuk ka ndonjë sistem në funksionim, por vetëm pjesë të tij. Qasja e bazuar në rast ose qasja me grup të synuar, pavarësisht arritjeve së saj, ka dëshmuar se, nëse problem nuk trajtohet në tërësinë e tij dhe nëse nuk hartohet një strategji parandalimi paralelisht me ndihmën dhe mbrojtjen e drejtpërdrejt dhe nëse problemi nuk trajtohet nga të gjitha aspektet, asnjë politikë apo strategji nuk do të jetë e mjaftueshme për të luftuar rreziqet me të cilat fëmijët përballen¹⁷.

Kjo lloj metodologjie zvogëlon arritjet për mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë të qëndrueshme, sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, po bëhen përpjekje për të ndërtuar një sistem mbrojtjeje që ndërmerr të kryejë këtë detyrë.

Deri më tani, këto përpjekje kanë krijuar dy mekanizma shumë të rëndësishëm, atë të mbrojtjes së fëmijës, i cili ka në qendër fëmijët që janë abuzuar ose në rrezik për t'u abuzuar, dhe mekanizmi kombëtar i referimit, i cili ka në qendër fëmijët viktimë/viktima të mundshme të trafikimit dhe kanë përfshirë disa aktorë të rëndësishëm. Të dy mekanizmat dhe aktorët përkatës janë paraqitur më poshtë. Duke u bazuar në faktin se këto dy mekanizma kanë zhvilluar procedura të ndryshme dhe kanë përfshirë aktorë të ndryshëm, më poshtë ata përshkruhen veçmas njëri-tjetrit. Megjithatë, është e rëndësishme që të theksojmë se të dy mekanizmat kanë në fokus: bashkëpunimin shumë disiplinor dhe me shumë aktorë, qasjen e menaxhimit të rastit dhe ndërhyrjen në nivelin vendor.

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

¹⁶ Studim vlerësimi për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, WorldVision, 2013; Analizimi i situatës për sistemin e mbrojtjes së fëmijës, BKTF, 2011; Situata e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Save the Children, 2012.

¹⁷ Studim vlerësimi për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, WorldVision, 2013.

○ Neni 32 i Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve _____ përcakton mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor dhe qendror.

Mekanizmat në nivel qendror përfshijnë:

1. Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
2. Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila bashkërendon punën në lidhje me çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
3. Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Mekanizmat në nivelin vendor përfshijnë:

1. Njësitë e të drejtave të fëmijës në këshillin e qarkut;
2. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në bashki/komuna.

Mekanizmat e nivelit qendror dhe vendor bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve. Bashkërendimi i aktiviteteve të tjera për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të parashikuara nga ky ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sipas ligjit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e fëmijëve bie mbi mandatin e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve, të cilat duhet të krijohen në secilën bashki/komunë. Që nga koha që njësia e parë e MF-së është krijuar më 2006, NJMF-ja është kthyer në një strukturë kryesore në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në nivelin vendor, i cili është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e një qasje më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve.

Megjithatë, kuadri ligjor gjithashtu shpreh se të gjithë aktorët dhe palët e interesuara kanë detyrim statusor për të mbrojtur fëmijët, dhe në veçanti të mbështesin punën e NJMF-ve. Kjo do të thotë se të gjitha agjencitë duhet të reagojnë ndaj situatave të abuzimit, nëse janë raste ekzistuese apo të dyshuara. Në praktikë, kjo nënkupton se të gjitha agjencitë duhet:

1. Të referojnë rastet te NJMF-ja nëse ka shqetësime për një fëmijë
2. Të mbështesin NJMF-në për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve
3. Të mbështesin punën e NJMF-së duke marrë pjesë në takime, në shqyrtimin e rasteve dhe në hartimin e zbatimit e planeve të përkujdesjes

Edhe pse nuk është e detyrueshme, rekomandohet që secila agjenci të identifikojë Pikat e Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijës në secilën komunë/bashki, kështu që komunikimi dhe bashkërendimi mund të bëhet më i lehtë në situatat e mbrojtjes së fëmijëve.

Standardet dhe procedurat



Edhe pse janë krijuar standardet dhe procedurat për të përmbushur rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve përkatës, që përmenden më poshtë kryesisht në Protokollin e Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve¹⁸ ato akoma nuk janë të detyrueshme. Megjithatë Protokollin është një dokument i rëndësishëm që drejton punën e aktorëve kryesorë të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në punën e tyre me fëmijët, përfshirë këtu edhe fëmijët në lëvizje. Ai përfshin vlerësimin e rrezikut, nevojat e fëmijëve dhe reagimin ndaj tyre nëpërmjet politikave publike dhe institucioneve qendrore, vendore dhe rajonale të shtetit shqiptar, në funksion të Mbrojtjes së Fëmijës. Përcaktimi dhe njohja më e mirë e të drejtave dhe detyrimeve që lindin, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dukuritë që ndikojnë në mirëqenien e tyre, merr një rëndësi të veçantë.

Protokollin është konceptuar për të ndihmuar të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët të cilët janë abuzuar, veçanërisht për stafin e departamenteve të administratës së qeverisë vendore, psikologët e shkollave, mësuesit, mjekët, infermierët, punonjësit social, policinë kufitare dhe policinë kundër trafikimit, punonjësit dhe vullnetarët e OJQ-ve që punojnë me fëmijët dhe familjet, stafin e çerdheve dhe kopshteve, por kryesisht për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve që punojnë në Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivelin e bashkive dhe komunave. Protokollin i Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve ka si qëllim të ndihmojë Punonjësit e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për të:

- Kuptuar se çfarë është mbrojtja e fëmijëve;
- Orientuar punën e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve që të përdorin një qasje të standardizuar;
- Paraqitur parimet e interesave më të mira të fëmijëve;
- Krijuar praktikën e punës shumë disiplinore për të mbrojtur fëmijët;
- Vënë në zbatim menaxhimin e rastit si një mjet për të identifikuar, punuar dhe rishikuar ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve;
- Krijuar një sistem të besueshëm të mbledhjes së të dhënave.

Protokollin i Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve përfshin një udhëzues hap pas hapi për veprimet dhe punën që Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës duhet të ndjek, kur identifikon një fëmijë apo merr një referim të një fëmije në rrezik abuzimi, lëndimi, neglizhimi apo shfrytëzimi. Protokollin përbëhet nga parimet dhe detyrat që orientojnë Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, nga praktika e menaxhimit të rastit që përfshin marrjen dhe ruajtjen e informacionit, si edhe nga vendosja e raporteve me aktorët e tjerë. Kohët e fundit, Protokollin është duke u rishikuar që të pasqyrojë ndryshimet e fundit në legjislacionin si për shembull ato të Kodit Penal, Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve, etj., si edhe t'u shërbejë të gjitha institucioneve dhe agjencive që

¹⁸ Protokollin i Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në Shqipëri. UNICEF dhe Terre des hommes. 2010.

merren me çështjet e mbrojtjes së fëmijës. Në rastin e fëmijëve në lëvizje, Protokollin mund të ndihmojë si një orientues për të identifikuar rreziqet nga abuzimi, trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve, hartimin e një plani individual nëpërmjet një qasje shumë disiplinore.

Rolet dhe përgjegjësitë e agjencive kryesore në lidhje me mekanizmat e mbrojtjes të fëmijëve, të përfshirë nga Protokollin i Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, përmbledhen në Shtojcën IV të këtij raporti.

Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat e trafikimit



- *Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit / Zëvendës Ministri i Brendshëm*
Kjo zyrë, e krijuar në Nëntor 2005, është pika kyçe për koordinimin e përpjekjeve kundër trafikimit në nivel ndër-ministor, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai gëzon një mandat të gjerë politik dhe një nivel të lartë pavarësie për të ndërmarrë iniciativat e nevojshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Autonomia e kësaj zyre sanksionohet me një vendim të kryeministrit.
- *Njësia Kundër Trafikimit në Ministrinë e Brendshme*
Njësia e Kundër Trafikimit mbikëqyret nga Koordinatorin Kombëtar kundër trafikimit, i cili është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare, për bashkërendimin me institucionet kryesore dhe mbledhjen e informacionit dhe të dhënave për këtë dukuri.
- *Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit*
Ky autoritet është krijuar nëpërmjet një urdhri të përbashkët të veçantë me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me qëllim që të forcojë bashkëpunimin dhe të krijojë një rrjet bashkëpunimi funksional dhe të konsoliduar. Ky autoritet bashkërendon procesin e referimit për ndihmën parësore dhe mbrojtjen e rehabilitimit afatgjatë të viktimave të trafikimit, bashkëpunon ngushtë me ministritë e sipër-përmendura dhe institucionet e tjera dhe strehëzat për viktimat e trafikimit. Të gjithë aktorët e përfshirë në këtë Autoritet luajnë një rol vendimtar dhe kanë përgjegjësi të barabarta në funksionet ndihmëse që ato ofrojnë.
- *Spektori për Luftën Kundër Trafikimit në Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe Migracionit*
- *Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Kundër Trafikimit*¹⁹

Shërbimet për viktimat e trafikimit tani ofrohen nga disa strehëza/qendra. Këto

¹⁹ Koalicioni përbëhet nga 4 qendra: Qendra Pritëse Kombëtare për Viktimat e Trafikimit - Tiranë, Tjetër Vizion - Elbasan, D & D (Të Ndryshëm të Barabartë) Tiranë dhe "Vatra" - Vlorë

qendra janë pjesë e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe trajtojnë të gjitha rastet që referohen nga ky mekanizëm.

- *Nën seksioni për të Drejtat e Fëmijëve te Avokati i Popullit*

- *Komitetet Rajonale Kundër Trafikimit*

Komitetet Rajonale Kundër Trafikimit u krijuan me Urdhër të Kryeministrit Nr. 139 datë 19.06.2006. Komitetet Rajonale Kundër Trafikimit dhe Tavolinat Teknike të Punës janë ngritur në 12 rajone. Këto organe drejtohen nga prefektët dhe përfshijnë kryetarët e bashkive, drejtuesit e Njësive të Shërbimeve Sociale, Zyrën e Punës, Policinë, Shërbimin Kombëtar të Informacionit, Shërbimin e Arsimit dhe Publikut në nivel Qarku. Përveç identifikimit, referimit dhe mbrojtjes për viktimat e trafikimit, Komitetet Rajonale monitorojnë situatën e trafikimit në rajonin e tyre dhe identifikojnë masat që duhen marrë për të luftuar këtë lloj krimi.

Standardet dhe procedurat

- Procedurat që orientojnë punën për fëmijët në lëvizje, me _____ qëllim që të referojnë rastet e fëmijëve të trafikuar ose në rrezik trafikimi ndodhen në dokumentin: **Procedurat Standarde të Veprimeve për të Identifikuar dhe Referuar Viktimat/Viktimat e mundshme të Trafikimit (i referuar më poshtë si PSV)**²⁰. PSV është hartuar nga Ministria e Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër-trafikimit në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse qeveritare dhe jo-qeveritare. PSV përmban kuadrin ligjor që mbështet punën në fushën e trafikimit njerëzor (përfshirë fëmijët) dhe një procedurë hap pas hapi për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. PSV ndjek një qasje ndër-sektoriale se si një fëmijë identifikohet, vlerësohet dhe referohet për kujdes dhe mbrojtje të mëtejshme. PSV-ja identifikon tre situata: a) kur rasti identifikohet jashtë Shqipërisë; b) kur rasti identifikohet në kufi, dhe c) kur rasti identifikohet brenda Shqipërisë.

Rolet dhe përgjegjësitë e agjencive kryesore në lidhje me trafikimin e fëmijëve, si përcaktohen nga PSV-ja janë përmbledhur në Shtojcën IV të këtij raporti.

²⁰ Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Mundshme të Trafikimit, Ministria e Brendshme e Shqipërisë dhe Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit, Shqipëria, 2011.

V. Fëmijët në Lëvizje në Shqipëri

Në këtë pjesë paraqiten karakteristikat e fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, shkaqet, modalitetet e lëvizjes dhe pasojat e saj.

Kush janë fëmijët në lëvizje në Shqipëri?

Siç u shpjegua në seksionet e mëparshme, asnjë dokument ligjor ose procedural në Shqipëri nuk i përmend apo i referohet grupit të fëmijëve në lëvizje si një kategori gjithëpërfshirëse. Pavarësisht faktit se aktorët kryesorë që merren me çështjet e fëmijëve nuk janë të njohur me këtë nocion, të gjithë kanë identifikuar grupet kryesore të fëmijëve që ndikohen nga lëvizja/shpërngulja. Grupet e identifikuara janë:

- Fëmijët që kanë migruar
- Fëmijët në situatë rruge
- Fëmijët e trafikuar
- Fëmijët rom ose egjiptian

Edhe pse të gjithë fëmijët mund të ndikohen nga lëvizja në Shqipëri, sipas përkufizimit të projektit Mario për shembull; fëmijët e larguar, këto grupe nuk u identifikuan nga burimet kryesore apo nga të dhënat dhe literatura lokale në dispozicion. Po ashtu, studimet e bëra deri më tani në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në vend, i referohen më shumë grupeve të përmendura më lart, edhe pse në mënyrë të fragmentizuar. Gjithsesi, këto studime nuk identifikojnë lëvizjen si faktor të përbashkët rreziku ose disa nga grupet e mësipërme. Gjithashtu, të dhënat ekzistuese për këto grupe janë të ndara, duke rritur kështu rrezikun e mbivendosjes së të dhënave, pasi fëmijët nga grupet e cënueshme mund t'i përkasin më shumë se një kategorie në të njëjtën kohë.

a) Fëmijët migrantë dhe të kthyer

Lëvizja e brendshme dhe ndërkombëtare e fëmijëve ka ekzistuar në Shqipëri që në fillim të viteve 1990, por deri më tani ka pak studime për fenomenin e fëmijëve në lëvizje dhe gjithashtu ka një mungesë të të dhënave të sakta rreth lëvizjeve brenda dhe jashtë vendit. Studimet e mëparshme për fenomenin e trafikimit dhe migracionit të pashoqëruar tregojnë se fenomeni ekziston dhe ka pasoja reale në jetën e fëmijëve Shqiptarë^{21, 22}.

21 Vlerësimi i trafikimit të fëmijëve përkrah kontrabandës në Shqipërinë veri perëndimore. Partnerë për Fëmijët. Orgocka, A. & Jasini, A. (2007).

22 Emigrimi ndërkombëtar i fëmijëve nga zonat rurale të Shqipërisë veri lindore. Te J. Kanics, D. S. Hernandez dhe K. Touzenis (Eds), Të emigrosh vetëm: Emigrimi i fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë në Evropë (fq. 129-142). Botimet UNESCO. Orgocka, A (2010).

Emigracioni – Duke filluar nga viti 1990 popullsia e Shqipërisë filloi të reduktohej, si pasojë e emigracionit masiv. Gjatë periudhës 2001-2011 (midis dy regjistrimeve të popullsisë) është vlerësuar se kanë emigruar 500 mijë persona. Ky fakt mbështetet edhe nga të dhënat e disponueshme të migracionit të marra nga disa prej vendeve kryesore destinacion të emigrantëve shqiptarë, si për numrin ashtu edhe për lëvizjet vjetore të tyre²³.

Edhe pse nuk ka të dhëna të disponueshme për numrin e fëmijëve që kanë migruar, të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë së vitit 2011 treguan se 21.356 fëmijë (banorë aktual nën moshën 19 vjeçare më 2011) janë kthyer nga vende të ndryshme në Shqipëri gjatë 10 viteve të fundit. Gjatë viteve të fundit numri i fëmijëve të kthyer është vazhdimisht në rritje, kjo mund të lidhet me krizat ekonomike në Greqi dhe Itali²⁴.

Edhe pse fëmijët e kthyer janë vlerësuar të jenë një grup në rritje, ata nuk janë identifikuar në studimin tonë nga burimet kryesore si një grup i veçantë të ndikuar nga lëvizja, çka tregon mungesën e ndërgjegjësimit për këtë kategori. Të dhënat e mbledhura nga intervistat²⁵ tregojnë se numri i fëmijëve të kthyer vetëm gjatë periudhës janar-shtator 2013 nga Greqia dhe Italia ka qenë përkatësisht 451 dhe 758 fëmijë.

Migrimi i brendshëm - Për herë të parë, sipas të dhënave të Regjistrimit të popullsisë në 2011, popullsia që jeton në zonat urbane ka tejkaluar numrin e popullsisë që jeton në zonat rurale. 53.5% e popullsisë jeton në zonat urbane dhe 46.5% të popullsisë jeton në zonat rurale. Kjo tregon se lëvizjet e brendshme të popullsisë kanë vazhduar në nivele të larta dhe jo vetëm gjatë periudhës 1990-2000, po edhe gjatë periudhës midis dy regjistrimeve të popullsisë (2001-2011) kryesisht nga zonat rurale në ato urbane. Në krahasim me censusin e parë, rreth 10.6% e popullsisë banuese ka ndryshuar vendbanimin e tyre brenda vendit, ndërsa 4% kanë deklaruar se në datën e censusit të parë ka qenë jashtë vendit²⁶.

b. Fëmijët në situatë rruge

Rezultatet e ‘Sondazhit Kombëtar të Punës së Fëmijëve në Shqipëri 2010’ (ILO 2012) tregojnë përhapjen e fenomenit të punës te fëmijët e moshës 5-17 vjeç, në nivelin 7.7%. Punësimi ka prirjen të rritet sipas moshës, ku djemtë përbëjnë përqindjen më të madhe të punëtorëve fëmijë (63.4%) në krahasim me vajzat. Një numër i konsiderueshëm i këtyre fëmijëve punojnë

në rrugë, si shitës, lypës apo shpërndarës droge; çka i lidh ata më shumë me lëvizjen.

23 Shqipëria: Censusi i Popullsisë dhe banesave 2011. INSTAT, (2012). http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf

24 Po aty.

25 Të dhëna të mbledhura nga intervista me përfaqësuesin e IOM.

26 Shqipëria: Censusi i Popullsisë dhe banesave 2011. INSTAT, (2012). http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf

Një vëmendje të veçantë në këtë nën-kategori fëmijësh u është kushtuar fëmijëve që lypin, si tregojnë studimet më të fundit, ata janë më shumë të pirur të migrojnë brenda dhe/ose jashtë për arsye ekonomike, pasi ata vijnë kryesisht nga familje shumë të varfra dhe grupe shoqërore të marxhinalizuar. Për shkak të këtyre karakteristikave, duke u bazuar edhe në vëzhgimet e mëparshme (ARSIS, 2011) vlerësohet se pjesa më e madhe e fëmijëve të ndikuar nga ky fenomen i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, dhe një numër i vogël i përkasin shumicës shqiptare, kryesisht ata që vijnë nga familje të varfëra të zonave rurale të Shqipërisë veriore. Edhe pse nuk ka asnjë të dhënë të saktë për numrin, moshën, gjininë, rreziqet dhe faktorët nxitës për fëmijët që lypin në Shqipëri, sipas Studimit Tipologjia e Politikave dhe Reagimet ndaj Lypjes së Fëmijëve në BE, disa tipare kryesore të këtij fenomeni mund të përmenden.²⁷

- Edhe pse mungojnë statistikat, vetëm gjatë periudhës korrik-gusht 2011 nga vëzhgimet në rrugët e Tiranës dhe Durrësit u identifikuan të paktën 420 raste të fëmijëve që lypin. (90 raste të raportuara nga Policia për periudhën janar 2010 – prill 2011; 587 raste të raportuara nga ARSIS vetëm në Tiranë për periudhën 2006-2010).
- Pjesa më e madhe e fëmijëve të përfshirë janë nga mosha 4 ose 5 vjeç deri sa bëhen 14 ose 15 vjeç, përsëri ka shumë raste të lypjes që OJQ-të kanë raportuar, ku janë përfshirë edhe foshnja të porsalindura vetëm dy-ditësh dhe fëmijë të vegjël 3 vjeçar.
- Mendohet se deri në moshën 12 vjeçare, fenomeni i lypjes të fëmijët ndikon në mënyrë të njëjtë të të dy gjinitë, për fëmijët mbi moshën 12 vjeçare ky raport ndryshon, ku djemtë përbëjnë 70% dhe vajzat 30%, kjo shpjegohet me rreziqet më të mëdha që vajzat adoleshente mund të jenë të ekspozuara në rrugë.

Sipas këtij studimi²⁸, fëmijët shqiptarë raportohen të jenë një nga grupet më të mëdha që janë të përfshirë në fenomenin e lypjes në vende të tjera, kryesisht Greqi, Itali dhe Kosovë. Kështu, në Kosovë të dhënat e ofruara nga Terre des hommes e Kosovës tregojnë se që nga fillimi i vitit 2007 deri në fund të muajit tetor 2010, 599 fëmijë lypsarë ishin identifikuar në të gjithë territorin e Kosovës, nga të cilët 196 ishin nga Shqipëria dhe 403 nga Kosova. Edhe pse pjesa më e madhe e fëmijëve ishin pjesë e komunitetit rom, kishte edhe fëmijë që nuk ishin rom.

c) Fëmijët e trafikuar

Sipas raportit më të fundit ‘Raporti i Trafikimit të Personave’ të nxjerrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit më 2013²⁹, Shqipëria vazhdon të konsiderohet si një vend burimi ku meshkujt, femrat dhe fëmijët janë subjekt i trafikimit seksual dhe punës së detyruar. Viktimat shqiptare i janë nënshtruar trafikimit seksual brenda Shqipërisë, si edhe në Greqi, Itali, Maqedoni, Kosovë, Belgjikë, Holandë, Gjermani, Zvicër, Irlandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Shumë gra kanë

27 Raporti për studimin Tipologjia e politikave dhe reagimet ndaj lypjes së fëmijëve në BE, Komisioni Evropian, 2012.

28 Po aty.

29 Raporti i Trafikimit të Personave. Departamenti i Shtetit, 2013.

qenë subjekt i trafikimit pasi kanë pranuar oferta punësimi si kamariere, banakiere, kërcimtare apo këngëtare në vendet fqinje, sidomos **në Kosovë, Greqi dhe Maqedoni.**

Fëmijët shqiptarë viktime të trafikimit kanë qenë kryesisht subjekt i lypjes dhe formave të tjera të punës së detyruar. Më 2013, nga një numër total i 138 viktimave që morën përkujdesje në strehëzat shtetërore dhe të OJQ-ve, 26 prej tyre ishin fëmijë. Raportet shprehin se pjesa më e madhe e viktimave ishin vajza nga familjet rurale me probleme sociale, si për shembull familje me prindër të divorcuar apo me përvoja të dhunës në familje³⁰.

Në një studim të fundit të vitit 2013³¹, rezulton se në Greqi, OJQ-të kanë regjistruar statistika në nivel vendor për lypjen e fëmijëve, dhe raportojnë se pjesa më e madhe e fëmijëve që vijnë nga komunitetet rom/egjiptian të Shqipërisë, kryesisht nga Shqipëria jugperëndimore dhe juglindore (Fieri, Vlora dhe Korça) nuk janë të dokumentuara. Më tej, siç raportohet në këtë studim, hulumtimet në Greqi kanë treguar ekzistencën e rrjeteve të trafikimit që sjellin fëmijët shqiptarë në Athinë dhe i shfrytëzojnë ata për të lypur. Edhe pse numri i fëmijëve që lypin në Greqi është dyfishuar gjatë dhjetë viteve 1999-2009, hulumtimet e bëra nga OJQ-të treguan se pas vitit 2004 është ulur niveli i trafikimit të fëmijëve shqiptarë nga një palë e tretë për t'i shfrytëzuar për lypje, por pas këtij viti kemi një përqindje më të lartë të fëmijëve të pashoqëruar dhe/ose të shfrytëzuar nga prindërit e tyre, që zakonisht janë të papunë.

Edhe pse, nga fillimi i viteve 1990, problemi kryesor në këtë drejtim kishte lidhje me trafikimin jashtë vendit, gjatë viteve të fundit trafikimi i brendshëm është kthyer në një çështje edhe më shqetësuese. Që nga viti 2004, tendenca e trafikimit të brendshëm është në rritje në mënyrë të qëndrueshme. Raporti i vajzave të trafikuar jashtë Shqipërisë, midis viteve 2004-2006, në krahasim me shfrytëzimin brenda Shqipërisë, ka qenë 80% me 20%; për periudhën 2007-2009 ky raport ka ndryshuar 50% me 50% dhe në 2010 ishte 30% me 70%³².

d) Fëmijët Rom

Komuniteti rom njihet si një nga pakicat etnike të Shqipërisë. Shifrat e popullsisë së këtij komuniteti ndryshojnë në bazë të raporteve të ndryshme, e për rrjedhojë nuk ka të dhëna të sakta për numrin e fëmijëve të këtij komuniteti. Sipas Strategjisë për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom në Shqipëri, pakicat e komuniteti rom dhe egjiptian kanë lëvizur brenda vendit dhe janë përqendruar kryesisht në qendër dhe juglindje të Shqipërisë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër, etj. Kjo lëvizje e shpeshtë e ka bërë të vështirë regjistrimin e pjesëtarëve të këtij komuniteti³³.

30 Raporti vjetor 2010, "Vatra" Qendër Psiko-Sociale, 2010.

31 Raporti për studimin Tipoplogjia e politikave dhe reagimet ndaj lypjes së fëmijëve në BE, Komisioni Evropian, 2012.

32 Po aty.

33 Raport i veçantë për problematikën dhe situatën e të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri, Avokati i Popullit, 2013; Situata e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Save the Children, 2012.

Edhe pse një pjesë e popullsisë dhe gjithashtu disa nga pjesëmarrësit në studimin tonë i lidhin lëvizjet e shpeshta të këtij komuniteti me traditat dhe zakonet e tyre, raportet tregojnë se lëvizja e tyre bazohet në kushtet e tyre të jetesës, të cilat karakterizohen nga varfëria, disavantazhet, niveli i ulët i punësimit dhe përjashtimi shoqëror³⁴.

Pavarësisht mungesës së të dhënave të sakta në Shqipëri për secilën nga kategoritë e mësipërme, të identifikuar sipas karakteristikave të grupeve dhe nga raportet e burimeve kryesore, numri i fëmijëve në lëvizje në Shqipëri nuk mund të jetë i barabartë me shumën e numrit të fëmijëve të secilës kategori. Kjo ndodh për shkak të mbivendosjes së të dhënave, sepse fëmijët e grupeve të pambrojtura shpesh mund të përjetojnë situata që mund t'i përfshijnë ata në shumë se një prej grupeve të mësipërme ose në të gjitha prej tyre.

* * *

Edhe pse fëmijët e larguar janë të përfshirë brenda grupit të fëmijëve jashtë mjedisit të mbrojtur, deri më tani në Shqipëri nuk ka të dhëna për këtë grup. Një nga arsyet për këtë mund të jetë se këta fëmijë konsiderohen brenda grupit të fëmijëve në situatë rruge. Në këtë studim, ne u përballëm me dy raste të fëmijëve të larguar, një prej tyre drejtpërdrejt dhe tjetrin nëpërmjet raportit të një burimi kryesor.

Modalitetet e lëvizjes dhe arsyet e saj

○ Pavarësisht karakteristikave të ndryshme të secilit grup, _____ burimet kryesore të studimit tonë raportuan ekzistencën e elementeve të përbashkëta, që mund të identifikohen si faktorë që sjellin migrimin e pasigurt të fëmijëve. Kështu, burimet kryesore raportuan se fëmijët që vijnë nga familjet me probleme sociale, të varfra, nga zonat rurale, dhe nga grupet e përjashtuara nga shoqëria (p.sh komuniteti rom) janë më shumë të prirur që të përfshihen në migrimin e pasigurt dhe të vuajnë pasojat negative. Disa nga këta faktorë u identifikuan edhe në dy raportet e mëparshme të fëmijëve në lëvizje³⁵.

Arsyet e lëvizjes, siç u raportua nga fëmijët dhe prindërit e tyre, ishin kryesisht të lidhura me karakteristikat e cënueshmërisë të identifikuar më sipër. Zakonisht vendimi për të lëvizur merret nga prindërit dhe fëmijët pothuajse nuk kanë qenë asnjëherë të përfshirë në procesin e marrjes së vendimit në lidhje me lëvizjen dhe modalitetet e saj. Shkaku kryesor i raportuar i lëvizjes për pjesën më të madhe të familjeve ishte varfëria dhe kushtet e vështira të jetesës, të cilat i detyronin familjet të lëviznin me qëllim që të mbijetonin.

³⁴ Po aty.

³⁵ Raport vëzhgimi: shfrytëzimi i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge në Kosovë, Mario 2010; Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012

‘Na duhej që të lëviznim herë pas here. Duhet të gjejmë një punë për të bërë.

Gjithëherë, të mënjetojmë për shkak të kushteve shumë të këqija të banimit ose për shkak të strehimeve të përkohshme të ndërtuara në zona jo të qëndrueshme, si vendet e përpunimit të plehrave, apo në brigje lumi.

‘Shtëpia jonë u shkatërrua për shkak të lumit. Muret u shembën, kështu që na u

dashur të largoheshim’ (Mashkull, 2 vjeç) të lidhet me problemet familjare, si për shembull divorci i prindërve ose vdekja e njërit prej tyre.

‘Nipi im shkon e vjen nga Kosova, sepse e ëma jeton atje. Por ai nuk jeton atje

më shumë se 2 orë në një ditë sepse ajo është martuar përsëri atje’ (Gjyhe) tyre, ish-in abuzimi dhe shfrytëzimi për punë nga prindërit dhe të afërmit.

Një **‘Të afërmit e përfaqësojnë familjen, nëse nuk u dëjtojnë’** (Mashkull, 7 vjeç) endshme. Shumë nga këto familje, meqenëse jetojnë në ndërtesa të përbashkëta apo të përkohshme (si pasojë e lëvizjeve të mëparshme nomade) shpesh zhvendosen nga autoritetet ose pronarët individë.

‘Ne jetonim afër lumit Lanë dhe ishte afër qendrës dhe tregut, kështu që e kishim më të lehtë për të gjetur punë. Tani që jemi këtu, është shumë e vështirë për të mbledhur kanaçe dhe të përballosh jetesën’ (Mashkull, 14 vjeç)

Lëvizjet e brendshme

- Sipas SDSHSH³⁶, pjesa më e madhe e migrantëve të brendshëm (30%) lëvizin / shpërngulen në drejtim të Tiranës, 10% në Durrës, 8% në Vlorë dhe 6% në Lushnje dhe Fier. Gjithashtu, SDSHSH-ja vlerëson se 33% e të gjithë migrantëve të brendshëm i përkisnin grup moshës 15-19 vjeçare në kohën e migrimit dhe 4.7% prej tyre ishin më të vegjël se 15 vjeç.

Pavarësisht kohës së gjatë apo mënyrës së qëndrueshme të lëvizjes, mund të thuhet se grupet më të cënueshme lëvizin në mënyrë më pak të planifikuar dhe më shpesh. Këto situatë përfshijnë rastet kur familjet lëvizin së bashku, për të ndjekur mundësitë e punësimit. Meqenëse këto lloj punësh zakonisht nuk janë të qëndrueshme, ata duhet të lëvizin përsëri pas një farë kohe.

‘Ne sapo kemi lëvizur. Më parë jetonim në Sharrë, por atje na ndaluan të mbledhim kanaçe. Kështu që duhet të lëviznim, pasi nuk kishim mënyrë tjetër për të bërë para.’ (Mashkull, 14 vjeç)

Situata të tjera përfshijnë edhe rastet kur, edhe pse familjet kanë një vend të qëndrueshëm për të jetuar, zakonisht, fëmijët më të mëdhenj të familjes me ose pa prindërit, mund të lëvizin për 3-4 ditë për punë afatshkurtër, si për shembull për të mbledhur kanaçe, etj., dhe të kthehen në shtëpi përsëri. Gjithashtu, mund të ndodhë dhe e kundërta në rastet kur prindërit lëvizin për pak ditë duke i lënë fëmijët pas vetëm në shtëpi.

‘Unë shkoj shpesh me burrin në Laç për 2-4 ditë për të mbledhur hekurishte. Jam e shqetësuar për fëmijët, por ata rrinë me njëri-tjetrin dhe më të mëdhenjtë janë mësuar që kur ishin të vegjël, që të kujdesen për më të vegjlit.’ (Prind rom)

Lëvizjet më të shkurtra janë ato ditore. Kështu, për shembull, në zonat e largëta rurale, fëmijët lëvizin për të shitur produktet bujqësore në tregjet kryesore; ndërsa gjatë verës, disa fëmijë lëvizin drejt zonave turistike për të lypur.

‘Kur patëm një projekt për të identifikuar fëmijët që punojnë në rrugë, kryesisht për të lypur, në vendet turistike, u habitëm kur gjetëm disa nga fëmijët tanë atje. Domethënë, fëmijë që ne u ofrojmë shërbime në qendrën tonë. Shumica e tyre udhëtonin gjatë verës çdo ditë drejt Durrësit së bashku me gjyshërit apo të afërm të tjerë.’ (OJQ)

Një lloj lëvizje tjetër është ajo sezonale, ku përfshihen lëvizje në të gjithë Shqipërinë, zakonisht

36 Shqipëria: studim demografik shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, 2010. demographic health survey, Institute of Public Health, 2010.

në zonat e mëdha urbane, drejt Vlorës dhe Sarandës, për shkak të mundësive më të mëdha për fitime të përkohshme, që lidhen më shumë me turizmin në verë dhe punën bujqësore. Një problem i veçantë që është ngritur në vitet e fundit, lidhet me disa familje me fëmijë, shumica rom që lëvizin për 2-3 muaj në Lazarat për të mbledhur kanabis. Sipas raporteve të OJQ-ve, këto familje janë të vendosura në Elbasan dhe Cërrik.

‘Vetëm gjatë periudhës Shtator-tetor 2013, kemi identifikuar 36 fëmijë nga 1-16 vjeç të komunitetit rom nga Cërriku që kanë lëvizur drejt Lazaratit’ (Profesionist i mbrojtjes së fëmijëve)

Lëvizjet e jashtme



Që nga viti 1990, në Shqipëri, ka filluar një prirje e ngjashme emigruese kryesisht drejt Greqisë (50%) dhe Italisë (35%), por edhe drejt MB (5%) dhe Gjermanisë (2%)³⁷. 3% e emigrantëve kanë lëvizur drejt vendeve të tjera evropiane. Arsyeja kryesore e lëvizjes ishte për të gjetur punë dhe vetëm disa prej tyre kishin si qëllim që të bashkoheshin me familjet jashtë apo të vazhdonin arsimimin atje. Gjatë viteve të para të kësaj lëvizje, meqenëse emigracioni ishte i paligjshëm, në shumicën e rasteve, individët, kryesisht meshkujt dhe djemtë udhëtonin vetëm dhe më vonë u ribashkuan jashtë me familjet e tyre nëpërmjet ribashkimit familjar.

Një tjetër fluks i rëndësishëm ndodhi në fund të viteve 90' dhe në fillim të vitit 2000, kur pas luftës së Kosovës një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kërkuan azil politik, duke pretenduar se ishin nga Kosova. Pasojat e kësaj lëvizjeje ishin të dukshme për vite me radhë, sepse këta individë ishin regjistruar me emra të rremë, duke u mohuar kështu nënshtetësinë fëmijëve të tyre të lindur gjatë asaj periudhe.

Qëllimi kryesor i këtyre lëvizjeve ishte krijimi i kushteve më të mira të jetës dhe një akses më të madh në shërbime. Gjatë viteve të fundit, fluksi migrator është ulur ndjeshëm, por tani me Shqipërinë në fazën e liberalizimit të vizave, një tjetër fenomen është rishfaqur, ai i kërkimit të azilit politik në disa vende evropiane. Siç u përmend më sipër, në rastin e fëmijëve që kërkojnë azil politik, një pasojë e kësaj lëvizjeje është pamundësia për të vizituar vendin e origjinës, për të takuar të afërmit dhe miqtë që kanë lënë pas.

Në lidhje me lëvizjen e jashtme, fokusi i raportit tonë mbetet në dukuritë e lëvizjes së fëmijëve në vendet fqinje për periudha të shkurtra kohe. Një numër i madh fëmijësh, kryesisht rom, lëvizin me të gjithë familjen ose një pjesë të saj drejt Kosovës, Malit të Zi për qëllime lypjeje, ose ndonjëherë për ndonjë punë tjetër që nuk është e përshtatshme për moshën e tyre.

37 Shqipëria: sondazh shëndetësor demografik, Instituti i Shëndetit Publik, 2010.

Lëvizja drejt këtyre vendeve është raportuar si më e lehtë, për shkak të kufirit tokësor dhe

‘Ne jetonim në Shkodër, por djemtë (14-16 vjeç) shkonin në Podgoricë (Mal të Zi) vetëm, që të punonin në tregun e qytetit.’ (Baba, komuniteti rom)

policisë kufitare më neglizhente. Për sa më sipër, hulumtime të mëparshme kanë treguar se 2/3 e fëmijëve që lypin në Kosovë janë shqiptarë, kryesisht nga komuniteti rom³⁸.

Qytetet më të lakmuara për fëmijët shqiptarë në situatë rruge në Kosovë janë Prizreni, Prishtina, Gjilani dhe Peja. Fëmijët e moshës nga 0-5 vjeç lëvizin me një prind, ndërsa fëmijët mbi 5 vjeç lëvizin me bashkëmoshatarët e tyre³⁹.

Kështu, pjesa më e madhe e prindërve, por edhe disa fëmijë në studim raportuan se kalimi i kufirit është më të vërtetë i lehtë për shkak të kontrollove të neglizhuara, sidomos për komunitetin rom, por edhe për shkak të kostove më të ulëta të transportit dhe kontrolleve më të pakta të policisë gjatë qëndrimit të tyre:

Pjesa më e madhe e fëmijëve të intervistuar që kanë qenë në Kosovë, kanë raportuar se

‘Unë shkova me mamanë dhe gjyshin disa herë (në Kosovë)... ata kurrë nuk na nxorën ndonjë problem kur kalonim kufirin, sepse e shikonin se kishim të njëjtin mbiemër.’ (Femër, 12 vjeç)

‘Nuk është e vështirë për të kaluar në anën tjetër, edhe kur je vetëm, sepse ata i mbledhin mjetet e identifikimit njëherazi dhe i vulosin të gjitha së bashku.’ (Mashkull, 17 vjeç)

zakonisht kanë qëndruar për disa muaj dhe janë kthyer, dhe shpesh kanë lëvizur nga një qytet në tjetrin brenda territorit të Kosovës.

Pasojat e lëvizjes

‘Kam qenë në Prishtinë, Prizren, Gjilan, por më shumë më pëlqen Prizreni.’ (Vajzë, 11)

‘Shumica e fëmijëve që lëvizin drejt Kosovës, zakonisht nisen rreth muajit Maj-Qershor dhe kthehen në tetor. Kjo është periudhë e mirë sepse emigrantët kthehen në Kosovë dhe moti është i mirë.’ (OJQ)

38 Raport studimi i tipologjisë së politikave dhe reagimit për lypjen e fëmijëve në BE, Komisioni Evropian, 2012.

39 Raport vëzhgimi: shfrytëzimi i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge në Kosovë, Projekti Mario 2010.



Pavarësisht modaliteteve të lëvizjes, fëmijët gjithnjë ndikohen nga lëvizja me pasoja negative dhe pozitive. Lëvizjet migratore të qëndrueshme, kur e gjithë familja lëviz për një periudhë kohe të gjatë, shpesh ndiqen nga kushte më të mira të jetës dhe akses më të madh në shërbime, por kjo nuk mund të përgjithësohet. Duke u bazuar në këtë përgjithësim, profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve ndonjëherë e nënvlerësojnë peshën që migrimi ka për këta fëmijë, si p.sh. humbja e mjedisit të njohur, lidhjeve familjare, miqve, dhe vështirësitë për t'u përshtatur. Gjithashtu, fëmijët përfitojnë nga lëvizja, duke mësuar aftësi të reja, siç edhe është raportuar nga studimet e mëparshme.⁴⁰

Regjistrimi



Shpesh, një pasojë e lëvizjes lidhet me problemin e regjistrimit civil në zonën e re ku familja është shpërngulur. Procedura e transferimit të regjistrimit civil nga një administratë vendore e vendit të origjinës në vendin e mbërritjes është e gjatë, procedurë administrative jo koherente që në vetvete përjashton mundësinë e disa grupeve të individëve apo fëmijëve të gëzojnë të drejtën e regjistrimit. Kjo ndodh sepse kriteret e regjistrimit përfshijnë paraqitjen e dokumentit të pronësisë së shtëpisë (dhe/ose kontratën e qerasë); dokumentin e punësimit dhe një librezë kursimesh. Mungesa e regjistrimit civil sjell si pasojë e aksesit të kufizuar në shërbimet shëndetësore dhe të arsimit, programet e mbrojtjes sociale, skemat e asistencës financiare etj., por edhe vështirësi për të pasur akses në institucionet e tjera publike.

'Ata më thonë që të aplikoj në zyrën e punës, por duhet të kesh një certifikatë origjinale ose të noterizuar. Kjo do të thotë që të shkoj në Korçë vetëm për të marrë një certifikatë, dhe të shpenzoj para.' (Baba, komuniteti rom)

'Pavarësisht faktit se familjet rome janë shpërngulur në një kamp të improvizuar në qarkun tonë shumë vite më parë, ne kemi regjistruar vetëm gjysmën e tyre, dhe gjysma tjetër vazhdojnë të marrin asistencën financiare në Elbasan.' (Përfaqësues i qeverisë vendore)

Një problem i veçantë i komuniteteve që lëvizin shpesh ka qenë mos regjistrimi i lindjeve të fëmijëve. Sipas një studimi të UNICEF i vitit 2012, përqindja e regjistrimit të fëmijëve në Shqipëri gjatë 2005-2010 ka qenë midis 98-99%⁴¹. Veçanërisht, hartëzimi i fëmijëve rom në Shqipëri që u bë në vitin 2011, përllogariti se rreth 5.7% e fëmijëve të familjeve që morën pjesë në sondazh nuk janë të regjistruar në lindje dhe për këtë arsye mbeten të padukshëm dhe të

40 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012.

41 Gjendja e fëmijëve në botë 2012: Fëmijët në një Botë Urbane, UNICEF, 2012.

përrjashtuar nga shërbimet⁴².

Ky fakt është interpretuar shpesh nga profesionistët si neglizhencë prindërore, ndërsa për prindërit, mos regjistrimi u lidh me problemet e tyre (fëmijë jashtë martesë, braktisja e fëmijëve nga prindërit dhe të afërmit kujdeseshin për ta, etj.) ose me vetë lëvizjen, pasi ka qenë e pamundur që ata të shkonin në zonën e vendbanimit të tyre të mëparshëm brenda kohës së nevojshme, ose për shkak të shpenzimeve të udhëtimit⁴³. Mos regjistrimi i fëmijëve, siç është përmendur në nën-seksionin e mësipërm, u raportua që të kishte ndodhur gjithashtu, edhe në rastet kur familjet ishin shpërngulur jashtë shtetit ku kishin kërkuar azil duke pretenduar se janë nga Kosova dhe kishin ndryshuar emrat e tyre.

Edhe pse shumë nga këto probleme ishin zgjidhur nëpërmjet ndryshimeve dhe përmirësimeve të ndryshme të kuadrit rregullator, si për shembull Ligji ‘Mbi Gjendjen Civile’ të vitit 2009 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Brendshme i vitit 2010 ‘Mbi Referimin dhe Regjistrimin e Aktit të Lindjes të Personave që Rezultojnë të Paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit Kombëtar’, si edhe një marrëveshje ndërmjet aktorëve të ndryshëm e nënshkruar në qershor të vitit 2012, e cila i lejon prindërit të regjistrojnë fëmijët e tyre, pavarësisht moshës, apo mungesës së certifikatës së lindjes, ose nëpërmjet verifikimeve të nevojshme. Burimet kryesore gjithashtu raportuan se për një numër të vogël fëmijësh këto probleme akoma ekzistojnë.

‘Në komunitetin rom ku punoj, ka akoma fëmijë të paregjistruar, sepse ata jetojnë me gjyshërit dhe nëna i ka braktisur. Gjyshërit nuk mund t’i regjistrojnë ata, as si nipërit e tyre.’ (Staf, OJQ për fëmijët në situatë rruge)

Një problem tjetër i identifikuar gjatë periudhës së fundit lidhet me disa vështirësi që fëmijët shqiptarë të lindur në Greqi përballen për dokumentet e tyre të njoftimit apo pasaportat e lëshuara nga autoritet shqiptare. Këto vështirësi lidhen me faktin se emrat e qyteteve janë shkruar në shqip dhe nuk njihen nga autoritetet greke, dhe për këtë arsye ata shpesh hasin pengesa kur kalojnë kufirin ose kanë vështirësi për akses të plotë në shërbime në Greqi.

Arsimi



Niveli i përgjithshëm neto i regjistrimit në arsimin parashkollor në Shqipëri mbetet i ulët në nivelin 59%, ndërsa niveli i regjistrimit neto në arsimin bazë raportohet të jetë 89-91% gjatë periudhës 2005-2010⁴⁴. Veçanërisht për fëmijët rome, janë identifikuar dy probleme kryesore nga raportet e mëparshme: a) shkalla e ulët e regjistrimit dhe b) shkallë e lartë e braktisjes

42 Hartëzimi i Fëmijëve Rom në Shqipëri, UNICEF Shqipëri, 2011

43 Raport Vlerësimi për Problemet që Vijnë nga Mos-regjistrimi i Lindjeve të Fëmijëve Rom, TLAS. 2006

44 Situata e fëmijëve bë botë 2012: Fëmijët në një Botë Urbane, UNICEF, 2012.

së shkollës para përfundimit të vitit akademik, çka kontribuon, në nivelin e përgjithshëm të analfabetizimit të fëmijët rom me 34%⁴⁵. Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm i familjeve romë është identifikuar si një nga faktorët kryesorë që ndikon negativisht në arsimimin e fëmijëve, të cilët në pjesën më të madhe të rasteve e braktisin shkollën gjatë vitit akademik ose e ndërpresin plotësisht arsimimin e tyre⁴⁶.

Po kështu, pengesat kryesore të raportuara në këtë studim nga palët e interesuara, prindërit dhe fëmijët në lidhje me regjistrimin në shkollë, është mungesa e regjistrimit në lindje, dhe paftësisë financiare të prindërve për të përballuar shpenzimet e ndjekjes së shkollës.

Siç kanë shprehur edhe studime të tjera, edhe pse një numër i madh i fëmijëve është regjistruar, ka akoma fëmijë që nuk janë regjistruar për shkak të ndërlikimeve në rastet e tyre, për shembull kur prindërit nuk janë të regjistruar ose kur prindërit deklarojnë qëllimisht të dhëna personale të rreme. Gjithsesi, Ministria e Arsimit (MA) i pranon fëmijët në shkollë edhe pa dokumente, por ata regjistrohen në një regjistër të veçantë të klasës, i cili nuk e garanton mundësinë e vazhdimin të arsimimit të tyre edhe pas arsimit të detyrueshëm⁴⁷.

‘Edhe pse thonë që çdo fëmijë gëzon të drejtën e arsimimit dhe se arsimi bazë është i detyrueshëm, në shumicën e rasteve që kemi menaxhuar, jemi përballur me vështirësi në regjistrimin e fëmijëve në shkollë pa certifikatë lindjeje’ – (OJQ)

Raporti i UNICEF-it i vitit 2011, thekson se 32% e fëmijëve që kanë braktisur shkollën pranojnë se arsyeja kryesore që ata nuk e kanë ndjekur shkollën është mungesa e burimeve për të mbuluar shpenzimet⁴⁸. Kjo arsye është raportuar si një faktor kryesor edhe nga disa fëmijë që u intervistuan për këtë analizë të situatës, ku kostot e ndjekjes së shkollës ishin të lidhura me distancat e largëta të shkollës nga zonat e tyre jo formale të strehimit (kryesisht për fëmijët rom) ose me faktin se ata duhet të punojnë me qëllim që të përballonin jetesën.

Gjithashtu, shumica e fëmijëve kanë shprehur se kur ata kanë lëvizur brenda ose jashtë vendit

‘Nuk shkoj më në shkollë. Më pëlqen të shkoj në shkollë, por që kur jemi shpërngulur në shtëpinë tonë të re, shkollë është shumë larg dhe më duhet të kap dy autobusë që të shkojë në shkollë. (Femër, 10 vjeç)

‘Unë nuk shkoj në shkollë. Më mirë të ndihmoj babin që të mbledh kanaçe.’ (Mashkull, 13 vjeç)

45 Analizimi i situatës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, BKTF, 2011.

46 Raporti vjetor (2011-2012) i monitorimit të zbatimit të ligjit “për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, ASHMDF, 2012.

47 Po aty.

48 Gjendja e të drejtave të fëmijëve, Save the Children, 2012.

për periudha kohore deri më 1 vit, ata kurrë nuk shkonin në shkollë. Zakonisht ata rrinin në shtëpi për t'u ndihmuar prindërve në punë.

'Kur u shpërngulëm dhe jetuam për një vit në Korçë te gjyshërit tanë, nuk shkova në shkollë. E kaloja kohën duke luajtur me kushërinjtë e mi ose duke ndihmuar babin te tregu.' (Mashkull, 13 vjeç)

'Kam përsëritur të njëjtën klasë dy vjet, sepse në të dy vitet në prill shkova me familjen time në Kosovë.' (Mashkull, 15 vjeç)

Pjesa më e madhe e fëmijëve që kanë qenë jashtë shtetit për një kohë më të gjatë, si emigrantë të rregullt, kanë raportuar se kanë ndjekur shkollën atje, por në shumicën e rasteve nuk e kanë ndjekur shkollën kur janë kthyer, pasi ju është dashur të shpërnguleshin në vende të ndryshme, deri sa u stabilizuan.

'Kam lindur në Greqi dhe atje shkoja në shkollë. Por kur erdhëm në Shqipëri, nuk shkova në shkollë një vit, sepse ikëm në Korçë dhe Fier për të jetuar me gjyshërit para se të vinim në Tiranë.' (Femër, 12 vjeç)

'Djali im më i vogël shkoi në shkollë në Itali për 8 vjet. Por kur u kthyem në Shqipëri, ai humbi dy vite pasi ne lëvizëm në qytete të ndryshme. Kur e vendosëm që të qëndronim në Tiranë, ai nuk donte të ikte më në shkollë, as për të mbaruar arsimin bazë, sepse i vinte turp të kthehej në klasën e shtatë me fëmijë më të vegjël. E kuptoj atë shumë mirë.' (Nënë)

Shëndetësia



Pothuajse 50% e popullsisë në Shqipëri ka akses të kufizuar ndaj shërbimeve cilësore shëndetësore. Raportet e mëparshme kanë identifikuar probleme të ndryshme në këtë drejtim, veçanërisht për fëmijët e grupeve të cënueshme⁴⁹.

Kryesisht, fëmijët në situatë rruge dhe nga komuniteti rom përballen me pengesa të ndryshme që me sa duket lidhen me lëvizjet e tyre. Raportohet se 76% e romëve, në krahasim me 93% të popullsisë jo rome janë vaksinuar për poliomielitin, difterinë, tetanosin dhe kollën e mirë⁵⁰. Kjo lidhet me lëvizjen dhe mos regjistrimin e lindjeve apo në regjistrin civil të fëmijëve dhe

49 Analiza esituatës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, BKTF, 2011. Gjendja e të Drejtave të Fëmijëve, Save the Children, 2012.

50 Hartëzimi i Fëmijëve Rom në Shqipëri, UNICEF Shqipëria, 2011.

familjeve të tyre që kushtëzon aksesin në shërbime bazë.

Ndërkohë që është e vështirë për të pasur akses falas në shërbimet parësore të kujdesit

‘Nuk mund të shkoj te mjeku i familjes për recetë, sepse do të më duhet të blej ilaçe. Ai më ka shpjeguar se nuk mund t’i marrë falas, sepse nuk jam banor këtu.’

(Nënë, komuniteti rom)

shëndetësor, shërbimet e urgjencës (spitalet) nuk u mohohen të gjithë personave pavarësisht përkatësisë së tyre administrative dhe faktit se kanë apo jo dokumentet e regjistrimit. Zakonisht fëmijët që paraqiten në spitale në gjendje apo simptoma shumë të rënda shëndetësore, ndodhen aty për shkak të aksesit të munguar ndaj kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor. Asnjë nga pjesëmarrësit nuk raportoi se ju është refuzuar kujdesi kur kanë kërkuar një shërbim

‘Kur ke nevojë me të vërtetë për një doktor, duhet të shkosh te urgjenca. Ata nuk të kërkojnë asnjëherë dokumente.’ (Nëna e një fëmije në situatë rruge)

shëndetësor.

Në raste të tilla, problemi kryesor i raportuar nga prindërit kishte lidhje me burimet e kufizuara

‘Nëse je rom ose i varfër, ata kurrë nuk ta refuzojnë shërbimin. Ata e dinë që ne nuk kemi para.’ (Mashkull, 17 vjeç)

financiare për të blerë ilaçet e rekomanduara nga mjekët.

Në shumicën e rasteve, problemet shëndetësore të fëmijëve u raportuan të kishin lidhje me

‘Mjeku më tha se kishte të ftohur të rëndë dhe kishte nevojë për antibiotikë dhe të hante siç duhet. Nuk kam para për asnjërin prej tyre. Nëse do të isha i regjistruar këtu, të paktën mund të blija ilaçet.’ (Nënë, komuniteti rom)

kushtet e këqija të jetës, kequshqyerjen ose me kushtet e këqija të punës apo të situatës në rrugë, e raportuar edhe nga studimet e mëparshme⁵¹.

Shfrytëzimi

Rastet e trafikimit të brendshëm dhe ndërkombëtar për qëllime shfrytëzimi për punë janë të shumta⁵². Format më të këqija të punës së fëmijëve në Shqipëri mund të ndikojë fëmijët e grupeve të cënueshme, si për shembull fëmijët e rrugës dhe fëmijët e trafikuar⁵³. Një nga

51 Raport vëzhgues: shfrytëzimi i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge në Kosovë, projekti Mario 2010. Fenomeni i fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012.

52 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansve të Barabarta. 2010. Raport Vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, Tiranë.

53 Situaata e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Save the Children, 2012.

format e shfrytëzimit të fëmijëve është lypja e detyruar. Rreziqet kryesore që fëmijët në situatë rruge të përfshirë në lypje përballen janë: niveli i lartë i vdekshmërisë për shkak të keqshqyerjes dhe mungesës së një strehe duke qenë të ekspozuar ndaj kushteve ekstreme të motit; ata vuajnë përjashtimin social dhe diskriminimin dhe vazhdojnë të jenë shumë të ekspozuar ndaj formave të tjera të ashpra të shfrytëzimit, adoptimit të paligjshëm, rrëmbimit dhe trafikimit⁵⁴.

Sikurse u shpreh nga raporti i mëparshëm Mario⁵⁵, ka raste të disa prej këtyre fëmijëve

‘Njerëzit mendojnë meqenëse je rom, ata mund të të ngacmojnë ose të japin para për të bërë seks me ata.’ (Femër, 17 vjeç)

shqiptarë në situatë rruge në Kosovë, që janë abuzuar fizikisht dhe keqtrajtuar nga prindërit e tyre dhe të afërmit më të rritur, nëse fëmijët nuk sjellin shumën e parave që pritej prej tyre.

‘Nuk mund të shkoj në shkollë. Më duhet të punoj; përndryshe do të kem probleme në shtëpi’ (Mashkull, 11 vjeç)

‘Më mirë të shkoj në Kosovë. Fiton 5,000 lekë në pak orë, dhe kështu mund të shkosh në shtëpi më herët. Këtu (në Tiranë) duhet të rri gjithë ditën në rrugë për të sjellë kaq shumë lekë në shtëpi.’ (Mashkull, 13 vjeç)

Nga ana tjetër, studimet gjithashtu kanë treguar se fëmijët që lypin shpesh janë subjekt i dhunës së policisë, këta të fundit i konsiderojnë ata si një problem që duhet zgjidhur duke i përzënë nga rruga dhe nga vendi (në rastin e fëmijëve që lypin në vendet fqinje) sesa si raste të shfrytëzimit dhe neglizhencës për t’u referuar për shërbime sociale⁵⁶. Në shumë raste, fëmijët raportuan të njëjtin qëndrim edhe nga oficerët e policisë në Kosovë.

‘Në Kosovë, duhet të tregonim shumë kujdes se policia mund të vinte në çdo moment dhe na ndiqte. Në këtë rast do të na kthenin mbrapa... jo vetëm mua por të gjithë familjen.’ (Femër, 11 vjeç)

‘Një herë në Prizren, policia më kapi dhe më çoi në komisariat. Më morën në pyetje për dy orë, por e dija që nuk duhet t’u tregoja për familjen time. Kështu, pas dy orësh më lanë të lirë.’ (Mashkull, 13 vjeç)

54 Raport studimi i tipologjisë së politikave e reagimeve ndaj lypjes së fëmijëve në BE, Komisioni Evropian, 2012.

55 Raport Vëzhgimi: shfrytëzimi i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge në Kosovë, Mario 2010.

56 Daniela Reale, “Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje: Përkthimi i parimeve në praktika”, te IOM, *Fëmijët në lëvizje*, 2013.

6. Reagimi Aktual i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve për Fëmijët në Lëvizje

Pas paraqitjes së karakteristikave të fëmijëve në lëvizje në Shqipëri dhe modaliteteve e pasojave që lëvizja ka për ata, në këtë pjesë do të përpiqemi të analizojmë reagimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për të adresuar nevojat e tyre.

Gjatë viteve të fundit, përkrah tendencave ndërkombëtare edhe Shqipëria është zhvendosur nga një qasje e bazuar në rast për të programuar mbrojtjen e fëmijëve drejt një qasje sistematike të mbrojtjes së fëmijëve, sepse e para nuk ishte e qëndrueshme dhe nuk trajtonte situatën e të gjithë fëmijëve në rrezik abuzimi. Në Shqipëri, dy aktorët kryesorë të sistemit të mbrojtjes që mund t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve në lëvizje janë: njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat e trafikimit. Për këtë arsye këto do të jenë fokusi kryesor i këtij shqyrtimi në termat e kapaciteteve, përshtatshmërisë dhe gjithëpërfshirjes.

Kapaciteti dhe Përshtatshmëria e Reagimeve të SMF-së

Kjo pjesë analizon kapacitetin dhe përshtatshmërinë e reagimeve të SMF-së përsa i përket, identifikimit, referimit, vlerësimit, ndërhyrjeve dhe _____ ndjekjes së rasteve të fëmijëve në lëvizje.

Modeli i njësive të mbrojtjes së fëmijëve gjatë viteve të fundit ka filluar që të përdoret dhe tani ato janë kthyer në një element kyç për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Ngritja dhe funksionimi i NJMF-ve, nuk përbën në vetvete një sistem kombëtar të mbrojtjes së fëmijëve, i cili përfshin përpjekjet e të gjithë sektorëve, të strukturuar, brenda udhëzimeve të qarta legislative dhe politike, me një kapacitet të duhur stafi dhe burimesh, që punojnë në harmoni për mbrojtjen e fëmijëve dhe promovimin e mirëqenies së tyre.

Gjithsesi, NJMF-të janë njësi unike për identifikimin, referimin dhe trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve në nevojë në nivel vendor⁵⁷. Ato janë konceptuar, si struktura të specializuara që ofrojnë mbështetje dhe bashkërendojnë shërbimet për rastet e fëmijëve në nevojë mbrojtjeje,

⁵⁷ Studim vlerësues i njësive të mbrojtjes së fëmijëve, WorldVision, 2013.

të cilët janë në rrezik apo subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhencës, përjashtimit shoqëror, trafikimit, shfrytëzimit dhe dukurive të tjera që kërcënojnë mirëqenien e fëmijëve në lëvizje. Këto shërbime ofrohen nëpërmjet një qasje ndërdisiplinore, me punonjësin e mbrojtjes së fëmijëve koordinator të grupit ndër disiplinor i përbërë nga partnerët vendorë, përfaqësuesit e shëndetësisë, policia, sektorët e drejtësisë dhe arsimit, shërbimi rajonal shoqëror, shërbimi bashkiak shoqëror, dhe organizatat jo fitimprurëse të zonës.

Vlerësimi më i fundit i Strategjisë Shqiptare për Përfshirjen Sociale 2007-2013⁵⁸ arriti në konkluzionin se shërbimet e sistemit të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve kanë mangësi në identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme psiko-sociale dhe ekonomike për fëmijët në rrezik dhe familjeve të tyre. Për më tepër, fëmijët rom janë identifikuar si një grup veçanërisht i rrezikuar për përjashtimin shoqëror. Gjithashtu, Strategjia nuk u referohet fëmijëve në lëvizje me një term gjithëpërfshirës, por i identifikon veçmas si grupe të cënueshme. Lëvizja në vetvete nuk përmendet asnjëherë si një tregues i rrezikut dhe nevojës potenciale për shërbime.

Në Shqipëri, janë kryer disa studime vlerësuese për punën e NJMF-ve (më i fundit, ai i vitit 2013⁵⁹). Këto studime pasqyrojnë ndryshimet dhe zhvillimet e funksionimit të NJMF-ve gjatë viteve të fundit. Një studim i vitit 2009, ka renditur disa sfida, por në përgjithësi ka nxjerrë si përfundim se modeli i NJMF-së ka funksionuar⁶⁰. Në rekomandimet e tij, studimi sugjeroi vlerësimin e mundësisë për të shtuar grupe të tjera të cënueshme në sistemin e referimit të NJMF-së, si për shembull emigrantët dhe familjet emigrante të kthyer dhe pakicat e marxhinalizuara. Shtrirja e ofrimit të shërbimit për një gamë më të gjerë përdoruesish të cënueshëm do të ishte një “vlerë e shtuar” për shërbimin dhe do të zgjeronte e thëllonte Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve duke e kthyer në një lehtësi më të përgjithshme e shërbimeve sociale.

Raporti i BKTF-së i vitit 2011⁶¹ thekson qasjen sistematike dhe shumë disiplinore të modelit të ngritur të NJMF-së, si një model që duhet të adresojë të gjithë fëmijët që përballen me rreziqe dhe kanë nevojë për mbrojtjeje dhe ka rezultuar efikas, edhe pse është i ri dhe ka nevojë të madhe për mbështetje.

Gjithashtu, një vlerësim i NJMF-ve nga këndvështrimi e fëmijëve⁶² arriti në përfundimin se të gjithë fëmijët asistohen në përgjithësi drejtpërdrejt nga NJMF-të. Ata e vlerësojnë

58 Raport vlerësimi, Strategjia Ndërsektorale e Përfshirjes Sociale, 2007-2013, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, 2012.

59 Studim vlerësues i njësisë të mbrojtjes së fëmijëve, WorldVision, 2013.

60 Vlerësimi i ndërhyrjeve të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve brenda kuadrit të reformës së sistemit të mirëqenies sociale dhe decentralizimi i proceseve të shërbimit social në Shqipëri. Përgatitur nga Gary Westwater dhe Vladan Jovanović - Tiranë – Gusht - Shtator 2009.

61 Analizimi i situatës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, BKTF, 2011.

62 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijëve, Projekti Mario, BKTF, 2012.

pozitivisht cilësinë e shërbimeve të marra dhe raportojnë disa përmirësime të jetës së tyre dhe marrëdhënieve familjare pas ndërhyrjeve. Ata mund të identifikojnë NJMF-të dhe policinë si aktorët kryesorë që referojnë rastet e abuzimit të fëmijëve.

Vlerësimi i fundit i NJFM-ve nxori si konkluzion se NJFM-të kanë kontribuar me një mbrojtje në rritje të fëmijës, kryesisht duke krijuar një hapësirë profesionale diskutimi për mbrojtjen e fëmijëve dhe mirëqenien e fëmijëve, së bashku me krijimin e rrjeteve / grupeve shumë disiplinore për t'i adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse rastet e abuzimit të fëmijëve⁶³. Nga ana tjetër, i njëjti vlerësim gjithashtu renditi disa sfida për ekzistencën dhe funksionimin e duhur të tyre. Menaxhimi i tyre në nivel vendor, pa ndonjë agjenci formale bashkërenduese (Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve vetëm kohët e fundit e mori këtë rol) nënkupton se secila prej tyre funksionon në mënyrë individuale, me një Protokoll Pune që nuk është i detyrueshëm (sëbashku me MMSR, UNICEF dhe Tdh). Për rrjedhojë, ato mund të jenë të izoluara, të pa inspektuara apo monitoruara deri më tani. Mungesa e shërbimeve të specializuara dhe e skemave gjithëpërfshirëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve që janë më të pambrojtur, mbeten sfida të forta.

Reforma e kohëve të fundit e Shërbimeve të Integruara Sociale në Shqipëri pritet që të ketë ndikim në funksionimin e NJMF-së⁶⁴. Në këtë kontekst, ka një rëndësi të veçantë mënyra se si kjo strukturë do të mbështetet për të luajtur rolin koordinues në grupet shumë disiplinore, që të sigurohet identifikimi, referimi dhe trajtimi më i mirë i fëmijëve në nevojë dhe në rrezik.

Vështirësitë e sistemit për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve janë më të dukshme në rastet e fëmijëve në lëvizje. Shërbimet e disponueshme nuk janë të përshtatura sipas nevojave individuale të fëmijëve në lëvizje.

‘Aktualisht, edhe pse është shumë e nevojshme, nuk ka shërbime specifike ose të specializuara për këta fëmijë, gjithashtu mungon edhe legjislacioni i posaçëm. E mendoj si të domosdoshme sepse kjo gjë ndihmon për identifikimin e tyre, kudo që ndodhen. Deri më tani, ata janë trajtuar njëllor si çdo rast tjetër në rrezik.’
(Punonjës i mbrojtjes së fëmijëve)

Identifikimi, referimi dhe ndërhyrjet

Referimi është mjaft sfidues për rastet e fëmijëve në lëvizje. Shumica e rasteve në sistem, siç

63 Po aty.

64 Studim vlerësimi i njësive të mbrojtjes të fëmijëve, WorldVision, 2013.

○ është raportuar nga profesionistët, referohen nga OJQ- _____ të dhe menaxhohen po nga ata. Nuk ka asnjë shkëmbim informacioni për rastet e referuara nga shkollat apo administratorët social (të cilët shpërndajnë asistencën financiare dhe kanë të detyruar që të vizitojnë familjet për të kryer vlerësimin fillestar). Ata janë aktorët e rrjetit që u jepet më shumë mundësia për të identifikuar lëvizjen dhe ta referojnë atë si një rast i fëmijëve në rrezik.

Administratorët social mund të jenë profesionistët më të përshtatshëm për të regjistruar lëvizjen, por ata merren vetëm me shpërndarjen e asistencës financiare⁶⁵ për shkak të ngarkesës së madhe të rasteve që kanë. Aktualisht, roli i administratorit social po rishikohet, në kuadër të Reformës së Shërbimeve të Integruara Sociale në Shqipëri. Ky është një moment kyç për të përfshirë në mandatin e tyre edhe identifikimin e lëvizjeve të familjes dhe referimin e fëmijëve të këtyre familjeve në njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në zonën ku ata lëvizin.

Vështirësitë në identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik trafikimi lidhen gjithashtu me

‘Identifikimi dhe referimi mbetet i vështirë, për shkak të mungesës së rrjetit ndërmjet aktorëve. Sipas mendimit tim menaxhimi i rasteve ndryshon në varësi të nivelit të përgjegjësisë së aktorëve të përfshirë në këtë proces.’ (Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve)

faktin se punonjësit e shëndetësisë dhe arsimit që punojnë në nivel vendor nuk kanë trajnimin e duhur dhe as nuk mbajnë përgjegjësi administrative për të identifikuar dhe referuar fëmijët në rrezik⁶⁶.

Gjithashtu, zakonisht referimet bëhen nëse fëmijët janë tashmë të regjistruar në sistem për shkak të nevojave të tjera. Nëse nuk janë në sistem, nënkupton se ata nuk janë të identifikuar vetëm për shkak të lëvizjes, e për rrjedhojë mund të qëndrojnë jashtë sistemit. Sipas përgjigjeve të palëve të interesuara, referimi i rasteve në sistem mbetet problemi kryesor edhe pse ka vështirësi për monitorimin dhe për ndërhyrjet në raste të tilla.

Pavarësisht vështirësive të identifikimit dhe referimit të rasteve të fëmijëve në lëvizje, palët e interesuara raportuan se kur rastet ishin identifikuar në sistem për shkak të nevojave të tjera, u bënë shumë përpjekje për t’i adresuar në mënyrë të përshtatshme nevojat e tyre, si në rastin e mëposhtëm:

⁶⁵ Vlerësimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale, drejtorët dhe specialistët e shërbimeve sociale për modelin e menaxhimit të rastit, UNICEF, Tdh, 2013 (i pa botuar).

⁶⁶ Raport i Analizës së Situatës për Trafikimin e Fëmijëve në Shqipëri, BKTF, 2012.

'Familja e B. përbëhet nga pesë anëtarë, nëna dhe katër fëmijë, nga 3-18 vjeç. Prindërit janë rom dhe egjiptian, dhe për shumë vite me radhë ata kanë lëvizur në disa vende. Pas vdekjes aksidentale të babait, familja qëndroi në rrugë dhe kërkonte mbështetjen e NJMF-së. Grupi shumë disiplinor përcaktoi këto objektiva:

- . Fëmijët më të vegjël, 3, 9 dhe 12 vjeç u regjistruan në shkollë dhe kopsht me mbështetjen e NPF-së, A2B*
- . Djali 18 vjeçar u regjistrua në një kurs profesional*
- . Ata u referuan te një OJQ, e cila i ofronte asistencë mujore financiare (si jetim)*
- . Ata u përfshinë në skemën e asistencës financiare, si rast në nevojë*
- . Qiraja e tyre u pagua për gjashtë muaj nga (WV))*
- . Gjenerimi i të ardhurave, nëpërmjet shitjes së rrobave (NPF)*
- . Rasti është monitoruar rregullisht dhe familja nuk ka lëvizur për një vit të tërë, fëmijët vazhdojnë të ndjekin shkollën dhe kopshtin.'*

Por këta fëmijë mund ta braktisin sistemin përsëri dhe sistemi nuk është në gjendje t'i gjurmojë ata në raste të tilla.

'Rastet e fëmijëve në lëvizje janë konsideruar si më të vështirët sepse mund të ndodhë që familja ka marrë shërbimet, situata e familjes është përmirësuar dhe e gjithë kjo ndërpritet nga lëvizja e tyre e menjëhershme.' (Qendër ditore publike)

Si në rastin e mëposhtëm:

Familja përbëhet nga nëna dhe djali i saj 12 vjeçar. Ata morën shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve sipas nevojave të tyre. Për dy vite, pavarësisht monitorimit të vazhdueshëm të rastit, familja ka është shpërngulur dy herë në Kosovë. Atyre u është dhënë gjithnjë akses në shërbime, por fatkeqësisht nëna dhe fëmija e saj u shpërngulën përsëri dhe asnjë nuk e di se ku janë. Nëpërmjet intervistave me fëmijën, ai pranoi se e ëma e ka dërguar në rrugë për të lypur në Kosovë dhe fitojnë shumë para. Edhe pse ata u deportuan nga policia e Kosovës, nëna nuk e pranon se ajo ka shkuar në Kosovë dhe trillon histori të ndryshme.

Ky është një rast, i cili thekson problemet në ofrimin e shërbimeve ndaj fëmijëve në lëvizje, kur familja lëviz përsëri edhe pas marrjes së shërbimeve duke i ekspozuar fëmijët ndaj rreziqeve më të mëdha. Për shkak të lëvizjeve, fëmija kishte probleme të rënda shëndetësore për të cilat ai mori trajtim, si dhe probleme emocionale dhe sjelljeje.

Në mënyrë specifike, në rastin e fëmijëve të mbështetur nga OJQ-të me në qendër fëmijët në

situatë rruge, palët e interesuara raportojnë se në rastin e një familje që lëviz ata zakonisht e marrin këtë informacion nga komuniteti ku familja jetonte më parë ose nga të afërmit e tyre. Në rastin e lëvizjeve të brendshme, ata raportojnë se i kanë vizituar vetë fëmijët në zonën e re ose nëse zona është larg dhe nuk e arrijnë dot, ata i referojnë tek NJMF-të përkatëse. Në rastin e emigracionit ndërkombëtar, situata bëhet edhe më e vështirë sepse vendi i mbërritjes shpesh nuk mund të identifikohet dhe nuk ka asnjë bashkëpunim me shërbimet e huaja sociale.

‘Gjurmimi i lëvizjeve varet nga largësia gjeografike. Kur fëmijët lëvizin jashtë Shqipërisë, kontaktet janë pothuajse të pamundura.’ (Qendër ditore publike)

Bashkëveprimi ndërmjet aktorëve përkatës dhe NJMF-së është thelbësor për efikasitetin e të gjitha fazave të menaxhimit të rastit. Palët e interesuara raportojnë vështirësi të mëdha në bashkërendim, veçanërisht në nivel kombëtar.

‘Bashkëveprimi lidhet shpesh me seriozitetin e personave që punojnë në këto institucione. Mund të themi se bashkërendimi në nivel vendor është i mirë, por bashkërendimi në nivel qendror rezulton problematik.’ (Punonjës i mbrojtjes së fëmijëve)

‘Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet strukturave, përfshirë qeverinë vendore, strukturat politike dhe shërbimet sociale mungon.’ (Shërbimi Shtetëror Social)

Një problem tjetër i vazhdueshëm lidhet me faktin se disa shërbime janë nën mbikëqyrjen e qeverive vendore, ndërsa të tjerat janë nën përgjegjësi të qeverisë qendrore. Kjo situatë krijoi mangësi në shërbimet e mbrojtjes ku profesionistët mund t’u shmangen përgjegjësi të tyre, në bazë të ndarjes së kompetencave midis qeverive vendore dhe qendrore.

‘Roli dhe përgjegjësi të qeverisë vendore për të ofruar shërbime sociale për fëmijët është shumë i rëndësishëm, por kjo ndodh vetëm në bashkitë e mëdha, të tjerët shpesh nuk bashkëpunojnë në ofrimin e shërbimeve shoqërore.’ (Shërbimi Shtetëror Social)

Sipas palëve të interesuara, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve është në mënyrë jo proporcionale i varur nga burimet e OJQ-ve. Gjithashtu, nëse sistemi në përgjithësi nuk i merr parasysh të gjitha grupet e fëmijëve në lëvizje, puna e OJQ-ve me grupe të synuara bëhet akoma edhe më

specifike, kryesisht vetëm me fëmijët në situatë rruge.

‘Nëse nuk janë fëmijë të rrugës, ne nuk i trajtojmë ata.’ (OJQ)

‘Deri tani, shërbimet për fëmijët janë ofruar nga OJQ-të, vetëm ndihma financiare jepet nga buxheti i shtetit.’ (OJQ)

Një studim i kohëve të fundit mbi sfidat që dalin për mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje u përqendrua në sektorin e OJQ-ve me synimin që të tregonte, se pse ato luftojnë me sfidën nëse duhen ndihmuar dhe si duhen ndihmuar e mbrojtur më mirë fëmijët në lëvizje⁶⁷. Sipas këtij studimi, OJQ-të edhe pse e njohin fenomenin e migrimit të fëmijëve dhe shkallën e tij në rritje, në përgjithësi, ndjehen të sfiduara nga debati politik që po ndodh rreth çështjes së migracionit, dhe ndikohen gjithashtu nga perceptimet e tyre për migracionin dhe dilemave që ai paraqet. Pavarësisht ekzistencës së aktorëve OJQ që punojnë me komunitetet nga ku fëmijët emigrojnë dhe gjithashtu të OJQ-ve që ndihmojnë fëmijët sapo ato mbërrijnë në destinacionin e ri, një ndërprerje gjeografike mes aktiviteteve të OJQ-ve në vendet e origjinës dhe mbërritjes është identifikuar si një nga mangësitë kryesore. Studimi gjithashtu identifikoi disa iniciativa ekzistuese të OJQ-ve që janë përpjekur të reagojnë ndaj kësaj mangësie në Shqipëri.

‘Roli i OJQ-ve duhet të jetë identifikimi i fenomenit, adresimi i problematikës nëpërmjet ofrimit të ekspertizës se si të punohet drejtpërdrejt me këta fëmijë, por ato nuk mund të jenë vendim-marrëse në zbatimin e ligjit. Ky proces dhe gjetja e një mjedisi të përshtatshëm për mirëqenien e fëmijës, duhet të jetë përgjegjësi e shtetit. OJQ-të duhet të jenë vetëm katalizatorë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe orientimi drejt alternativave më të mira.’ (OJQ)

Një listë e detajuar e OJQ-ve që punojnë aktualisht në Shqipëri dhe projektet e tyre aktuale në lidhje me fëmijët në lëvizje është e përfshirë në Shtojcën V të këtij raporti.

○ **Përshtatshmëria e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët viktimë të trafikimit**

Lidhur me reagimin e agjencive për trafikimin e fëmijëve, Raporti Alternativ për gjendjen e të drejtave të fëmijëve dhe për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës 2005-2009⁶⁸, ka arritur në konkluzionin se sistemi i referimit nuk ka funksionuar me

⁶⁷ Sfidat e hasura për mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje: nga këndvështrimi i një OJQ. M. Shuteriqi – Fëmijët në Lëvizje, IOM, 2013.

⁶⁸ Raporti alternativ i Shqipërisë për Protokollin Alternativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës lidhur me Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionit dhe Pornografisë së Fëmijëve, 2012.

efikasitet. BKTF ka botuar në 2012, analizimin më të fundit të situatës të trafikimit të fëmijëve në Shqipëri⁶⁹, i cili përmban analizën më gjithëpërfshirëse dhe aktuale për këtë çështje që do të përmendet më poshtë.

‘Raporti Teknik i Vlerësimit të Nevojave të CAAHT’ tregoi se “nuk është akoma e qartë për Anëtarët e Komitetit, si të përmbushin përgjegjësitë e tyre”. Disa të intervistuar kanë raportuar mbi punën e bërë kundër trafikimit, çka tregon se vetë krijimi i Komitetit është një hap i rëndësishëm përpara. Përsëri ka një ndërprerje ndërmjet strukturave në Komitetet Rajonale Kundër Trafikimit, kjo nënkupton se ndërkohë që vullneti politik është thelbësor për të garantuar suksesin e përpjekjeve anti-trafik në secilin qark duhet të shoqërohet me plane dhe veprime konkrete. Në përgjithësi nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për Komitetet dhe Tavolinat Teknike të Punës që t’u mundësojë atyre për të ndërmarrë detyrat dhe përgjegjësitë e kërkuara. Kjo nënkupton që ka nevojë për trajnim dhe rritjen e kapaciteteve për strukturat e qeverisë vendore.

Sipas konkluzioneve të këtij raporti Komitetet rajonale nuk kanë qenë shumë efikase. Për anëtarët e këtyre komiteteve, anëtarësi është thjesht detyrë që ata duhet të kryejnë. Gjithsesi, disa prej tyre u janë afruar ose me iniciativat e tyre personale, kanë ftuar OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare për t’i ndihmuar dhe bashkëpunuar së bashku në çështjet e luftës kundër trafikimit. Më tej është vënë re se, edhe pse janë komitetet rajonale, ato kanë tendencën të përqendrojnë punën dhe përpjekjet e tyre në qytetet kryesore të rajonit dhe në qytetet e komunat e tjera nuk është bërë pothuajse asgjë.

Lista tregon se pothuajse të gjitha agjencitë e përfshira në proces funksionojnë në nivelin e politikave dhe ka më shumë nevojë për njësi në nivelin operacional. Lufta kundër trafikimit të fëmijëve nënkupton të punën në terren, të identifikosh rastet, t’i vlerësosh ato, të ofrosh ndihmën sipas nevojave të viktimës dhe të ndjekësh rastet deri sa të ketë prova për ndryshime pozitive të përhershme dhe të qëndrueshme. Shembulli se si modeli i Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve filloi nëpërmjet njësive pilot të krijuara në disa bashki dëshmoi se rezultatet janë të mundshme, veçanërisht kur organizatat Shtetërore dhe jo-shtetërore bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë përpjekjet e tyre.

Gjithashtu, përkufizimet e punës në Mekanizmin Kombëtar të Referimit duhet të rishikohen, me qëllim që të garantojnë ndihmën ndaj atyre që janë shpallur si viktimë ose viktimë të mundshme të trafikimit, grupeve në rrezik dhe grupeve të cënueshme. Më tej, përvoja që nga viti 2005 tregon se përmirësimi i procesit të diagnostikimit duhet përmirësuar sepse ai të çon drejt identifikimit të personave që kanë nevojë për ndihmë. Në të njëjtën kohë, ofruet të tjerë të shërbimeve në shoqërinë civile, të cilët ofrojnë shërbime cilësore në mënyrë aktive

69 Nën-seksioni i mëposhtëm është përshtatur nga Raporti i Analizës së Situatës për Trafikimin e Fëmijëve në Shqipëri, BKTF, 2008.

ndaj kategorive të ndryshme të viktimave të trafikimit duhet të përfshihen në marrëveshje dhe të bëhen palë nënshkruese. Së fundi, MKR-ja duhet të përshtatet dhe të jetë në harmoni me Mekanizmin Ndërkombëtar të Referimit, i cili deri më tani nuk ka qenë funksionues.

Gjithashtu, përveç PSV-ve, raporti i BKTF-së⁷⁰ identifikoi nevojën për rritjen e kapaciteteve brenda forcave të policisë për identifikimin, verifikimin dhe referimin e viktimave të supozuara, si edhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme. Siç mund të shihet nga objektivat dhe aktivitetet që do të zbatohen nga Plan Veprimi për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit, ka akoma nevojë për psikologë, punonjës social dhe këshilltarë ligjorë në departamentet e policisë. Ka nevojë për trajnime sistematike të forcave të rendit publik në lidhje me PSV-të dhe bashkëpunimi i tyre me njësitë vendore të mbrojtjes së fëmijëve. Nga ana tjetër, shërbimet sociale për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit kanë qenë të pamjaftueshme, kryesisht të ofruara nga shoqëria civile. Fëmijët në situatë rruge të dyshuar për shfrytëzim prostitucioni dhe lypjeje brenda dhe jashtë vendit janë mbajtur përkohësisht në strehëza, por më vonë janë dërguar në shtëpi ku ata janë larguar përsëri pasi situata familjare që i ka detyruar ata të largohen që në fillim nuk ka ndryshuar. Situata e rrugës i ekspozon ata përsëri për t'u ritrafikuar, çka hedh dritë mbi mungesën e masave ri-integruese dhe dështimit të sistemit të mbrojtjes për këtë kategori fëmijësh.⁷¹

Gjithashtu, pavarësisht hapit pozitiv për ngritjen e Strehëzës për Personat e Trafikuar në Linzë, referimi i fëmijëve në këtë qendër mbetet një problem sepse minorenët janë vendosur në të njëjtën hapësirë me të rriturit⁷¹.

Në përgjithësi, mund të përmbledhim se pavarësisht progresit, SMF në Shqipëri nuk ofron mbrojtjen e fëmijëve për shkak të a) mungesës së bashkërendimit dhe koherencës midis mandatave në nivel vendor dhe qendror, b) mbështetjes kryesisht në burimet e OJQ-ve dhe burime të pamjaftueshme për shërbimet si në nivelin vendor ashtu edhe në atë qendror, c) shërbimeve të papërshtatshme ndaj kategorive të ndryshme të fëmijëve, veçanërisht fëmijëve viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit, d) mungesës së lidhjeve ndërkombëtare që përforcojnë menaxhimin ndërkombëtar të rasteve, e) kapacitetit të ulët referues ose vullnetit për të referuar, etj.



Gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria e reagimeve të SMF-së

Si u shpjegua edhe më sipër, qasja e SMF-së është e bazuar në rast (pavarësisht vizionit për një qasje sistematike), me në qendër grupe të veçanta fëmijësh. Për rrjedhojë, për t'u bërë pjesë

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Raporti alternativ i Shqipërisë për Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës lidhur me Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionit dhe Pornografisë së Fëmijëve, 2012.

e sistemit fëmijët duhet të trafikohen ose të jenë në rrezik trafikimi apo shfrytëzimi. Edhe pse fëmijët “në nevojë” që janë në nivele të ulëta rreziku, sipas protokollit, kanë hyrë në sistem, elementi i identifikimit për ata është varfëria dhe sëmundja. Lëvizja në vetvete nuk është e identifikuar si një faktor e cila, në disa raste, mund të shkaktojë cënueshmëri, për rrjedhojë ajo dështon në përcaktimin e masave të sigurisë për ta bërë lëvizjen e sigurt.

Sipas palëve të interesuara, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve e konsiderojnë lëvizjen si një faktor rreziku, por kjo ndodh vetëm në rastet kur një fëmijë është referuar tashmë te shërbimet për arsye të tjera. Edhe PP nuk e përmend shprehimisht ‘lëvizjen’ si një faktor për identifikimin e fëmijës dhe vlerësimin e rrezikut.

‘Lëvizja konsiderohet si një element i rrezikut, por kjo bëhet vetëm për grupet e marxhinalizuara’ (Punonjës i mbrojtjes së fëmijëve)

Në këtë mënyrë, jo vetëm punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve por edhe përfaqësuesit e shëndetësisë, policisë, etj., (aktorët kyç të përmendur në kapitujt e mësipërm), të cilët punojnë sipas protokollit nuk i identifikojnë dhe i referojnë rastet e fëmijëve në lëvizje te NJMF-të sepse ato nuk janë të identifikuar si raste që kanë nevojë për mbrojtje, vetëm pse janë në lëvizje.

‘Sistemi nuk është përfshirës; shpesh familjet dhe fëmijët në nevojë janë kthyer në vendet e tyre të origjinës nga policia, pa u mbështetur me shërbimet e nevojshme.’ (OJQ)

Aksesi ndaj njësive të mbrojtjes së fëmijëve nuk është i mundur në të gjithë Shqipërinë. Situata është pak unike me NJMF që janë nën drejtimin dhe kontrollin individual të kryetarëve të bashkive/komunave, ku janë ngritur dhe nuk janë nën përgjegjësinë e ndonjë ministrie/ departamenti. Ndërkohë, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (2010) përcakton se NJMF-të do të krijohen në secilën bashki dhe komunë, nga kjo del se nuk ka asnjë detyrim për të bërë këtë gjë, për rrjedhojë në disa prej tyre këto njësi nuk janë krijuar akoma. Për më tepër, nuk sigurohet asnjë burim financiar për ngritjen dhe funksionimin e NJMF-ve, ku secila bashki / komunë pritet që të identifikojë buxhetin e duhur për shërbimin. Pasoja kryesore e këtyre tipareve është se nuk ka ndonjë shërbim universal në të gjithë Shqipërinë dhe NJMF-të mund të jenë të cënueshme ndaj ndryshimeve të prioriteteve vendore. Kështu, OJQ-të dhe UNICEF e kanë mbështetur këtë proces, por tani është e nevojshme të krijohen njësi të qëndrueshme të mbrojtjes së fëmijëve. Ligjërisht, është detyra e Agjencive Shtetërore për fëmijët që të drejtojnë krijimin e NJMF-ve, por deri më tani Agjencia mbetet një institucion i ri dhe nuk

është në gjendje të përfshihet tërësisht në këtë proces⁷².

‘Aksesi nuk është i lehtë, sidomos në rrethina dhe zonat rurale. Është e pamundur sepse nuk ka asnjë shërbim. Në përgjithësi, shërbimet janë të vendosura në zonat kryesore urbane.’ (Shërbimi Social Shtetëror)

Gjithashtu njerëzit nuk kanë informacion për ekzistencën e NJMF-ve⁷³. Meqenëse ka vetëm një punonjës të mbrojtjes së fëmijëve që punon në të gjithë bashkinë ose komunën dhe në shumë raste ata punojnë në këtë pozicion me kohë të pjesshme (gjysma tjetër e detyrave të tyre përfshin përgjegjësitë e administratorit social ose punonjësit për dhunën në familje), ata përballen më ngarkesë të rasteve dhe është shumë e vështirë që ata të jenë të dukshëm në nivelin e komunitetit. Kështu, zakonisht fëmijët mësojnë për ekzistencën e këtyre shërbimeve nga fëmijët e tjerë ose anëtarët e komunitetit dhe ndonjëherë nga OJQ-të, që përpiqen të identifikojnë fëmijët në zonat ku ata banojnë ose në rrugë⁷⁴. Kjo gjë u raportua nga prindërit, fëmijët dhe nga palët e interesuara.

‘Ata e mësojnë nga njëri-tjetri, nga kontaktet me grupet që punojnë në terren ose nga qytetarët që e dinë për ekzistencën e qendrave ditore dhe bisedojnë me këta fëmijë në rrugë.’ (OJQ)

Aksesi ndaj shërbimeve të ndihmës financiare është i vështirë për disa familje në nevojë të cilat kanë lëvizur. Ndonjëherë, ndihma financiare që është kontakti më i qëndrueshëm me shërbimet sociale të bashkisë/komunës për disa nga këto familje shndërrohet në pengesë. Kjo ndodh sepse ata vazhdojnë të marrin asistencën financiare në të njëjtën zyrë të shërbimeve sociale, pavarësisht lëvizjes. Kjo e fundit nuk regjistrohet.

Rasti i mëposhtëm i raportuar nga një OJQ që punon me fëmijët në rrugë u zgjodh që të përmbyllë këtë pjesë, pasi ai konkretizon disa mangësi të sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve për t’ju përgjigjur nevojave të fëmijëve në lëvizje, përfshirë këtu vështirësitë e referimit, mungesës së njësive të mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë Shqipërinë, përpjekjet e OJQ-ve për të ofruar shërbimet, duke u përqendruar të një grup fëmijësh dhe zhdukja nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në rast të ndonjë shpërnguljeje / lëvizjeje.

X. shpërngulet nga L... për në Tiranë (kryeqyteti). Ai është identifikuar duke lypur në rrugë, nga punonjësit e Qendrës që punojnë në terren. Pasi u informua mbi shërbimet e Qendrës, X. bëri

72 Studim vlerësues i njësive për mbrojtjen e fëmijëve, World Vision, 2013.

73 Situata e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Save the Children, 2012.

74 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijëve, Projekti Mario, BKTF, 2012.

qëndresë dhe ishte dyshues për të shkuar atje. Pasi mbikëqyrëm lëvizjet e tij në Tiranë për disa ditë ai u gjet përsëri dhe filluam të komunikojmë pak me të.

Ai raportoi se ishte braktisur nga familja e tij e cila për momentin jetonte në Kosovë. Të afërmit e tij në L... ishin indiferent ndaj tij, nëse ai nuk siguronte para për ta.

Gjatë kësaj periudhe, prindërit e tij nuk kishin asnjë informacion për vendndodhjen e fëmijës dhe nuk kishte asnjë raportim në polici për mungesën e tij. Pasi u kontaktuan qendra të tjera, me qëllim që të merrnim më shumë informacion për këtë fëmijë, u gjetën numrat e kontaktit të prindërve. Gjatë bashkëbisedimit në telefon, ata e pranuan se djali i tyre ishte deportuar nga policia nga Kosova për në Shqipëri. Gjatë këtij procesi, pasi u la i lirë nga policia kufitare, ai duhet të mbijetonte dhe ishte përballur me shfrytëzim dhe abuzim nga personat me të cilët duhet të kalonte natën.

Gjatë qëndrimit të tij në Tiranë, personeli i Qendrës u përpoq të gjente një strehëz ndërkohë që ndërmerjetonte me të afërmit e tij në L..., për ta regjistruar në një kurs profesional apo për ta shoqëruar në spital për shkak të problemeve të rënda shëndetësore që kishte. Një vit më pas, X. shkon përsëri në Kosovë. Pas kontaktimit me prindërit, fillimisht ai kishte jetuar me ata dhe më pas kishte lëvizur drejt një drejtimi të panjohur. Deri tani asnjë nga partnerët tanë nuk ka donjë informacion për vendndodhjen e tij.



Parandalimi

Për identifikimin e reagimeve parandaluese në lidhje me fëmijët në lëvizje duhet të vëzhgojmë nga njëra anë, masat parësore parandaluese për sa i përket ndërgjegjësimit për rreziqet e mundshme me të cilat përballen fëmijët në lëvizje, dhe nga ana tjetër, masat parandaluese të ndërmarra nga SMF-ja me qëllim që të mbështes lëvizjen e sigurt.

Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës mbi veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), në raportin e vitit 2011 për zbatimin e Konventës së Këshillit Evropian për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nga Shqipëria (2011)⁷⁵ ka renditur disa masa ndërgjegjësuere në lidhje me fëmijët. Meqenëse ky është raporti më i fundit, i cili përmend masat parandaluese, ne i referohemi këtij raporti për masat e renditura më poshtë:

- Disa fushata kundër punës së fëmijëve u organizuan gjatë viteve të fundit, ku në qendër të tyre ishte kryesisht eliminimi i formave të këqija të punës së fëmijëve. Këto fushata kanë përdorur afishe, spote publicitare në television dhe paketa edukative. Ato u përqendruan pjesërisht në trafikimin e fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit për punë.
- Koordinatori Kombëtar dhe IOM-it ka organizuar seanca trajnuese për gazetarët

⁷⁵ Raporti për zbatimin e Konventës së Këshillit Evropian për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nga Shqipëria, vlerësimi i parë, GRETA, Këshilli i Evropës, 2011.

shqiptarë për t'ju kujtuar rolin që ata kanë për ndërgjegjësimin e shkaqeve themelore të trafikimit të qenieve njerëzore dhe detyrimin e tyre për të informuar publikun ndërkohë që ata duhet të përmbushin kodin e tyre profesional të etikës dhe të drejtat e dinjitetit e viktimave.

- Një sërë mjetesh arsimore të përgatitura në bashkëpunim me IOM u prezantuan veçanërisht për të parandaluar trafikimin, përfshirë këtu doracakë për mësuesit dhe nxënësit me në qendër trafikimin. Fëmijët janë të ndërgjegjësuar për rreziqet e trafikimit ndërkombëtar nëpërmjet programeve të drejtuara në shkolla. Në 2009, vetëm gjatë një muaji, veprimtaria teatrale interaktive (“Unë udhëtoj... vetëm”) arriti te 4000 nxënës, duke u shpjeguar si ndodh trafikimi dhe rreziqet e tij.
- Në 2008 dhe 2010, një numër veprimtarish ndërgjegjësuere u organizuan nga Koordinatori Kombëtar në bashkëpunim me agjenci të tjera qeveritare, organizata ndër-qeveritare dhe/ose OJQ, të përqendruara në trafikimin e qenieve njerëzore, por jo veçanërisht te fëmijët.
- Në 2010 Koordinatori Kombëtar në bashkëpunim me aktorët përkatës ka organizuar një seminar për zyrtarët i quajtur “Le ta bëjmë internetin të sigurt për fëmijët”. Kjo gjë rriti ndërgjegjësimin për rrezikun e rekrutimit për trafikim nëpërmjet internetit.
- Në 2010, u shpërndanë 6000 broshura me në qendër viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore te pikat e kalimit kufitar, në zyrat konsullore dhe vende të tjera përkatës.
- Për të parandaluar trafikimin dhe veçanërisht për ta dekurajuar atë, çështja e barazisë ndërmjet grave dhe burrave është trajtuar më gjerësisht në disa programe shkollore.
- Autoritetet shqiptare kanë marrë masat për të siguruar se shqiptarët janë të informuar për rreziqet e trafikimit lidhur me emigrimin në vendet e huaja. Për këtë arsye janë shpërndarë broshura dhe afishe në të gjithë vendin dhe në konsullata e ambasada jashtë vendit. Një linjë telefonike falas është hapur, që u jep mundësinë atyre që telefonojnë të raportojnë rastet e trafikimit dhe gjithashtu, të marrin informacion për kërkesat ligjore që duhen përmbushur kur udhëton jashtë. Stafi i konsullatës është pajisur me manuale që u japin udhëzime se si të informojnë shqiptarët jashtë për të drejtat dhe detyrimet e tyre por ata nuk janë të trajnuar për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.
- Pas heqjes së kërkesës për vizë për shqiptarët që kanë dëshirë të hyjnë në zonën Shengen në fund të vitit 2010, autoritetet shqiptare kanë filluar fushata informimi edhe në televizion, që i shpjegojnë popullatës se liria e tyre për të udhëtuar pa vizë nuk u jep të drejtën që të shkojnë në vendet e zonës Shengen për të punuar apo të kërkojnë punë dhe ata duhet të kenë kujdes ndaj premtimeve të rreme për punë të paguar në vende të tjera (kjo fushatë nuk ka në qendër fëmijët).

Pavarësisht kësaj, deri tani, nuk ka asnjë vlerësim të nivelit të mbulimit të masave të marra.

Fëmijët që morën pjesë në hulumtimin tonë nuk arritën të identifikonin ndonjë masë të ndërmarrë apo ndonjë të ngjashme to.

Nga ana tjetër, janë ndërmarrë disa masa parandaluese nga institucionet e sistemit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim që të mbrojnë fëmijët gjatë lëvizjes së tyre edhe pse janë identifikuar sfida të mëdha në këtë aspekt.

Një nga sfidat për të parandaluar rreziqet që shoqërohen me lëvizjen është të adresohet braktisja e shkollës. Për t'u regjistruar në shkollë, një fëmijë duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Edhe pse arsimit fillor është i detyrueshëm dhe falas për të gjithë fëmijët sipas ligjit për arsimin para-universitar, këta fëmijë mbeten jashtë sistemit arsimor, sepse prindërit e tyre nuk i kanë regjistruar asnjëherë ata. Edhe në rastet kur OJQ-të kontaktojnë me këta fëmijë në nevojë, atyre u duhet shumë kohë për t'i regjistruar ata për herë të parë në jetën e tyre. Gjithsesi, janë marrë masat për të lejuar që këta fëmijë, të cilët nuk janë regjistruar akoma në regjistrin e gjendjes civile, të ndjekin shkollën. Ministria e Arsimit lejon pranimin e fëmijëve në shkollë edhe pa dokumente. Fëmijët nuk mund të marrin dëftesën e arsimit bazë, e cila pengon vazhdimin e shkollimit të tyre edhe pas arsimit të detyrueshëm⁷⁶.

Gjithashtu, për të siguruar se fëmijët rom, që nuk mund të përballojnë blerjen e teksteve shkollore, të ndjekin shkollën, qeveria e ka zgjidhur këtë çështje nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave⁷⁷, i cili përcakton detyrimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të mbuluar 100% çmimin e teksteve shkollore për fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare.

Së treti, me qëllim që të sigurohet ndjekja e shkollës nga fëmijët shqiptarëve të kthyer, Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës 'Për fillimin e vitit të ri shkollor' parashikon disa masa që përforcojnë integrimin e tyre në shkollë, si përshembull regjistrimin për herë të parë në sistemin arsimor të personave të kthyer, vazhdimin e studimeve që kanë filluar jashtë vendit, dhe ekuivalentimin e diplomave⁷⁸.

Së katërti, shërbimi psiko-social i shkollës është ngritur në shkollat publike, i cili monitoron fëmijët në vështirësi në shkollë dhe për të gjetur zgjidhje që shmangin braktisjen e shkollës.

'Aktivitetet e mia përfshijnë këshillimin, përfshirjen e fëmijës në aktivitete shkollore, vlerësimin e rrezikut dhe referimin te NJMF-të nëse duhet' (Psikolog shkolle)

76 Analizimi i situatës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, BKTF, 2011.

77 Vendimi Nr. 107, datë 10.2.2010, i Këshillit të Ministrave 'Për Botimin, Printimin, Shpërndarjen dhe Shitjen e Teksteve Shkollore të Arsimit Para-universitar'.

78 <http://www.migrantinfo.gov.al/images/stories/migranti/kthimi-riintegrimi/strategjia-shtetasvekthyer.pdf>

Në këtë kontekst, shkolla mund të jetë një institucion shumë i rëndësishëm jo vetëm për identifikimin e rasteve të braktisjes së shkollës por edhe për sigurimin e informacionit të nevojshëm për fëmijët që kanë ndryshuar shkollën. Për momentin, të gjitha të dhënat përkatëse për fëmijët përfshirë edhe lëvizjet i referohen Zyrës Rajonale të Arsimit, por këto nuk përdoren për qëllime shërbimi.

‘Shkollat mund të jenë pika kontakti për identifikimin e fëmijëve në lëvizje. Të dhënat për fëmijët që kanë braktisur shkollën u janë dërguar zyrave rajonale të arsimit, kështu që ato janë diku, vetëm se askush nuk i përdor ato.’ (Profesionist i mbrojtjes së fëmijëve)

Rastet e fëmijëve që braktisin shkollën nuk ndiqen dhe nuk u referohen shërbimeve shoqërore, duke i bërë ata të padukshëm në sistem, në veçanti kur fëmija dhe familja nuk janë të regjistruar në gjendjen civile në vendbanimin e tyre të ri.

‘Kur lëvizëm nga Tirana në Korçë, nuk shkova më në shkollë se mami nuk donte që unë të shkoja. Atje qëndruam një vit. Mami shiste rroba në treg dhe unë e ndihmoja çdo ditë.’ (Mashkull, 12 vjeç)

Shkollat mund të bëhen aktorë të rëndësishëm në parandalim, duke i referuar rastet e fëmijëve që e braktisin shkollën për t’u shpërngulur në një qytet/zonë tjetër te njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të asaj zone. Kështu, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në vendin e ri mund të kontaktojnë me fëmijët dhe të sigurojnë regjistrimin e tyre në shkollë dhe t’i identifikojë ata si fëmijë në nevojë për mbrojtje, nëse e nevojshme. Kjo praktikë tashmë ekziston në shkolla, si u përmend më sipër, por rreziqet që shoqërohen me lëvizjen nuk janë një tregues për ta zbatuar atë.

‘Në rastet e divorcit, nëse një nga prindërit do të lëviz me fëmijën dhe tjetri nuk informohet për këtë, mund të jetë me rrezik. Në këto situata rasti i referohet psikologut të shkollës tjetër.’ (Psikolog shkolle)

Regjistrimi civil i fëmijëve është një sfidë tjetër përsa i përket masave parandaluese. Disa nga vështirësitë për të përdorur regjistrimin si një masë parandaluese identifikohen në këtë nën-seksion. Disa nga fëmijët lëvizin me familjet e tyre dhe ndryshojnë vendbanimin e tyre brenda Shqipërisë, pa bërë transferimin e dokumenteve. Të tjerët nuk janë regjistruar asnjëherë. Disa familje mund të hasin vështirësi në regjistrimin apo transferimin e regjistrimit civil për shkak të

mungesës së informacionit, tarifave të regjistrimit dhe vështirësive të lëvizjes nga njeri vend në tjetrin për t'u pajisur me të gjitha dokumentet e nevojshëm. Gjithashtu, rastet e fëmijëve që jetojnë me gjyshërit dhe janë braktisur nga prindërit e tyre nuk mund të regjistrohen.

'Meqenëse ata nuk janë banorë të qytetit / komunës ku janë identifikuar, ata janë përjashtuar nga çdo lloj shërbimi, arsimor, mjekësor, ekonomik dhe social'
(Punonjës i mbrojtjes së fëmijëve)

'Procedurat ligjore janë të bazuara në regjistrimin në zyrën përkatëse të bashkisë/ komunës. Nëse vendbanimi nuk përkon me atë të regjistrimit, është e vështirë të mbështesësh fëmijën, për sa i përket regjistrimit në shkollë, shërbimeve shëndetësore, etj. Aksesin në shërbime publike është në nivel të ulët.' (Shërbimi Shoqëror Shtetëror)

Institucione të tilla si shkollat dhe shërbimet shëndetësore, të cilat kanë mundësitë dhe aftësinë për të identifikuar këta fëmijë, duhet t'i ndihmojnë ata në mënyrë pro-aktive dhe reaguese duke i identifikuar ata dhe duke i referuar te zyrat e regjistrimit civil. Regjistrimi i tyre është hapi i parë dhe kyç për t'i bërë ata të dukshëm në syrin e ligjit dhe institucioneve publike dhe t'u japi atyre mundësinë për të gëzuar të drejtat e tyre dhe aksesin në shërbime⁷⁹.

Mos regjistrimi shoqërohet me pamundësinë për të pasur akses në shërbime shëndetësore. Kështu, në rast se një fëmijë ka lëvizur në një zonë tjetër dhe familja nuk është regjistruar në vendndodhjen e re, fëmija nuk do të marrë shërbimet shëndetësore sepse nuk është i regjistruar, e për rrjedhojë nuk ka librezë shëndetësore. Udhëzimi Nr. 526, i datës 12.10.2009 'Për Zbatimin e Sistemit të Referimit të Pacientëve të Shërbimit Shëndetësor' i nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë i detyron punonjësit e shërbimit shëndetësor që t'u japin shërbime vetëm pacientëve që kanë dokumente të rregullta, me përjashtim të rasteve të urgjencës. Kështu, sipas ligjit, çdo person që kërkon kujdes shëndetësor duhet të ketë një librezë shëndetësore dhe një mjet identifikimi, përfshirë këtu edhe fëmijët.

Po kështu, problemet për sa i përket vaksinimit të fëmijëve rom janë gjithashtu të lidhura me lëvizshmërinë. Sipas sondazhit të vitit 2011⁸⁰ në vendbanimet e romëve në Tiranë, niveli i vaksinimit ndryshon në vendbanime të ndryshme. Ndonjëherë niveli i vaksinimit të fëmijëve rom është raportuar të jetë më pak se 80%. Edhe pse autoritetet shëndetësore raportojnë se kanë mbështetur aktivitetet e vaksinimit nëpërmjet identifikimit të fëmijëve rom duke shkuar derë më derë, si dhe duke ngritur kapacitetet e ofruesve të shërbimit shëndetësor

79 Analizimi i situatës së sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, BKTF, 2011.

80 Sondazh për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Tiranë, Save the Children, 2011.

për të arritur grupet e cënueshme nëpërmjet vaksinimit dhe ofrimit të shërbimeve të tjera të kujdesit shëndetësor, mungojnë të dhëna të besueshme në lidhje me situatën dhe përkujdesjen shëndetësore që kanë marrë të sapolindurit rom dhe nënat që i ushqejnë me gji⁸¹.

Në bazë të statistikave të raportuara, por edhe në bazë të raporteve të profesionistëve dhe prindërve, sistemi shëndetësor ka dështuar të zbatojë mekanizmin që ka si qëllim të parandalojë pasojat shëndetësore të lidhura me lëvizjet, veçanërisht në rastin e programit të vaksinimit të detyrueshëm.

‘Punonjësit shëndetësor ndonjëherë vijnë në zonën tonë dhe mund të pyesin për vaksinimin, por nuk na shqetësojnë ose kritikojnë pse nuk i kemi vaksinuar fëmijët tanë’ (Prind rom)

Një sfidë tjetër për parandalimin e rreziqeve që shoqërohen me lëvizjen është sigurimi dhe lehtësimi i migracionit të ligjshëm. Pikat e kufirit do të ishin vendi më i mirë në këtë aspekt. Zyrat e migracionit të ngritura në çdo kufi, ofrojnë informacion për të gjithë migrantët por vetëm në rastet kur ata i afrohen këtyre zyrave në mënyrë vullnetare. Gjithashtu, sipas Strategjisë për ri-integrimin e shqiptarëve të kthyer, në përgjithësi masat e ri-integrimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin nuk i adreson plotësisht nevojat e të kthyerve, sepse nuk ka mekanizëm të qartë informacioni në lidhje me shërbimet publike në vend dhe mungojnë shërbime të vazhdueshme referimi. Këto masa përqendrohen kryesisht në punësimin dhe formimin profesional të të kthyerve ndërkohë që nevojat e tyre janë më të gjera⁸².

Më tej, në rastin e minorenëve të pashoqëruar, që janë kthyer nga jashtë, palët e interesuara kanë raportuar se “ata janë mbajtur për 24 orë në kufi, dhe më pas, veçanërisht në rastet e fëmijëve rom, ata thjesht i kanë hipur në ndonjë mjet të transporti publik drejt destinacioneve që ata kanë përmendur si qytetet e tyre të banimit”⁸³. Për këtë arsye, sistemi ka dështuar në parandalimin e rreziqeve që shoqërojnë lëvizjen në këto raste.

Në bazë të raportimeve nga prindërit dhe fëmijët rom, me sa duket, ata injorohen plotësisht nga policia kufitare dhe shpesh mund të kalojnë kufirin e të kthehen vetëm me një certifikatë lindjeje. Dokumentet e identifikimit nuk kërkohen.

‘Ata nuk na shqetësojnë kurrë. Janë shumë të rreptë me të bardhët, por me ne janë gjithnjë shumë tolerant. Gjithmonë na lejojnë që të kalojmë dhe nuk na kërkojnë asgjë.’ (Prind rom)

81 Analizimi i situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Save the Children, 2012.

82 <http://www.migrantinfo.gov.al/images/stories/migranti/kthimi-riintegrimi/strategjia-shtetasve-kthyer.pdf>

83 Intervistë me përfaqësues të IOM-it.

VII. Rekomandimet




Forcimi i reagimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve

- Krijimi i një baze të përbashkët të dhënash që fillon me regjistrimin në zyrën e e Gjendjeve Civile dhe vazhdon me profesionistët shëndetësor që i ndjekin më nga afër fëmijët gjatë viteve të parat të jetës, dhe më vonë me shkollën të cilët sigurojnë regjistrimin e tyre. Për rrjedhojë, lëvizjet mund të gjurmohen brenda sistemit dhe largimi i fëmijës nga sistemi i mbrojtjes mund të parandalohet.
- Rishikimi i kuadrit rregullator, me qëllim që të sigurohet se ai nuk u referohet në mënyrë të fragmentizuar kategorive të veçanta të fëmijëve në lëvizje, por në qendër të kenë nevojat e tyre dhe parandalimin e rreziqeve që shoqërohen me lëvizjen në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe grupet e lëna jashtë, si p.sh. fëmijët e larguar.
- Përmirësimin e marrëveshjeve midis shteteve, kryesisht me shtetet fqinje, me qëllim që të sigurohet një bashkëpunim më i mirë midis sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe një shkëmbim më i mirë i të dhënave lidhur me fëmijët në lëvizje, kryesisht për fëmijët jashtë mjedisit të mbrojtur.
- Planifikim më i mirë i shërbimeve sociale në nivel vendor, me qëllimin që të mbështeten familjet dhe fëmijët, si dhe të fuqizohen NJMF-të në të gjithë Shqipërinë.
- Forcimi i mekanizmave që sigurojnë identifikimin e hershëm të rasteve të fëmijëve në lëvizje, të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe mbrojtje.
- Përmirësimi i bashkërendimit midis të gjithë aktorëve të sistemit ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve për të gjitha rastet e fëmijëve në lëvizje, në nivelet vendore dhe qendrore, nëpërmjet rishikimit të roleve dhe kryesisht duke ndërtuar mekanizma më të mirë monitorues për menaxhimin e rastit.
- Sigurimi i një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet shtetit, OJQ-ve dhe aktorëve përkatës për të lehtësuar punën e tyre me fëmijët në lëvizje.
- Rishikimi i rolit të administratorëve social, të cilët për momentin janë të ngarkuar me dhënien e ndihmës financiare, por në vend të kësaj duhet të zhvillojnë shërbime për familjen, të cilat mundësojnë monitorimin më nga afër të nevojave të familjes gjatë dhe pas lëvizjes.
- Ngritja e një sistemi të mbledhjes së vazhdueshme të të dhënave për fëmijët në

lëvizje, me të dhëna të sakta të grupuara sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, statusit social-ekonomik, etj.

○ **Krijimi i masave parandaluese**

- Zbutja e rreziqeve që mund të shoqërohen me lëvizjen e fëmijëve nëpërmjet fushatave dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe përdorimit të burimeve të ndryshme mediatike, me qëllim që të arrihet tek të gjithë grupet e fëmijëve dhe të rriturve. Duhet të merren masat për të parandaluar neglizhencën ndaj disa grupe fëmijësh të cënueshëm nga lëvizjet e pasigurta, si për shembull fëmijët rom.
- Shpërndarja e programeve informuese tek fëmijët dhe prindërit për burimet e ndryshme për mbështetjen e fëmijëve në lëvizje në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.
- Rritja e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në funksion të identifikimit dhe adresimit të faktorëve të cënueshmërisë që mund të kontribuojnë në lëvizjen e pasigurt të fëmijëve, siç është varfëria, papunësia, mungesa e banesave, etj.
- Regjistrimi i të gjithë fëmijëve dhe reduktimi i braktisjes së shkollës, si një masë parandaluese më afat-gjate, e cila redukton rreziqet që lidhen me lëvizjen.
- Trajnimi i aktorëve përkatës i të gjithë sektorëve të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve, kryesisht:
 - Trajnimi i policisë kufitare me qëllim ndërgjegjësimin e tyre rreth lëvizjeve të pasigurta dhe se si të ndërhyjnë në raste të tilla
 - Trajnimi i profesionistëve të shëndetësisë dhe arsimit për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në lëvizje që rrezikojnë të dalin nga këto shërbime.
 - Trajnimi i administratorëve social që gjatë vizitave të tyre familjare të identifikojnë fëmijët në rrezik si rrjedhojë e lëvizjes së pasigurt.
- Ndërmarrja e hulumtimeve të mëtejshme me qëllim që të vlerësohet niveli i ndërgjegjësimin të grupeve të ndryshme të popullatës (të rritur, fëmijë, grupe në rrezik) mbi faktorët e rrezikut që lidhen me lëvizjen, për zhvillimin e strategjive më të mira parandaluese për këtë çështje.



VIII. Shtojcat

Shtojca I



Udhëzime për intervistën me palët e interesuara

1. Çfarë dini për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve?
2. Ku mund t'i gjeni ato?
3. Çfarë mandati kanë?
4. A e dini se çfarë bëjnë ato?
5. E konsideroni sistemin gjithëpërfshirës?
6. A është lehtësisht i aksesueshëm?
7. Ofron ai vëzhgime në terren?
8. Është kjo efikase?
9. E dini nëse ka standarde të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve për grupe të veçanta fëmijësh?
10. Llojet e fëmijëve?
11. Është përjashtuar ndonjë grup fëmijësh? Nëse po, kush janë ata dhe pse?
12. Mendoni se ato standarde funksionojnë?
13. Cilat mendoni se janë?

(Pyetje të mëtejshme për individët që punojnë në sektor apo në fusha të tjera që kanë lidhje me këtë sektor)

14. Sa fëmijë janë mbuluar nga shërbimet ekzistuese të mbrojtjes së fëmijëve?
15. Cilat janë pengesat ligjore, administrative dhe praktike që fëmijët në lëvizje përballen për të pasur akses ndaj shërbimeve?
16. Kur ndodh kjo?
17. A e dini nëse ekzistojnë dokumentacione për këto shërbime?
18. A keni krijuar, keni qenë i përfshirë në krijimin apo keni përdorur atë dokumentacion?
19. Ka alokuar organizata juaj një buxhet për mbrojtjen e fëmijëve?
20. Nëse po, sa është ai?

(Për të gjithë të intervistuarit)

21. A ka ndonjë gjë tjetër që dëshironi të shtoni rreth atyre që keni thënë deri tani? Për shembull, nëse flasim në përgjithësi, besoni se shërbimet funksionojnë mirë për fëmijët e marxhinalizuar si për shembull për ata që janë lëvizje dhe që ky studim ka në fokus? Apo mendoni se ka ndonjë gjë tjetër që duhet bërë?
22. Ndonjë detaj tjetër.



Udhëzime për intervistimin e fëmijëve

1. Emri:
2. Ku qëndroni/ku mund t'ju gjejmë?
3. Fëmijët në lëvizje janë.....
4. Ata vijnë nga
5. Janë ata nga këtu apo nga ndonjë vend tjetër? Ata vijnë nga.....
6. Je ti njëri prej tyre? Ti je nga....
7. Disa fëmijë kthehen këtu? Kur ata largohen, ata shkojnë tek....
8. Mendon se do të ishte mirë apo keq të shkosh diku tjetër? Mund të na shpjegoni pse?
9. Ku po jetoni tani? Jeni me familjen tuaj, në një institucion apo
10. Sa vjeç je?
11. Sa fëmijë njih që janë si ty? Më trego pak për ta....
12. Janë djem apo vajza, sa prej secilit grup?
13. Çfarë bën çdo ditë, për shembull, je vetëm, më trego pak për këtë.....
14. A ka ndonjë organizatë që ju ndihmon apo bën ndonjë gjë tjetër për ju?
Shpjegoni çfarë...
15. Ka ndonjë gjë tjetër që doni të thoni?

Shtojca II

○ **Origjina e konceptit të fëmijëve në lëvizje**

Termi “fëmijët në lëvizje” u krijua për herë të parë në mesin e dhjetëvjeçarit (2000 - 2010) për t’u referuar në përgjithësi fëmijëve, që ishin larguar nga vendqëndrimi i tyre i zakonshëm për të lëvizur brenda vendit të tyre ose drejt një vendi tjetër.

Meqenëse qëllimi ishte t’u referohej një game të gjerë fëmijësh, përvojat specifike që ata kishin për lëvizjen ishin të ndryshme, por nevojat ata që kishin për mbrojtje ishin të përbashkëta, termi fillimisht nuk u shoqërua me një listë të saktë se kush përfshihej ose jo në këtë grup. Gjithsesi, politikë-bërësit, praktikuesit dhe profesionistët e tjerë që punonin me/ose fëmijët në kontekste migrimi, kërkonin një përkufizim dhe një listë më të saktë se kujt i referohej ky term. Për rrjedhojë, organizata të ndryshme kanë miratuar përkufizime të ndryshme për këtë koncept.

Sipas përkufizimit të organizatës ‘Save the Children’, fëmijët në lëvizje janë ata “fëmijë që lëvizin për një sërë arsyesh, të vullnetshme ose të pavullnetshme, brenda ose ndërmjet shteteve, me ose pa prindërit apo kujdestarët parësor dhe kjo lëvizje mund t’i vendos ata në rrezikun (apo një rreziku në rritje) e mungesës së një përkujdesje të mjaftueshme, e shfrytëzimit ekonomik apo seksual, abuzimit, neglizhencës dhe formave të tjera të dhunës”⁸⁴.

Një shënim shoqërues – shpjegues për përkufizimin e mësipërm përcakton se:

‘Fëmijët në Lëvizje’ nuk duhet kuptuar si një kategori ‘e re’ fëmijësh. Ai është një përkufizim gjithëpërfshirës që sjell së bashku disa kategori në të cilat fëmijët në lëvizje kanë qenë ndarë.

Për rrjedhojë, ky përkufizim përfshin:

- fëmijë që kanë qenë trafikuar;
- fëmijë që migrojnë (për shembull, për të ndjekur mundësi më të mira jete, kërkojnë punë ose arsimin, ose arratisen nga situatat shfrytëzuese apo abuzive në shtëpi);
- fëmijë të zhvendosur për shkak të konflikteve dhe fatkeqësive natyrore; dhe
- fëmijë që jetojnë dhe punojnë në rrugë.

Të gjithë këta fëmijë mund të gjenden në rrezik, kryesisht duke qenë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit dhe mund të përfshihen në format më të këqija të shfrytëzimit. Ky koncept që thekson rreziqet e përbashkëta dhe sfidat që këta fëmijë përballen përkras situatave të tyre specifike, nevojave dhe vendimeve që ata marrin, ka si qëllim të riorientojë ndërhyrjet në mbështetje të tyre dhe të sigurojë politika koherente, duke vënë në qendër të tyre mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ai njuh nevojën për të mbështetur efektin pozitiv që

84 <http://resourcecentre.savethechildren.se/child-protection/priority-areas/children-without-appropriate-care/children-move>

lëvizja mund të ketë në përmirësimin e mundësive të jetës së fëmijëve”⁸⁵.

Në 2011, Terre des hommes (Tdh) miratoi përkufizimin e saj, sipas të cilit koncepti i ‘fëmijëve në lëvizje’ “i referohet atyre fëmijëve që janë larguar nga vendbanimi i tyre i zakonshëm dhe janë ose rrugës për në destinacionin e tyre të ri ose kanë arritur në këtë destinacion”⁸⁶.

Sipas përkufizimit të mësipërm, një fëmijë mund të lëvizë përtej kufijve shtetërore ose brenda një vendi. Ai/ajo mund të jetë në lëvizje me prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes, me të rritur dhe/ose fëmijë të tjerë që fëmija i njihet më parë ose jo. Për më tepër, mund të bëhet një dallim ndërmjet fëmijëve të ndryshëm në lëvizje në bazë të arsyeve mbrapa kësaj lëvizjeje.

Ata i përkasin katër kategorive të mëposhtme:

- Personave të zhvendosur brenda vendit;
- Azil-kërkuesve dhe refugjatëve;
- Emigrantëve (d.m.th. për arsye ekonomike apo për ndryshime klimatike, si brenda ashtu dhe jashtë kufirit);
- Personave të trafikuar (fëmijët).

Përkufizimi ‘fëmijë në lëvizje’ i referohet “një game të gjerë fëmijësh në lëvizje, në një fazë të fëmijërisë së tyre, nga një vend në tjetrin shpesh nga vendi ku ata kanë jetuar që në fillim me prindërit e tyre drejt një vendi tjetër”. Ai i referohet kategorive të fëmijëve që organizatat të cilat punojnë me fëmijët nuk i janë referuar së bashku, për arsye se fëmijë të veçantë kanë staturë apo të drejta të ndryshme ligjore⁸⁷.

Një koncept tjetër që përdoret për të përshkruar shpërnguljen është “fëmijë i lëvizshëm”. Një fëmijë në lëvizje, është një fëmijë i cili pasi është larguar nga vendi ku ai apo ajo ka jetuar, jeton larg për një periudhë kohe të gjatë për shkak të ndryshimit që ka ndodhur në kushtet e tij apo saj të jetës dhe identitetin e tij/saj. Në këtë rast, autorët e kanë zgjedhur qëllimisht termin ‘i lëvizshëm’ pasi nënkupton konceptin e lëvizjes shoqërore – sepse fëmijët që lëvizin janë ndonjëherë të aftë ndryshojnë aspekte të rëndësishme të identitetit të tyre pas mbërritjes në destinacionin e ri, duke marrë zakone të reja ose edhe një gjuhë tjetër dhe duke ripërkufizuar vetveten si ‘qytetar’ në vend të termit fshatar⁸⁸.

Një specialist i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e migrantëve i ka përshkruar fëmijët

⁸⁵ Daniela Reale, “Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje: Përkthimi i parimeve në praktika”, te IOM, *Fëmijët në lëvizje*, 2013.

⁸⁶ Dottridge M. (2012). Çfarë mund të bëni për të mbrojtur fëmijët në lëvizje. Manual që ndihmon organizatat të rishikojnë si e parandalojnë trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, dhe të sigurohen nëse interesat më të mira të fëmijëve udhëheqin veprimtaritë e tyre. Terre des hommes International Federation

⁸⁷ Dottridge M., op. cit, fq. 19.

⁸⁸ Cilën mbrojtje për fëmijët në lëvizje në Afrikën Perëndimore. Projekt i një Studimi të Përbashkët Rajonal për Lëvizshmërinë/ Shpërnguljen e Fëmijëve dhe të Rinjve në Afrikën Perëndimore PLAN WARO ENDA Jeunesse Action AMWCY ILO Terre des hommes Foundation IOM Aide à l’Enfance - Suède UNICEF WCARO. 2011.

në lëvizje, në kontekstin e migracionit ndërkombëtar (pa përfshirë fëmijët që lëvizin brenda vendit të tyre)⁸⁹ si “fëmijë migrantë, që luajnë një rol aktiv në procesin e migracionit, kryesisht në fazat e kalimit dhe mbërritjes në vendet transit dhe destinacion. Midis të tjerave, ata mund të jenë duke migruar me anëtarët e familjes ose vetëm në kërkim të mundësive si për arsim ashtu edhe për punësim. Ata mund të gjenden edhe në vendet pritëse për t’u ribashkuar me anëtarët migrantë të familjes; janë rivendosur ose dërguar nga familjet për të qëndruar me të afërmit apo miqtë në vendet e treta ose, siç e ka dokumentuar dhe Raportuesi i Veçantë në të kaluarën, janë dërguar nga anëtarët e familjes për të gjetur punë jashtë shtetit dhe për të dërguar një pjesë të fitimeve në shtëpi”⁹⁰.

Kështu, koncepti i ‘fëmijëve në lëvizje’ përdoret për t’u referuar një game të gjerë fëmijësh që lëvizin ose brenda vendit të tyre ose përtej kufijve ndërkombëtar ose edhe ndërmjet kontinenteve. Ai mbulon fëmijët që lëvizin vetëm ose me të tjerë (fëmijë ‘të pashoqëruar’, ‘të ndarë’). Në secilin rast ata largohen nga mjedisi i tyre i njohur në një mjedis që është me pak i njohur, të paktën fillimisht, dhe për rrjedhojë ata janë më në rrezik për t’u shfrytëzuar apo për të mos u kujdesur siç duhet. Në të njëjtën kohë, ata mund të kenë më shumë mundësi sesa kanë pasur para se të largoheshin nga shtëpia.

Ndërkohë që ka arsye të mira për të bërë dallimin ndërmjet secilës kategori të fëmijëve, kjo gjë ka inkurajuar besimin se, secila kategori e veçantë fëmijësh kërkon një reagim të ndryshëm (për sa i përket mbrojtjes) nga Institucionet shtetërore, OJQ-të dhe aktorët e tjerë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve⁹¹.

Nga ana tjetër, një arsye kryesore për t’ju referuar të gjithë kategorive së bashku duke përdorur termin ‘fëmijët në lëvizje’, është për të identifikuar ngjashmëritë midis grupeve të ndryshme të fëmijëve, që ndajnë nevoja të përbashkëta për mbrojtje e për këtë arsye kërkojnë skema të ngjashme të reagimeve dhe mbrojtjeve. Më tej, në realitet, fëmijët nuk jetojnë brenda ‘kategorive’ por zhvendosen lehtë nga njëra te tjetra, kështu që format e mbështetjes dhe mbrojtjes nga të cilat përfitojnë të gjithë ose shumica e fëmijëve në lëvizje mund të jetë më efikase sesa ato që kanë si objektiv vetëm një kategori fëmijësh⁹².

Ndërkohë që është shumë e rëndësishme të përkufizojmë trafikimin e fëmijëve si një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut dhe si një krim i rëndë, është e rëndësishme që të njohim

89 Dottridge M. (2012). Çfarë mund të bëni për të mbrojtur fëmijët në lëvizje. Manual që ndihmon organizatat të rishikojnë si e parandalojnë trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, dhe të sigurohen nëse interesat më të mira të fëmijëve udhëheqin veprimtaritë e tyre. Terre des hommes International Federation

90 Jorge Bustamante, ‘Migracioni dhe mbrojtja ndërkombëtare për fëmijët’ në *Raportin e Raportuesit Special mbi të drejtat e njeriut për migrantët*, Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB, Dokumenti i OKB-së A/HRC/11/7 (5 Maj 2009).

91 Dottridge M. (2012) Çfarë mund të bëni për të mbrojtur fëmijët në lëvizje. Manual që ndihmon organizatat të rishikojnë si e parandalojnë trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, dhe të sigurohen nëse interesat më të mira të fëmijëve udhëheqin veprimtaritë e tyre. Terre des hommes International Federation

92 Fenomeni i Fëmijëve në Lëvizje në Syrin e Fëmijës, Projekti Mario, BKTF, 2012.

se lëvizja e fëmijëve nuk është term sinonim me trafikimin e tyre. Duke u përqendruar në trafikimin si një vepër penale, debati i trafikimit ka ulur rëndësinë e çështjeve se pse dhe si, fëmijët fillojnë udhëtimet e tyre. Me fjalë të tjera, diskutimet nuk marrin parasysh rolin e fëmijëve në marrjen e vendimeve, jo vetëm si shkaktar për lëvizjen, por dhe si një element për mbrojtjen e tyre⁹³.

Si rrjedhojë, reagimet kundër trafikimit kanë pasur tendencën që të konsiderohen si përgjigja kryesore ndaj të gjitha formave të lëvizjes, e cila *a priori* shihet si diçka negative dhe e rrezikshme për mirëqenien e fëmijës. Për shembull, nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme si të mbrohen fëmijët në lëvizje, nga situatat shfrytëzuese – përfshirë edhe shfrytëzimin seksual – me mënyra të tjera sesa me parandalimin e vetë lëvizjes.

Po ashtu, lëvizja e fëmijëve nuk është e njëjtë me migrimin e të rriturve. Deri tani, debati i migracionit është fokusuar kryesisht në lëvizjen e të rriturve. Për rrjedhojë, këndvështrimi i vetë fëmijës rrallë herë është marrë parasysh, dhe migrimi i tyre shpesh supozohet që të jetë për arsye ekonomike. Shtrirja e plotë dhe diversiteti i fëmijëve në lëvizje nuk është trajtuar në literaturën për migracionin e përgjithshëm⁹⁴. Në këtë aspekt, nuk janë kuptuar specifikat e motiveve dhe rrethanave, cënueshmëria dhe qëndrueshmëria e fëmijëve në lëvizje, brenda popullsisë së përgjithshme migruese.

Në të gjithë botën, miliona fëmijë migrojnë nën rrethana të ndryshme – vetëm ose me prindërit e tyre ose kujdestarë të tjerë kryesorë, me dëshirë ose me forcë, brenda ose ndërmjet vendeve – dhe për arsye të ndryshme, si për shembull, për të kërkuar punë, akses në arsim, largimi nga rrethanat e pafavorshme si konfliktet, varfëria, abuzimi, dhuna etj. Vetë situata e lëvizjes mund t'i vendos ata në një rrezik (më të madh) të përkujdesjes së pamjaftueshme, shfrytëzimit ekonomik ose seksual, abuzimit, neglizhencës, ose dhunës, veçanërisht nëse udhëtojnë vetëm. Padukshmëria e tyre ligjore që vjen nga mungesa e regjistrimit në lindje paraqet një rrezik të veçantë. UNICEF vlerëson se më shumë se një të tretat e fëmijëve të sapolindur në zonat urbane nuk janë të regjistruar⁹⁵. Nga ana tjetër, migrimet në disa raste mund të ndihmojnë shumë fëmijët dhe familjet e tyre për të përmirësuar standardet e tyre të jetës dhe mundësitë e jetës⁹⁶. Megjithatë, edhe pse studimet janë shprehur se shumica e fëmijëve migrojnë me prindërit dhe familjet e tyre për të gjetur punë dhe mundësi më të mira në fakt një numër i konsiderueshëm fëmijësh lëvizin vetëm.

93 Daniela Reale, "Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve në lëvizje: Përktimi i parimeve në praktika", te IOM, *Fëmijët në lëvizje*, 2013.

94 Po aty.

95 *Situata e Fëmijëve të Botës 2012*, Fëmijët në një Botë Urbane, fq. 3 http://www.unicef.org/soec2012/pdfs/SOEC%202012-Executive%20Summary_EN_13Mar2012.pdf.

96 <http://resourcecentre.savethechildren.se/child-protection/priority-areas/children-èithout-appropriate-care/children-move>

'Fëmijët e lënë pas'⁹⁷ nga prindërit që migrojnë mund të klasifikohen si 'fëmijë në lëvizje'. Megjithatë, ata janë në një situatë disi të ngjashme sepse janë të privuar nga prania e një apo të dy prindërve dhe për rrjedhojë, shpesh janë të ekspozuar ndaj rreziqeve më të mëdha sesa fëmijët që jetojnë me prindërit e tyre. Kur të dy prindërit kanë migruar, vendosja e kujdesit alternativ është e nevojshme për fëmijët më të vegjël që mund të jetojnë të sigurt me gjyshërit por mund të jenë edhe në një mjedis më pak të sigurt, për shembull, në shtëpi të drejtuara nga vetë fëmijët kur të dy prindërit kanë vdekur.

Ashtu si fëmijët në lëvizje, edhe fëmijët që mbeten prapa, nuk e përjetojnë automatikisht abuzimin apo të kenë nevojë menjëherë për masat aktive të mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë, janë raportuar raste të shumta⁹⁸ ku fëmijë të veçantë kanë vuajtur, si rezultat i mungesës së njërit apo të dy prindërve por edhe sepse atyre u kërkohej të mbushnin hapësirën e krijuar nga mungesa e prindit në ekonominë e shtëpisë. Edhe në ato raste, ka nevojë për të grumbulluar prova për përvojat e fëmijëve në çdo sferë ku mund parashikohet një ndërhyrje, kështu që kjo mund të ketë përfitime maksimale për fëmijët që kanë më shumë nevojë dhe të vlerësohen nevojat për mbrojtje sipas rastit.

Lëvizja e fëmijëve është më komplekse dhe shumë dimensionale dhe mund të ketë si rezultate pozitive ashtu edhe negative. Duke marrë parasysh kompleksitetin e problemit dhe specifikat e situatës së fëmijëve në lëvizje në lidhje me të rriturit, adresimi i këtij fenomeni kërkon një qasje të unifikuar, gjithëpërfshirëse, si edhe një bashkëpunim ndërkombëtar intensiv dhe të zhvilluar.

97 Dottridge M. (2012) Çfarë mund të bëni për të mbrojtur fëmijët në lëvizje. Manual që ndihmon organizatat të rishikojnë si e parandalojnë trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, dhe të sigurohen nëse interesat më të mira të fëmijëve udhëheqin veprimtaritë e tyre. Terre des hommes International Federation.

98 Po aty.

Shtojca III

○ **Kuadri rregullator shqiptar në lidhje me të drejtat e fëmijëve në lëvizje**

Shqipëria ka ratifikuar këto Instrumente Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në lidhje me fëmijët në lëvizje:

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (Nju Jork 1966, në fuqi që nga viti 1976) ratifikuar nga Shqipëria më 04.10.1991
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Nju Jork 1966, në fuqi që nga viti 1976) ratifikuar nga Shqipëria më 04.10.1991
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Romë, 1950 në fuqi që nga 1953) ratifikuar nga Shqipëria që nga 02. 10. 1996
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nju Jork 1989, në fuqi që nga viti 1990) dhe Protokollin Opsional i Konventës për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë e Fëmijëve (Nju Jork 2000, në fuqi që nga 2002) ratifikuar nga Shqipëria 27.02.1992.
- Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (Strasburg 1996, në fuqi që nga viti 2000) ratifikuar nga Shqipëria më 01.02.2012
- Konventa për Punën e Detyruar ose të Detyrueshme 78 (Nr. 29 e vitit 1930) ratifikuar nga Shqipëria 25.06.1957
- Konventa për Format më të Këqija të Punës së Fëmijës (Nr. 182 i vitit 1999) ratifikuar nga Shqipëria në 02.08.2001
- Konventa Suplementare për Heqjen e Skllavërisë, Tregtisë së Skllavëve dhe Institucioneve dhe Praktikave të Ngjashme me Skllavërinë (Gjenevë 1956, në fuqi që nga viti 1957) ratifikuar nga Shqipëria në 06.11.1958
- Protokollin për Parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, ratifikuar nga Shqipëria më 21.08.2002.
- Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Njerëzve (Varshavë 2005, në fuqi që nga 1/2/2008) ratifikuar nga Shqipëria në 22/12/2005 6/2/2007 1/2/2008
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit Ndërkombëtar të Organizuar (Nju Jork 2000, në fuqi që nga 2003) ratifikuar nga Shqipëria më 21.08.2002
- Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (Strasburg 1983 në fuqi që nga 1988) ratifikuar nga Shqipëria më 01.03.2005
- Karta Evropiane Sociale (rishikuar) (Strasburg 1996, në fuqi që nga 1999), ratifikuar nga Shqipëria më 01.01.2003

Baza të tjera ligjore në Shqipëri lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pavarësisht “kategorive të ndryshme” që fëmija mund të klasifikohet dhe shërbimet për mbrojtjen e

fëmijëve paraqitet më poshtë, duke filluar me ligjet dhe duke vazhduar me strategjitë dhe dokumente të tjerë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë – Neni 54, pika 1 shpreh se: “Fëmijët, të rinjtë, nënat shtatzënë dhe nënat e reja gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti”.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë – Neni 54, pika 3 shpreh se: “Çdo fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe puna, veçanërisht puna e fëmijës nën moshën minimale, e cila mund të lidhet me problemet shëndetësore dhe morale ose vënë në rrezik jetën dhe zhvillimin normal të fëmijës”.
- Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (Rishikuar).
- Ligji Nr. 9355, i datës 10.03.2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore” (ndryshuar), Neni 1, 2, 3, 4, 29, 31 dhe Neni 42.
- Ligji Nr. 9669 i datës 18. 12.2006 “Për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhënie Familjare”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 80 i datës 20.01.2008 “Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale për Mbrojtjen Sociale”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 658 i datës 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore”;

Ligje të tjera të rëndësishme që duhen marrë parasysh me kujdes kur punohet me fëmijët në lëvizje janë:

- Ligji për regjistrimin civil dhe të lindjeve në Republikën e Shqipërisë, **Nr. 8950, i datës 10.10.2002**. Neni 7, Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijës shpreh se: “Fëmija duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe që nga lindja duhet të ketë të drejtën e emrit, të drejtën e kombësisë dhe, për aq sa është e mundur, të drejtën për të njohur dhe për t’u kujdesur nga prindërit e tij ose e saj.”

Fëmijët në lëvizje janë një grup fëmijësh që mund të jenë të regjistruar në vendin e tyre të origjinës dhe si rrjedhojë ata qëndrojnë jashtë sistemit të shërbimeve.

- Ligji për Arsimin Para-Universitar në Republikën e Shqipërisë, Nr. 69/2012, është në harmoni me Kartën e të Drejtave të Komisionit Evropian (2000/C 364/01), viti 2000. Ligji mbështet konventën e OKB-së KDF dhe zhvillon më në detaje organizimin dhe strukturën e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë, arsimit para universitar për grupet etnike dhe pakicat, forma të ndryshme të arsimit para universitar, si për shembull shkollimi në shtëpi, arsimi në institucionet publike dhe jo publike, arsimi i veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar, roli i psikologut të shkollës në identifikimin e fëmijëve të cënueshëm, bashkëpunimi ndërmjet shkollës, prindërve dhe fëmijëve në procesin e arsimit etj. Ka një numër Aktesh Normative, që lehtësojnë zbatimin e ligjit dhe nxisin arsimin para universitar për grupet e cënueshme (si Vendimi për tekste shkollore falas për fëmijët rom, ose për fëmijët me një prind etj.). Gjatë vitit të fundit, Ministria e Arsimit ka ndërmarrë iniciativa

për transformimin e shkollave në qendra të komunitetit (të cilat mund të shërbejnë për veprimtaritë jashtë kurrikulare, për të mbështetur fëmijët që hasin vështirësi në procesin e arsimimit, nxitjen e ndërveprimit ndërmjet mësuesve dhe prindërve dhe nxitjen e llojeve të ndryshme të arsimit për të gjithë fëmijët). Kjo iniciativë shikohet si një mënyrë për t'i bërë shkollat më të hapura ndaj komuniteteve, prindërve dhe fëmijëve dhe gjithashtu përfshirjen e fëmijëve që janë në grupet e përjashtuara dhe të cënueshme në një shkallë më të madhe).

- Ligji për Kujdesin Shëndetësor Parësor, Nr. 10 107/2009. Ligji shpjegon të gjitha format e kujdesit shëndetësor parësor, standardeve të kujdesit shëndetësor, roleve dhe përgjegjësive të personelit shëndetësor në nivele të ndryshme të kujdesit shëndetësor parësor etj.
- Ligji për Policinë e Shtetit, Nr. 9749, i datës 4.6.2007.
- Ligji për Ndhmën Ekonomike dhe Shërbimet Sociale, Nr. 9355, i datës 10.03.2005.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e fëmijëve për të qëndruar me prindërit përveç rastit kur interesat në të mirë të fëmijës kërkojnë ndryshe, ose kur ndarja ndodh për shkak të braktisjes, apo arrestimit të një apo të dy prindërve, apo në rastet kur një prind akuzohet se ka kryer një krim kundër fëmijës, e për këtë arsye shteti duhet të ndërhyjë me qëllim që të mbrojë fëmijën. Më tej, gjykata mund të heqë kujdestarinë prindërore në rastet kur prindi ka dëmtuar interesat e fëmijëve. Më specifikisht, gjykata mund të heq kujdestarinë prindërore në rastet e abuzimit të fëmijëve nga prindi ose kur prindi tregon pakujdesi të rëndë gjatë kohës së ushtrimit të përgjegjësive të tij/saj prindërore kundrejt fëmijës. Kjo pakujdesi do të përbente një rrezik të mundshëm abuzimi dhe neglizhence, që do të sillte shfrytëzimin dhe trafikimin e fëmijës. Për më tepër, ka masa të veçanta që mund të çohen më tej për të siguruar mbrojtjen e duhur të fëmijës.

Më tej, **Ligji “Për masat kundër dhunës në familje”** ka si qëllim të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjithë format e saj, të sigurojë mbrojtjen e anëtarëve të familjes, përfshirë fëmijët viktimë të dhunës në familje. Masat parandaluese të garantuara nga ky ligj mund të përdoren për fëmijët që janë subjekt i shfrytëzimit, trafikimit apo lypjes kur këto kryhen nga prindërit. Shfrytëzimi, trafikimi ose lypja mund të karakterizohen si dhunë sepse dhuna përkufizohet si çdo veprim apo mosveprim i një individi ndaj një tjetri që mund të shkaktojë lëndimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social apo ekonomik, nëse dhuna ndodh midis anëtarëve të familjes. Ky përkufizim përqendrohet te pasojat e ndonjë veprimi ndaj viktimës, duke mos e kufizuar zbatimin e tij te ndonjë listë veprimesh të përkufizuara me ligj. Për këtë arsye, çdo lloj veprimtarie që do të lëndonte fëmijën dhe që mund të cilësohet si dhunë, përfshirë edhe lypjen e fëmijëve, punën e fëmijëve në rrugë, etj., nëse kjo do të kryhej nga prindërit dhe/ose kujdestarët ligjorë.

Në këto kushte, fëmijët mund të mbrohen nga urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe

urdhërat e mbrojtjes që nxirren nga gjykatat. Ata mund të përfshijnë lloje të ndryshme masash si: të urdhërojnë ndërhyrjen e shërbimeve sociale, apo të organizatave. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është ndryshuar disa herë me qëllim që të mbrohen fëmijët nga shfrytëzimi për punë dhe për të penguar veprimet e jashtëligjshme kundër fëmijëve, duke vendosur sanksione më të rënda kundër shkelësve të ligjit, veprimet e paligjshme të të cilëve mund të çojnë në humbjen e jetës së fëmijës. Megjithatë, legjislacioni për mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacioni i punës kanë nevojë të rishikohen për të adresuar siç duhet fenomenin e punës së fëmijëve për kontributin e punës së fëmijëve për familjen e tij/saj dhe vetëpunësimin e fëmijëve.

Strategjia Kombëtare për Përfshirjen Sociale (2007-2013), e cila ka në qendër reduktimin e varfërisë dhe të përjashtimit nga shoqëria, i referohet edhe fëmijëve në rrezik për t'u ndikuar nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca, duke theksuar në veçanti fëmijët rom dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim që të sigurojë ndërhyrje të hershme për të mbrojtur fëmijët.

Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Komunitetit Rom në Shqipëri (2003) përqendrohet te fëmijët më të cënueshëm, që jetojnë në kushte shumë të varfra, në veçanti fëmijët rom dhe ballkano – egjiptian. Strategjia kombëtare përfshin masa në lidhje me fëmijët që i përkasin komunitetit, ka në qendër të saj forcimin e përpjekjeve për të reduktuar nivelin e braktisjes së shkollës dhe të nxisë prindërit që të dërgojnë fëmijët në shkollë.

Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit dhe OSBE-së në Shqipëri për **Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit të Fëmijëve në Turizëm**, u nënshkrua në vitin 2007 nga 22 operatorë turistikë (OSBE, Raporti Vjetor 2007).

Përveç këtyre dokumenteve, më poshtë jepet një listë e përmbledhur e **kuadrit rregullator për migrimin** në Republikën e Shqipërisë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Strategjia Kombëtare për Migracionin (2005-2010);
3. Plan Veprimi për Migracionin;
4. Strategjia për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer, 2010-2015 dhe Plan Veprimi.
5. Ligji Nr. 9749, datë 4.05.2007 “Për Policinë e Shtetit”;
6. Ligji Nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të Huajt”;
7. Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësi”;
8. Ligji Nr. 10060, datë 26.01.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit Nr. 8432 datë

- 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;
9. Konventa e bashkëpunimit policor për Evropën juglindore (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgari, Mal i Zi, Maqedoni, Moldavi, Rumani dhe Serbi) nënshkruar më 05.05.2006, në Vjenë;
 10. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia), “Për ngritjen e një sistemi të shkëmbimit të informacionit statistikor për migracionin e paligjshëm dhe pjesëmarrjen në sistemin rajonal të paralajmërimit të hershëm” nënshkruar në Shkup, më 20.11.2008.
 - II. Marrëveshjet e ri-pranimit dhe protokollet zbatuese të nënshkruara nga Shqipëria me:
 - a. Qeverinë e Republikës së Italisë për ri-pranimin e personave, nënshkruar më 18 nëntor 1997;
 - b. Këshillin e Federatës Zvicerane për ri-pranimin e personave, shkurt 2000.
 - c. Qeverinë e Republikës së Hungarisë për ri-pranimin e personave, nënshkruar më 20 mars 2001
 - d. Mbretërinë e Belgjikës për ripranimin e personave të paligjshëm nënshkruar më 17 prill 2001.
 - e. Qeverinë e Rumanisë për ripranimin e personave, nënshkruar më 7 qershor 2002. Protokollin zbatues nënshkruar më 13 tetor 2004.
 - f. Qeverinë e Republikës së Bullgarisë, për ripranimin e personave që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme, nënshkruar më 11 qershor 2002
 - g. Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë për ripranimin e personave, nënshkruar më 11 nëntor 2002
 - h. Qeverinë e Republikës së Kroacisë për ripranimin e personave që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme e nënshkruar më 28 janar 2003
 - i. Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut për ripranimin e personave dhe protokollit të saj e nënshkruar më 14 tetor 2003, ka hyrë në fuqi më 16 gusht 2005
 - j. Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për ripranimin e personave nënshkruar më 17 qershor 2004
 - k. Komunitetin Evropian për ripranimin e personave që qëndrojnë pa leje, 14 prill 2005
 - l. Mbretërinë e Danimarkës për ripranimin e personave, nënshkruar më 24 prill 2008, ka hyrë në fuqi më Dhjetor 2008
 - m. Islandën për ripranimin e personave, nënshkruar më 26 gusht 2008
 - n. Mbretërinë e Norvegjisë për ripranimin e personave, nënshkruar më 12 shtator 2008, ka hyrë në fuqi më 1 mars 2009
 - o. Këshillin e Ministrave të Bosnje-Hercegovinës për ripranimin e personave dhe protokollin e zbatimit, nënshkruar më 23 mars 2009

- p. Qeverinë e Republikës së Kosovës për ripranimin e personave dhe protokollet e zbatimit nënshkruar më 6 tetor 2009.
 - q. Qeverinë e Malit të Zi për ripranimin e personave, hyrja apo qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm dhe protokoli i zbatimit nënshkruar më 6 nëntor 2009
12. Protokoli i zbatimit për marrëveshjen e ripranimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, si edhe me vende të tjera:
- a. Vendet e Beneluksit (Mbretëria e Belgjikës, Luksemburgut dhe Holandës) më 9 qershor 2005
 - b. Ministrinë e Brendshme Federale e Austrisë nënshkruar më 29 qershor 2007.
 - c. Ministrinë e Brendshme të Republikës së Italisë nënshkruar më 31 Tetor 2008
 - d. Ministrinë e Brendshme të Republikës së Kroacisë nënshkruar më 10 shkurt 2009
 - e. Qeverinë e Republikës së Hungarisë nënshkruar më 30 tetor 2009
 - f. Qeverinë e Republikës së Sllovakisë nënshkruar më 22 janar 2010
13. VKM Nr. 362 datë 01. 04. 2009 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”;
14. VKM Nr. 470, datë 06.05.2009 “Për miratimin e modelit, specifikimeve teknike dhe formave të dokumenteve të udhëtimit për të huajt”;
15. VKM Nr. 493, datë 06.05.2009 “Për miratimin e modelit, specifikimeve teknike të ngjitjes së vizës”;
16. VKM Nr. 469, datë 06.05.2009 “Për përcaktimin e elementeve të sigurisë dhe miratimin e formës dhe modelit të leje qëndrimit për të huajt”;
17. VKM Nr. 1083 datë 28.10.2009 “Për ngritjen e qendrës së mbyllur dhe miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të saj”;
18. VKM Nr. 708, datë 16.10.2003 “Për licencimin dhe funksionimin e Agjencisë Private të Punësimit”;
19. VKM Nr. 745, datë 07.11.2007, “Për plan veprimin për remitancat”
20. VKM Nr. 348, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipit A/NK (punësim ndërkuftar)”;
21. VKM Nr. 349, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/PS (punësim sezonal)”;
22. VKM Nr. 866, datë 12. 08. 2009 “Për Miratimin e marrëveshjes dhe protokollit të saj zbatues ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë në fushën e punësimit”;
23. VKM Nr. 350, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/SH (shërbime vullnetare)”;

24. VKM Nr. 351, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi B/VP (aktivitet ekonomik i pavarur, si i vetë-punësuar)”;
25. VKM Nr. 352, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/AF (pjesëtarët e familjes)”;
26. VKM Nr. 353, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/S (Studentët)”
27. VKM Nr. 354, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi C, për raste të veçanta”;
28. VKM Nr. 355, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi B/I (aktivitet ekonomik i pavarur, si investitor)”;
29. VKM Nr. 356, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/TN (transferim brenda sipërmarrjes)”;
30. VKM Nr. 357, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi D leje pune e vazhdueshme”;
31. VKM Nr. 358, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/FP (Arsimi profesional)”;
32. VKM Nr. 359, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, “Tipi A/P punëmarrësit ”;
33. VKM Nr. 360, datë 06.03. 2009 “Për dokumentacionin dhe procedurën për përjashtim nga detyrimi për pajisje me leje pune”;
34. Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Brendshme Nr. 2864, datë 30.09.2009, Ministrisë së Punëve të Jashtme Nr. 11766, datë 6.10.2009 dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr. 1857, datë 16.10.2009 për miratimin e plan veprimit “Për zbatimin e ligjit Nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”;
35. Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorit të Shërbimit Shtetëror të Inteligjencës Nr. 2102, 03.08.2009, “Mbi bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimeve të Inteligjencës Shtetërore për procedurën e lëshimit të vizës”;
36. Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorit të Shërbimit të

- Inteligjencës Shtetërore Nr. 2947, datë 06.10.2009, “Për bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit të Inteligjencës Shtetërore për procedurat e trajtimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë”;
37. Udhëzim i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 1297, 16.07.2004, “Mbi funksionimin e regjistrimit për emigrantët dhe procedurat për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që emigrojnë për qëllime punësimi dhe që janë kthyer nga emigracioni”;
38. Udhëzim i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 612, 29.03.2004 “Mbi mënyrën e funksionimit të Komisionit të rishikimit të aplikimeve për licencimin e Agjencive Private të Punësimit”;
39. Urdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 1722, datë 18.09.2007, “Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurës për përfitim e statusit të emigrantit”;
40. Urdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 2086, datë 13 Nëntor 2007, “Për formën, përmbajtjen e Regjistrimit për emigrantët dhe procedurën e regjistrimit”;
41. Urdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 1176, datë 03.06.2009, “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik për Migracionin”;
42. Urdhër i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Nr. 1712, datë 18.09.2007 “Për marrjen e statusit të emigrantit”;
43. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1111, datë 29.09.2009 “Për bashkërendimin dhe bashkëpunimin brenda strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, bashkëpunimi i këtyre strukturave me struktura të tjera të Policisë së Shtetit dhe struktura të tjera e palët të interesuara jashtë Policisë së Shtetit në kuadër të zbulimit të imigracionit të paligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
44. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 851, 03.08.2009, “Procedurat standarde të punës së policisë kufitare dhe migracionit”;
45. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1016, 08.09.2009 “Për funksionimin e zyrës së analizës së rrezikut dhe krimit ndërkufitar në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe vendosja e bashkëpunimit me struktura të tjera për këtë qëllim”.

Shtojca IV

○ **Rolet dhe përgjegjësitë e agjencive në lidhje me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve**

Rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Sipas Protokollit të Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, agjencitë kryesore në lidhje me mekanizmin e mbrojtjes së fëmijëve dhe rolet e përgjegjësitë e tyre, mund të përmbliidhen si më poshtë:

Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve / Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve

Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Identifikimi i fëmijëve në nevojë dhe marrja e referimeve nga agjencitë, organizatat e tjera dhe publiku (përfshirë fëmijët)
- ✓ Ndërmarrja e vlerësimit fillestar të të gjithë fëmijëve të referuar te Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
- ✓ Bashkërendimi / kryerja e një vlerësimi të thelluar për fëmijët e referuar
- ✓ Bashkërendimi dhe moderimi i Takimit të Mbrojtjes së Fëmijëve, për të diskutuar fëmijë të veçantë të vlerësuar si fëmijë në rrezik.
- ✓ Hartimi dhe rishikimi i planeve individuale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe monitorimi i zbatimit të tyre.
- ✓ Të punuarit drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet (për shembull këshillim dhe mbështetje)
- ✓ Mbajtja e të dhënave të sakta dhe faktike për të gjithë fëmijët e referuar te Mbrojtja e Fëmijës
- ✓ Sigurimi i të dhënave për procese të tjera qeveritare, duke përfshirë sigurimin e raporteve për gjendjen e fëmijëve të zonës; hartëzimi i situatës së fëmijëve, të drejtat e tyre, ofruesit e shërbimeve dhe nevojat e fëmijëve brenda zonës gjeografike ku ata punojnë; dhe promovimi aktiv i të drejtave të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuese

Policia

Përgjegjësitë e tyre përfshijnë:

- ✓ Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje, dhe referimi i tyre te NJMF-ja në kohën e duhur ose te një agjenci tjetër (si, p.sh. Shërbimet Sociale Shtetërore / OJQ jashtë orarit të zakonshëm të punës)
- ✓ Parandalimi i krimit duke mbështetur NJMF-në në parandalimin / aktivitetet e parandalimit të hershëm, si për shembull vizitimi i familjeve (nëse ka shqetësime për sigurinë)

- ✓ Ndjekja e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetja e hartimit dhe zbatimit të planeve individuale të krijuara për fëmijët.
- ✓ Hetimi i pretendimeve për krime kundër fëmijëve

Arsimi

Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimi i tyre te NJMF-ja në kohën e duhur (zakonisht nëpërmjet psikologut të shkollës)
- ✓ Lehtësimi dhe mbështetja e fëmijëve për të ndjekur shkollën të cilët janë identifikuar si të pambrojtur ndaj abuzimit
- ✓ Ndjekja e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetje për hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të krijuara për fëmijët

Shëndetësia

Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje, dhe referimi i tyre te NJMF-ja në kohën e duhur
- ✓ Lehtësimi dhe ofrimi i ndihmës mjekësore, si kontrolllet e zhvillimit dhe ekzaminime mjekësore
- ✓ Ndjekja e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetje për hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të krijuara për fëmijët

Shërbimet Sociale Shtetërore

Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Identifikimi i fëmijëve në nevojë për mbrojtje, dhe referimi i tyre te NJMF-ja në kohën e duhur
- ✓ Ofrimi i një strehimi të përshtatshëm alternativ për fëmijët që nuk mund të jetojnë me familjet e tyre
- ✓ Ndjekja e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetje për hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të krijuara për fëmijët
- ✓ Mbështetje për Administratorët Social për monitorimin e familjeve
- ✓ Lehtësimi dhe bashkërendimi ndërmjet NJMF-së dhe Institucioneve Rezidenciale që të sigurohet pranimi në kohë, pa vonesa i fëmijëve nëse janë në rrezik të menjëhershëm

OJQ-të & Institucionet Rezidenciale (si edhe strehëzat e urgjencës)

Përgjegjësitë përfshijnë:

- ✓ Bërjen e referimeve tek NJMF-ja
- ✓ Ndjekja e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetje për hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të krijuara për fëmijët

*Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve***Përgjegjësitë përfshijnë:**

- ✓ Sigurimi i kuadrit dhe drejtimit për mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar
- ✓ Monitorimi i punës së NJFM-ve, nëpërmjet Njësive për të Drejtat e Fëmijëve
- ✓ Organizimi dhe bashkërendimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet Shërbimeve Sociale, Njësive të të Drejtave të Fëmijëve dhe shërbimeve të tjera, si edhe me NJMF-të më të afërta për ato zona ku nuk janë krijuar NJMF.

*Njësiti e të Drejtave të Fëmijëve***Përgjegjësitë përfshijnë:**

- ✓ Mbështetja e punës së Agjencisë Shtetërore në monitorimin e punës së NJMF-ve nëpërmjet grumbullimit të të dhënave
- ✓ Raportimi te Agjencia Shtetërore kur këto raportime janë për ndonjë fëmijë në nevojë për t'u mbrojtur, kur një NJMF nuk është krijuar akoma me qëllim që të identifikojnë mënyrën më të mirë për të mbështetur fëmijën

*Bashkitë / Komunitat***Përgjegjësitë përfshijnë:**

- ✓ Krijimi i NJMF-ës, me një punonjës që është në gjendje të kryej detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës
- ✓ Sigurimi i mbështetjes për punën e NJMF-ës, duke lehtësuar komunikimin, ofrimin e shërbimeve dhe lehtësimin e proceseve, për shembull të regjistrimit të lindjeve
- ✓ Caktimi i një buxheti të mjaftueshëm kështu që NJMF-ja është e aftë të funksionojë me efikasitet, përfshirë këtu sigurimin e hapësirës së duhur për zyrë dhe burimet e nevojshme
- ✓ Mundësimi i pjesëmarrjes në trajnime dhe në aktivitete për ngritjen e rrjeteve për punonjësit e NJMF-ës
- ✓ Sigurimi i mbështetjes së duhur teknike për NJMF-në dhe mbikëqyrja e saj.



**Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me Mekanizmin
Kombëtar të Referimit të viktimave të trafikimit**

Në rastin e trafikimit të fëmijëve, pavarësisht roleve të agjencive që përbëjnë mekanizmin, të përshkruara më sipër, ka edhe faktorë të tjerë të cilët janë parashikuar të luajnë një rol aktiv në këtë mekanizëm, si: Ministria e Brendshme, Prokurori i Përgjithshëm, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Strehëzat, IOM-i dhe disa OJQ lokale.

Të gjitha ministratë e mësipërme kanë përgjegjësinë për të zbatuar PSV-të, të standardizojnë terminologjinë e legjislacionit dhe kuadrin përkatës rregullator dhe të luajnë role konkrete në këtë mekanizëm për intervistimin, identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit dhe gjithashtu të ofrojnë ndihmën e nevojshme për rehabilitimin e tyre. Më konkretisht, lidhur me rolin e fundit, përgjegjësitë e tyre mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Ministria e Shëndetësisë siguron shërbime shëndetësore falas për të gjitha viktimat e trafikimit
- Ministria e Arsimit siguron se të gjithë fëmijët regjistrohen në shkollë, dhe gjithashtu ofron trajnime dhe promovon te arsimiti i detyrueshëm çështjet kundër trafikimit.
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë siguron zbatimin e standardeve të kujdesit, dhe rehabilitimin fizik, psikologjik dhe social të viktimës, promovimin dhe lehtësimin e arsimit profesional, përfshirjen në tregun e punës, lehtësimin e procedurave të strehimit, etj.
- Ministria e Punëve të Jashtme ka gjithashtu detyrën për të lehtësuar procedurat e regjistrimit të individëve, nëse nuk janë të regjistruar dhe pajisjen e tyre me dokumentet e nevojshme të identifikimit.

IX. Referencat

- ASHMDF (2012). Raporti vjetor (2011-2012) i monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.
- Avokati i popullit. (2013). Raport i veçantë për problematikën dhe gjendjen e të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri.
- BKTF. (2012a). Child Movement Phenomenon from a Child Perspective. Mario project.
- BKTF. (2012b). Situational Analysis Report on Child Trafficking in Albania.
- BKTF. (2011). Situational analysis on child protection system.
- European Commission. (2012). Report for the study on typology and policy responses to child begging in EU.
- INSTAT. (2012). Albania: Population and housing census 2011. Retrieved from http://www.instat.gov.al/media/177354/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf
- INSTAT. (2010). Albania in Figures.
- Institute of Public Health. (2010). Albania: demographic health survey.
- Mario. (2010). Observation report: exploitation of Albanian children in street situation in Kosovo.
- Ministry of Interior of Albania and Office of the National Coordinator for Anti trafficking, Albania. (2011). Standard Operating Procedures for Identification and Referral of Potential Victims of Trafficking.
- Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities. (2010). Evaluation Report of the National Strategy for Children.
- Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities in Albania, UNICEF Albania, Terre des hommes. (2010). Working Protocol for Child Protection Workers.
- Official Gazette, nr. 53. (2010). Law on the Protection of the Rights of the Child in the Republic of Albania. nr.10 347, date 4.11.2010.
- Orgocka, A. (2010). The international migration of children from rural North East Albania. In J. Kanics, D. S. Hernandez and K. Touzenis (Eds), *Migrating Alone: Unaccompanied and separated children’s migration to Europe* (pp.129-142). Unesco Publishing.
- Partnerë për Fëmijët. (2007). Assesment in child trafficking vis a vis smuggling in the Northwest of Albania.
- Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike. (2012). Raport vlerësimi, Strategjia

Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale, 2007-2013.

- Reale, D. (2013) “Protecting and supporting children on the move: Translating principles into practices”. In IOM, Children on the move.
- Save the Children. (2012). Child rights situation, Albania.
- SCEP. (2009). Statement of Good Practices. D9.Treatment of Unaccompanied and Separated Children Outside Their Country of Origin. Retrieved from www.unhchr.ch
- State Department. (2013). Trafficking in Persons Report.
- TLAS. (2006). Evaluation Report on Problems Arising from the Non-registration of Birth of Roma Children.
- UNICEF & Terre des hommes. (2013). Assessment of the capacities of the providers of the social services, the directors and specialist of social services on the model of case management, Unicef, Tdh, 2013 . Unpublished.
- UNICEF. (2012). The state of the world’s children 2012: Children in an Urban World.
- UNICEF. (2011). Mapping of Roma Children in Albania.
- “Vatra” Psycho-Social Center. (2010). Annual report 2010.
- Westwater, G. & Jovanovic, V. (2009). Evaluation of Child Protection Unit intervention within the framework of social welfare system reform and decentralization of social service processes in Albania.
- World Vision. (2013). Evaluation study of child protection units.



The page features several stylized human figures in a light grey color. One figure is at the top left, another at the top right, a third at the bottom right, and a fourth at the bottom center. Each figure has a circular head and four limbs extending outwards in a star-like pattern.

Terre des hommes Albania

PO Box 7426, Tirana - Albania
Tel/Fax: +355 (0) 42 46 88 11
Web: www.tdh-childprotection.org / www.tdh.ch
Email: info@tdhalbania.org

Save the Children Albania

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8
Pallatet I Maji, Vila "Lami"; P.O. Box 8185
Tel/Fax: +355 4 2261840 / +355 4 2263 428
Web: www.albania.savethechildren.net
Email: info.albania@savethechildren.org